

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7646 E diel 9 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

**E**dëgjova dhe e lexova deklaratën që anëtari i sotëm i Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe kryetari e kryeministri i djeshëm i Republikës së Shqipërisë...

Vijon në faqen 21

Nga REXHEP QOSJA

Berisha nuk ka të drejtë të flasë për kufij



Opinion

Ditës

**N**ëse njerëzia bëri pushim muajin gusht- ministrat e qeverisë kaluan pushimet më të këqija për shkak të sinjaleve se në shtator priteshin ndryshime në ...

Vijon në faqen 22

Nga LUTFI DERVISHI

Ndryshimi që prisnim nga Rama!



Kriteret e përfitimtimit në qytet dhe fshat

## Pensionistët, ja si mund të përfitohet kompensimi prej 760 lekësh në muaj

Të moshuarit që marrin pension pleqërie ose invaliditeti 'rimburohen' për energjinë elektrike

Nga VOLTIZA DURO

Të gjithë individët që marrin pension pleqërie, invaliditeti apo familjare, në masën e plotë apo edhe të pjesshme mund të përfitojnë një kompensim të të ardhurave mujore deri në 760 lekë. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot të gjitha ...

Në faqen 8

**NISMA/ KREU I PD: TE PERCAKTOHET NE KUSHTETUTE, MIRATIM ME 93 VOTA**

# BASHA: KONSENSUS PER VETINGUN E POLITIKES

Zgjedhjet 2019, Rama mbledh kryesinë e PS, ndan detyrat për sekretarët.

Spiropali: Opozita e bën betejën parlamentare në hotele me 5 yje



(Në foto) Kryeministri Edi Rama. Kreu i opozitës, Lulzim Basha



Në faqen 2-4

DIALOGU

Vuçiç shkel në Kosovë, brenda 2 javësh takim me Hashim Thaçin

Në faqen 9

VLORE

Dy të rinj të zhdukur prej dy muajsh, apeli: Na gjeni djemtë

Në faqen 7

MEMALIAJ

Alket Muho u vra nga kushërinjtë gjatë kohës që po kulloste bagëtitë

Në faqen 6

100-VJETORI I LINDJES

Burri shtatpaktë, Pashk Gjeçi: U hap dera dhe Dantja më la vetëm

Në faqen 12

LEGALIZIMET



**ALUIZNI: 350** personat që marrin lejen në Shkodër

Në faqen 10-11



Studimi i Aristotel Micit: Porti lumor i Vjosës, lidhje me detin

## Spinarica, porti detar i Apolonisë

Në brendësi: Një mësim nga nobelistja bjelloruse. Poezi nga Moikom Zeqo

NGA ARISTOTEL MICI

**D**isa vjet me parë, duke dashur të jepja mendimin tim rreth një porti detar të Apolonisë, e trajtova studimin në mënyrë hipotetike. Po me kalimin e kohës, duke vëzhguar fakte të reja,



gjellita detaje me interes dhe arrita në idenë se porti detar i Apolonisë nuk ishte më një iluzion hipotetik, po një realitet. Për të ndriçuar sado pak këtë ide, do të parashtrijmë në këtë trajtesë disa fakte konkrete ...

Suplement

## PARTIA SOCIALISTE RIORGANIZIMI

Qytetari e pyet kryeministrin ku ishte 5 vjet, përgjigja: Ia njoh damarët këtij vendi

# Rama: Besoj te njerzillëku i pushtetit, i pakënaqur me sa kemi bërë deri tani

"Ulëm taksat për 97% të shqiptarëve, vizitat te mjeku i bëmë falas"

Isha në krye të qeverisë kur për 600 mijë qytetarë të pasiguruar, vizita te mjeku i familjes u bë falas, hoqa taksën 10% të barnave dhe shërbimeve mjekësore, libra falas për 100640 fëmijë në nevojë dhe sot libra falas nga klasa e 1-4, ulëm taksat për 97% të shqiptarëve" iu përgjigj dje, kryeministri Edi Rama njërit prej qytetarëve që e pyeti se ku ka qenë këto 5 vjet. Në përgjigje të komentuesit në rrjetin social, Rama tha në rubrikën e re që ka hapur në "Facebook" se "Shqipëria bëhet nga 1 janari vendi ku 93% e biznesit paguan 5% taksë". Qytetari iu drejtua kryeministrit se "nuk mund të zhdukësh varfërinë e shqiptarëve, duke bërë dy apo tre vizita te familjet me vështirësi ekonomike". Në përgjigje të tij, kryeministri Rama shprehet se "vlerësimet e tua janë të pamërituara, sepse unë e kam bledhur më këmbë Shqipërinë sa të gjithë politikanët e marrë së bashku në afro 30 vitet e fundit". "Ia njoh gjymtyrët dhe damarët këtij vendi dhe jetoj me realitetin e njerëzve të zakonshëm të këtij vendi, sa nuk të vë dot faj as ty dhe as njeriun tjetër, deri sa nuk e ke idenë sesa gabon kur mendon të kundërtën. Pastaj sa i zoti jam që dhimbjen dhe shpresat që më ushqen kontakti i pandërprerë me realitetin t'i kthej në fuqi ndryshimi dhe në rezultate konkrete për njerëzit, kjo është një temë tjetër", u shpreh kryeministri. Duke qëndruar te komentit i qytetarit, Rama shprehet se "unë nuk kam se si mendoj se do të shuaj skamjen me vizitat në shtëpitë e atyre që jetojnë në kushte skamjeje, por unë nuk mendoj se as këto vizita janë humbje kohe, siç shkruan ti".

Kryeministri thotë: "Isha në krye të qeverisë kur për 600 mijë qytetarë të pasiguruar, vizita te mjeku i familjes u bë falas nga klasa e 1-4, ulëm taksat për 97% të shqiptarëve" iu përgjigj dje, kryeministri Edi Rama njërit prej qytetarëve që e pyeti se ku ka qenë këto 5 vjet. Në përgjigje të komentuesit në rrjetin social, Rama tha në rubrikën e re që ka hapur në "Facebook" se "Shqipëria bëhet nga 1 janari vendi ku 93% e biznesit paguan 5% taksë". Qytetari iu drejtua kryeministrit se "nuk mund të zhdukësh varfërinë e shqiptarëve, duke bërë dy apo tre vizita te familjet me vështirësi ekonomike". Në përgjigje të tij, kryeministri Rama shprehet se "vlerësimet e tua janë të pamërituara, sepse unë e kam bledhur më këmbë Shqipërinë sa të gjithë politikanët e marrë së bashku në afro 30 vitet e fundit". "Ia njoh gjymtyrët dhe damarët këtij vendi dhe jetoj me realitetin e njerëzve të zakonshëm të këtij vendi, sa nuk të vë dot faj as ty dhe as njeriun tjetër, deri sa nuk e ke idenë sesa gabon kur mendon të kundërtën. Pastaj sa i zoti jam që dhimbjen dhe shpresat që më ushqen kontakti i pandërprerë me realitetin t'i kthej në fuqi ndryshimi dhe në rezultate konkrete për njerëzit, kjo është një temë tjetër", u shpreh kryeministri. Duke qëndruar te komentit i qytetarit, Rama shprehet se "unë nuk kam se si mendoj se do të shuaj skamjen me vizitat në shtëpitë e atyre që jetojnë në kushte skamjeje, por unë nuk mendoj se as këto vizita janë humbje kohe, siç shkruan ti".



Kryeministri Edi Rama

rët si Hyseni Niko e të tjerë duhet të paguanin me lekë në dorë.

Isha në krye të qeverisë kur u hoq taksë 10% e barnave dhe e shërbimeve mjekësore. Isha në krye të qeverisë kur

numri i fëmijëve nga familjet të kategorive të ndryshme në nevojë që përfituan libra falas arriti në 100640, dhe jam sot në qeveri kur librat e shkollës shpërndahen falas nga klasa e parë deri në të katërtën", vijoi

më tej, Rama. "Isha në krye të qeverisë ku përveç librave u vendos kompensimi financiar me lekë në dorë për 59 mijë fëmijë për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike. Ku isha këto pesë vjet? Isha në

### VIZITA

Kryeministri Edi Rama mësohet se ka udhëtuar për në Nju Jork, pas mbledhjes së kryesisë së PS-së. Burimet pranë tij kanë bërë me dije se do të ketë disa takime zyrtare atje. Ende nuk është bërë publike ndonjë agjendë e kreut të qeverisë në SHBA.



Mbledhja e Asamblesë Kombëtare të PS-së

krye të qeverisë kur u hoq ndihma ekonomike e pjeshme dhe sot ka vetëm ndihmë ekonomike të plotë, e cila është trefish nga ç'ishte. Ishte 15-30 mijë katër vjet më parë, sot është 45-80 mijë dhe sot masa mesatare është 56 mijë. Është shumë pak, por është trefish nga ç'ishte. Isha në qeveri ku për 2600 të moshuar u vendos pension social, ndërkohë që deri atë ditë nuk merrnin një qindarkë nga shteti dhe ishin krejtësisht të braktisur", tha më tej,

Kreu i qeverisë, i prekur nga kjo pyetje. "Nuk dua të kujtoj njeri se po them se sa shumë janë bërë ndërkohë dhe janë mjaft për t'u bërë. Edhe pse raportet e BB për varfërinë e shënojnë qartësisht progresin e bërë, unë jam i pakënaqur me kaq. Nuk kam nisur t'i bëj tani këto vizita sot, i kam bërë edhe më parë, por do t'i bëj shumë më tepër dhe jo për filma, por për një arsye të thjeshtë, sepse unë besoj te njerzillëku i pushtetit", përfundon Rama.

### Kreu i Grupit të LSI mbron deputetin e përjashtuar nga PS

## Vasili: Rama doli kundër atyre që tha kur kandidoi për kryetar të PS

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së Petrit Vasili i ka dalë dje, në mbrojtje deputetit të përjashtuar nga PS, Gjetan Gjetani, duke i kujtuar kryeministrit Edi Rama ato që ai vetë kishte thënë në vitin 2013 kur kandidonte për kryetar PS-je. Përmes një statusi në "Facebook" Vasili theksoi se "Rama jargavitet e qurrepetet pas karriges se tij, kur një deputet nga te tija vetëm thotë ca të vërteta të rënda për krimin që po shkatërron vendin e çdo familje". Mes të tjerash Vasili e cilësoi Ramën 'kasap i së vërtetës', duke marrë shkas nga përjashtimi i deputetit të PS në Kurbin, Gjetan Gjetani nga



grupi parlamentar, se ky i fundit kritikoi Policinë e Shtetit. "Në vitin 2003 kur kandidonte për herë të parë për kryetar të Partisë Socialiste, ky Rama si me demok dashnor i të vërtetës që ishte deklaronte: "Duke parë se sa më shumë i fshihemi të vërtetës aq më pranë humnerës shkon pushteti i socialistëve të thjeshtë dhe jo pushteti i njeriut apo i tjetrit, kam vendosur të bëjë edhe këtë kandidim". Sot Rama vitit 2018, që jargavitet e qurrepetet pas karriges së tij, kur një deputet nga te tija vetëm thotë ca të vërteta të rënda për krimin që po shkatërron vendin e çdo familje, që i di i madhe i vogël në Shqipëri dhe janë në çdo tavolinë në Berlin, Bruksel dhe Washington, ky e përjashton atë që foli, ndërsa ky vetë kthehet në një kasap që hungërin e që do ta copëtojë dhe zhdukë me çdo kusht të vërtetën. Ja ç'do të thotë që të kesh një kryeministër të shndërruar në grupë septike parimesh dhe morali", u shpreh Vasili.

### Rama viziton familjen e varfër në Vlorë, i premtion zgjidhje

Shtatë anëtarë të familjes Ah Smeti jetojnë në këtë banesë gjysmë të shkatërruar. Kryefamiljari i pikëlluar tregon se jeta është e vështirë, ndërsa përfitojnë një ndihmë ekonomike prej 80 mijë lekësh. Kryefamiljari, Niko Ahmeti iu ankua kryeministrit: "Pa drita, pa ujë, pa rrugë. Marr një ndihmë ekonomike 80 mijë lekëshe". Kreu i qeverisë i shoqëruar edhe nga ministrja Ogerta Manastirliu, u shpreh se një zgjidhje për këtë familje do të jetë mbështetja për ta si fermerë, në mënyrë që të sigurojnë të ardhura. "Do bëjmë një plan për të asistuar për të marrë ndonjë mbështetje si fermerë për të bërë ndonjë blegtori të vogël. Do gjejmë një zgjidhje". Kryeministri u interesua nëse fëmijët shkollon në shkollë dhe qytetari shprehet se kanë mbaruar 8-vjeçaren. Njeri nga djemtë i shprehu kryeministrit dëshirën për të vazhduar shkollën profesionale për hidraulik.







Spiropali: Krerët e bashkive në territor, do të bëhet analiza

# Zgjedhjet 2019, Rama mbledh kryesinë, të detyrat për sekretarët e ministrat

*Parimet s'pengojnë rikandidimin e kryebashkiakëve me shumë mandate*

Një ditë pas Asamblesë Kombëtare, kryeministri nënshkruar edhe kryetar i Partisë Socialiste, Edi Rama mblodhi kryesinë dhe sekretariatit dhe partisë. Në një mbledhje të shkurtër, gati gjysmë orëshe, Rama sqaroi detyrat përkatëse për çdo të zgjedhur, një ditë më parë, por la edhe porositë për ministrat. Duke e cilësuar si një fazë të fillimit të përgatitjeve për zgjedhjet vendore të 2019, Rama u ka bërë të qartë deputetëve dhe ministrave të zbrasin në terren me njerëzit edhe pse s'apo u mbyllturi i logoridhënies së qeverisë. Pas mbledhjes së kryesisë së PS-së, sekretarja për Bashkëqeverisjen dhe Aleancat, Elisa Spiropali ka informuar mediën lidhur me atë që u vendos në mbledhje.

"Ndryshe nga opozita që betejën parlamentare ka vendosur ta bëjë në hotele me 5 yje, ne betejën tonë në PS në grup dhe qeveri kemi vendosur ta fokusojmë te njerëzit. Sot kemi një PS dhe një grup parlamentar kompakt për vizionin qeverisës, në bashkëqeverisje me qytetarët, kështu e kemi fituar betejën në koalicion me qytetarët dhe kështu do ta vazhdojmë", tha ajo. E pyetur nëse pas paralajmërimit të Ramës për vendorët është vendosur diçka sot në kryesia, ajo ka theksuar: "Krerët e bashkive dhe ekipet e tyre do të jenë në territor, pastaj do bëhet analizë për qeverisjen lokale në gjithë territorin"- tha ajo. Kryesia e PS-së dhe, nuk diskutoi në lidhje me përjashtimin e deputetit të Kurbinut, Gjetan Gjetani, i cili bëri deklaratë kundër policisë dhe për këtë u propozua përjashtimi nga kryeministri. E pyetur nëse është zyrtarizuar një vendim për përjashtimin e deputetit të PS-së, Gjetan Gjetani, Spiropali tha: "Nuk është kompetencë e kryesisë kjo. U diskutua në Asamble dhe ajo çështje u mbylltaty dhe pas largimit të gazetarëve ne votojmë formalisht për të gjitha vendimet e Asamblesë". Një ditë më parë Asambleja Kombëtare përcaktoi edhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për kryetarë bashkiakish. Parimet në të cilat do të mbështeten drejtuesit e



Anëtarët e Kryesisë së PS-së, dje pas mbledhjes

## SEKRETARIATI

Partia Socialiste ka bërë një formatim të plotë të sekretariatit të saj, duke sjellë emra të rinj dhe duke bërë një ndarje më të mirë të detyrave. Bie në sy përfshirja në sekretariat e zv. kryeministres Senida Mesi, si sekretare për Burimet Njerëzore, rifutja e Petro Koçit si dhe angazhimi si sekretar organizativ i Arben Pëllumbit.

lartë të PS-së për të përzgjedhur emrat e kandidatëve nuk do t'i pengojnë ata që të rikandidojnë një pjesë të krerëve aktualë. Kështu edhe pse disa prej tyre kanë disa mandate në krye të bashkive, ky mandat ruhet i pari, si shkak i ndarjes së re territoriale që sollë edhe ndryshimin e karakterit dhe territorit të bashkive që ata mbulojnë. Kështu

përparësi do të kenë më të aftët profesionalisht dhe ata që kanë integritet të lartë publik. Përfaqësimi në shoqëri, në angazhimin politik dhe në territorin e bashkisë, barazia mes burrave e grave, janë disa parime që do të respektohen. Një tjetër pikë është edhe kufizimi në kohë i mbajtjes së mandateve të përfaqësuesve nga njëjti person si dhe shmangia

e mbajtjes së disa funksioneve e përgjegjësive njëkohësisht nga njëjti kandidat. Një problematikë që ngriti kreu i PS-së, Edi Rama është edhe ajo e gjetjes së njerëzve me sa më reputacion të lartë në komunitet për këshilltarë bashkiakë, në mënyrë që të mos ndodhë që vendimet në këshillat bashkiakë të bllokohen.



## "Prokuroria dhe policia të bëjnë më shumë kundër krimin"

**Ambasadorja gjermane: Vetingu të japë më shumë rezultate konkrete**

Ambasadorja gjermane, Susanne Schutz foli për krimin nga Shkodra, qytetin që muajt e fundit ka qenë dëshmitar i disa ngjarjeve të rënda kriminale. "Shqipëria ka shënur përmirësime sa i takon luftës kundër krimin, por duhet të bëjë më shumë. Prokuroria dhe policia duhet të bëjë më tepër. Gjermania është e angazhuar që Shqipëria të integrohet në Bashkimin Europian. Do të kishim dashur që të hapeshin negociatat që në qershor, por Shqipëria duhet të bëjë më shumë në 5 prioritetet, në mënyrë të veçantë për krimin e organizuar", -u shpreh Susanne Schutz. Schutz foli edhe për vetingun. "Vetingu është një proces që po vijon në mënyrë pozitive, por duhet më shumë rezultate konkrete. Të gjitha vendet vakante në gjykata të mbushen sa më parë", -theksoi Schutz. Vizita e ambasadores në Shkodër vjen pas disa ngjarjeve kriminale në këtë qark, 6 të vdekur dhe 2 të zhdukur në dy muajt e fundit.

## Zbardhen porositë "sekrete" për krerët e PS në rrethe

**Anëtarësimet, objektivi i PS, 30 mijë pranime të reja deri në fund të dhjetorit**

Drejtuesit socialistë në rrethe duhet që deri në fund të dhjetorit të arrijnë objektivin për të shtuar me 30 mijë anëtarë të rinj regjistrin e anëtarësisë. Në raportin e publikuar në Asamblesë Kombëtare të PS-së thuhet se "Brenda 120 ditëve të ardhshme, deri në fund të muajit dhjetor 2018 anëtarësia e partisë të shohet me 30 mijë anëtarë të rinj". Përmes sloganit "Partia Socialiste është e hapur për ty", krerët e rretheve, deputetët, por edhe ministrat sipas delegimeve përkatëse nëpër qarqe do të duhet ta realizojnë këtë objektivi, veçanërisht pas kritikave të bëra edhe nga kryetari në Asamble. Në



raportin e paraqitur thuhet se "me gjithë pranimet e kryera në vitin 2017, rreth 9500, anëtarësia e partisë ka një rritje vetëm prej 0.3% më shumë se në vitin 2016, ndërsa në 8 qarqe pati ulje të numrit të anëtarësisë". Po

sipas këtij raporti 12 bashki kanë një rritje vetëm 1-2%. Në 9 bashki të tjera anëtarësia është rritur me 11-30%, ku më mirë paraqiten bashkitë Peqin, Patos, Kuçovë e Skrapar. Përveç shtimit të numrit të anëtarëve të rinj të partisë, sekretarët e PS-së dhe kryetari bëri të qartë se duhet një rritje cilësore, që do të thotë të afrohen njerëzit më të mirë, më të kualifikuar. Pasi të mbyllet aksioni i anëtarësimeve do të krijohet një bazë e përditësuar e të dhënave elektronike të PS-së. Për çdo javë, drejtuesit vendorë janë të detyruar të japin shifrat e anëtarësimeve në PS-së në nivelin qendror të PS-së.

**STRATI** Shoqëria përbarimorë "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shlyerjen e ankandit të pasurive të paluajtshme: "Apartment", me Nr. 11/23-1-22 pasurisë, me sipërfaqe 73 m<sup>2</sup>, Zona Kadestrale 8603, vëllimi 36, faqe 45, regjistruar faqe 92, regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë në pronosi të Shoqërisë "Evi Konstruktion" Sh.p.k. Çmimi fillësor i ankandit është 20.440 Euro. "Apartment", me Nr. 11/23-1-23 pasurisë, me sipërfaqe 73 m<sup>2</sup>, Zona Kadestrale 8603, vëllimi 36, faqe 93, regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë në pronosi të Shoqërisë "Evi Konstruktion" Sh.p.k. Çmimi fillësor i ankandit është 20.440 Euro. "Njesi", me Nr. 11/23-N11 pasurisë, me sipërfaqe 26 m<sup>2</sup>, Zona Kadestrale 8603, vëllimi 36, faqe 45, regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë në pronosi të Shoqërisë "Evi Konstruktion" Sh.p.k. Çmimi fillësor i ankandit është 14.560 Euro. Ankandit për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 13.09.2018. Ankandit për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përbarimorë "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 1411, Shkollë 1, Ap. 7, Tirana, Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

Kreu i PD-së publikon 5 fakte për kontrollin e pasurisë së politikanëve

# Basha: Vetingu të përcaktohet në Kushtetutë e të miratohet me 93 vota

Enkelejd Alibeaj: Jemi në emergjencë kombëtare

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha ka renditur dje, në një video "5 fakte", që sipas tij, duhet të dihen nga publiku, për vetingun në politikë. Në këtë material të shpërndarë në rrjetin social, "Facebook", Basha shprehet se "vetingu është skaner për deputetë, ministrat dhe zyrtarët e lartë në Shqipëri, përfshirë këtu edhe vetë kryeministrin". Në pikën e dytë ai përcakton se "vetingu do largojë politikanë që kanë lidhje me grupe me rekorde të tmerrshme kriminale". "Vetingu do largojë politikanët që nuk e justifikojnë pasurinë e tyre. Vetingu duhet të parashikohet në Kushtetutë dhe të miratohet nga 93 deputetë", shprehet më tej, kreu i opozitës, ai shtoi se "PD ka depozituar draftin në Kuvend në datën 7 shtator".

Partia Demokratike bëri publike të premtën ndryshimit kushtetues, me anë të cilave kërkohet t'i nënshtrohen procesit të vetingut të gjithë politi-

## TË PËRNDJEKURIT

"Edi Rama godet sërisht ish-të përndjekurit politikë dhe të dënuarit nga komunizmi, duke reduktuar fondin për dëmshpërblimet dhe duke i vënë këto para në dispozicion të koncesioneve korruptive dhe PPP-ve që u jep familjarët dhe miqtë e tij. Ligji injoron rregullat e trashëgimisë dhe parashikon që pjesën takuese të familjarit që nuk jeton e zhvat Rama, duke e futur në buxhetin e shtetit për ta përdorur për koncesionet korruptive të tij", tha dje, Alibeaj.

kanët, duke filluar nga kryeministri, ministrat, deputetët dhe drejtuesit e institucioneve kushtetuese, të cilët janë emëruar nga parlamenti. Nga ana e tij, kryeministri Edi Rama u shpreh dakord. Në fjalën e tij, në Asambleenë Kombëtare të PS-së, Rama i propozoi kundërshtarit të tij të takohen dhe madje vetingun ta nisnin nga vetë ata, duke përfshirë edhe familjet e tyre, të presidentit, fëmijët e ish-kryeministrit. Ndërkohë dje, pasdite, i ftuar në emisionin "Kjo javë" me Nisida Tufën në "News24", deputeti demokrat Enkelejd Alibeaj tha se kjo nisje e PD-së do

të ndihmojë në pastrimin e politikës nga krimi. Deputeti i PD ka shpjeguar edhe ndryshimin mes dekriminalizimit dhe vetingut në politikë. "Krimi mbështetet nga politika, dhe nuk goditet nga drejtësia. Jemi në emergjencë kombëtare. Na duhet veting në politikë. PD ka denoncuar lidhjet e politikës me krimin. Dekriminalizimi lidhjet me pastërtinë e figurave politike, zyrtarëve krerëve të bashkive, dhe ka dhënë rezultate. Padyshim që ka ende për të bërë. Në situatën ku jemi sot, ku ka politikanë me lidhje të forta me persona të dënuar, apo të përfshirë në krim, duhet të kalo-

het në një fazë të dytë të procesit. Jo vetëm që nuk duhet të kemi deputetë, ministër, zyrtarë, të dënuar e të lidhur me krimin, ashtu edhe nuk duhet të kenë kontakte me persona të tillë. Shqiptarët vetë e dinë se cilët politikanë janë të lidhur me krimin, e dinë cilët janë politikanët që e mbështetin krimin, që i krijojnë hapësira, në Durrës, Elbasan, Shkodër", -tha deputeti demokrat. I pyetur nëse do të verifikohet pasuria e politikanëve, deputeti demokrat thotë se PD ka propozuar një proces vetingu në politikë si ai në drejtësi, pra verifikim edhe i figurës, edhe i pasurisë. Sa i takon procesit të vetingut në gjyqësor, Alibeaj tha se opozita kërkon "që të mos krijohen me ligj mjetet nga mazhoranca që të kapë sistemin e drejtësisë".



Takimi

## PRESIDENTI

Ndërsa presidenti serb Aleksandër Vuçiç vijon vizitën në Kosovë, lideri i partisë opozitare Vetëvendosje, Albin Kurti vijon takimet në Shqipëri. Sot Kurti ka zgjedhur të drekojë me Presidentin Ilir Meta në Karpen të Kavajës. Në fokus të takimit mendohet të ketë qenë vizita e Vuçiç në Kosovë. Albin Kurti është takuar edhe me ish-kryeministrin Sali Berisha dhe kreun e PD, Lulzim Basha.

## Reagon ministria: PD hedh baltë mbi policinë

Ngjarja në Lezhë, PD: Policia e tradhtuar nga Ministria e Brendshme



Partia Demokratike deklaroi dje, përmes deputetit Ervin Saliqaj se policia sot është e tradhtuar nga segmente kriminale brenda Ministrisë së Brendshme. Ervin Saliqaj denoncoi një rast në qarkun e Lezhës, ku sipas tij persona të arrestuar për armëmbajtje pa leje janë lënë të lirë me urdhër politik. "Njësoj si në rastin e Shkodrës, ku për 6 vrasje dhe 2 rrëmbime nuk ka autor, edhe për shkëmbimin e zjarrit në Lezhë, krimi ka dalë mbi forcën e ligjit. Pavarësisht se policët e thjeshtë, ata që po i nënshtrohen vetingut, kanë kryer të gjitha veprimet procedurale, kriminelët janë liruar pas një telefonate nga ministria që drejton Fatmir Xhafaj, i cili refuzon t'i nënshtrohet vetingut njësoj si policët", tha Saliqaj. Pak orë pas deklarimit për mediat të deputetit demokrat, Ervin Saliqaj, për veprimet e policisë së Lezhës, ka ardhur edhe përgjigjia nga ministria e Brendshme. Në një njoftim zyrtar për

mediat, ministria e Brendshme sqaron se më datë 6 shtator, në orën 23:37 minuta ka ardhur një telefonatë se nga një makinë është qëlluar me armë në zonën e "Ranës së hedhun". Menjëherë pas lajmërimit, është ndaluar mjeti, në të cilin ndodheshin 3 persona, bën

me dije ministria. Më pas është gjetur një armë pistoletë, por që pas ekspertimit ka rezultuar se nuk ka qenë armë zjarri, por armë simuluese. Dosja i ka kaluar prokurorisë, thuhet në njoftim, por rasti në fjalë nuk përbën kundërvajtje penale.



## INVITATION TO TENDER

### REHABILITATION OF THE TWO PRIMARY HEALTH CENTRES IN VORA AND SAUK

The Health for All Project (HAP) in Albania is funded by Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) of the Swiss Government and is being implemented by a consortium of three organizations: the Swiss Tropical and Public Health Institute (SwissTPH), and the two NGOs: Terre des hommes (TdH) and Save the Children (SC) through HAP Centre. Its overall goal is that the Albanian population, benefit from better health due to improved primary health care services and health promotion activities.

HAP will rehabilitate two primary health care centers; one health center in Vora, in the municipality of Vora and the second health center in Sauk, in the municipality of Tirana. In the context of this initiative, HAP Centre is requesting offers from companies interested to carry out those rehabilitation works.

The required documents, forms, technical specifications and annexes for the bidding can be found in the HAP web site link: <http://www.hap.org.al/opportunities-for-cooperation-2/>

The interested Companies should express their interest in participating in this tender by sending an email to [info@hap.org.al](mailto:info@hap.org.al) until 14<sup>th</sup> of September 2018.

The interested Companies **must participate** in the site visit to take place within **third week of September 2018**. The details of place and time of the visit will be given to the interested Companies within 17<sup>th</sup> of September 2018.

The bidding Companies should submit their offers to HAP Centre **no later than end of business day on the 5<sup>th</sup> of October 2018**.

The offer should include:

1. Letter of interest (see Appendix 4.2);
2. The BoQ Excel sheet provided with the tender documents, filled with the respective prices and totals (BoQ template provided in Appendix 2.1);
3. The financial offer in correspondence with the subtotals and total amounts in the BoQ (Format provided in Appendix 2.0);
4. CV of the company (with proves of the experience of the company in carrying out similar works);
5. CVs of directors of the Company;
6. CV of technical team directly responsible for the coordination of the works and to will be deployed to do the work sites (see Appendix 4.2 and Appendix 4.3);
7. The time table of the works with a brief narrative of the timing and sequence of the jobs to be carried out (see Appendix 4, Appendix 4.1);
8. Copy of the registration and license of the company;
9. Copy of its status with the tax authorities and confirmation of Tax Authorities for having No obligations;
10. Document from the bank as a proof of its commercial links and sound finance (within the required limit for such works, see Appendix 4.2);
11. For the preparation of the offers, the companies will be obliged to visit the site, verify and make its own measurements; a short report of the visit should be added to the offer.

The application should be sent in sealed envelope **no later than end of business day on the 5<sup>th</sup> of October 2018** to the address:

Subject: **REHABILITATION OF THE TWO PRIMARY HEALTH CENTRES IN VORA AND SAUK**  
Procurement Team  
HAP Centre  
Rruga "Themistokli Gërmenji", Pallati Helios, Kati II, Ap.1, Tirana, Albania  
E-mail: [info@hap.org.al](mailto:info@hap.org.al); Website: [www.hap.org.al](http://www.hap.org.al)



Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve paralajmëron subjektet me xhiro nën 2 mln lekë

# Tatimet, biznesit: Kujdes me gabimet në kasë, do ju fusim në TVSH

## Skema e tatimit për bizneset e vogla

Ornela Manjani

Bizneset e vogla, që qarkullojnë më pak se dy milionë lekë rrezikojnë të futen në skemën e TVSH-së nëse nuk raportojnë shtypjet e gabuara të kasës fiskale. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka tërhequr vëmendjen e të gjithë tatimpaguesve të biznesit të vogël pa TVSH, me qarkullim vjetor nën 2 milionë lekë që të tregojnë kujdes në lidhje me raportimin e shtypjeve gabim të pajisjeve fiskale që kanë në përdorim. Drejtoria e Riskut në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, nga verifikimi i të dhënave të xhirove të raportuara nga pajisjet fiskale, ka konstatuar se shumë subjekte të biznesit të vogël pa TVSH, raportojnë vlera jashtë normalitetit të aktivitetit të tyre, kryesisht si pasojë e shtypjeve gabim të pajisjeve fiskale. Administrata Tatimore, bën me dije se është detyrim i tatimpaguesve që të reklamojnë të gjitha shtypjet gabim të pajisjeve fiskale pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore, ku subjekti ushtron aktivitetin, sipas procesverbalit përkatës. Çdo mosraportim i shtypjes së gabuar të pajisjes fiskale nga tatimpaguesit, sjell ndryshim nga ana e administratës tatimore, bazuar në të dhënat që disponon, të përgjegjësisë tatimore nga ajo ekzistuese në përgjegjësi tatimore "Biznes i vogël me TVSH". Administrata Tatimore, mbetet e angazhuar të informojë me korrektesë




si tatimpaguesit mbi të drejtat dhe detyrat tatimore që atyre u lindin, përfundon njëoftimi i tatimeve.

**DETYRIMET TATIMORE**

Tatimet kanë dhënë fillimisht informacion në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e personave juridikë që kanë një xhiro vjetore të biznesit nga 0 deri në 2 milionë lekë. 'Person juridik' quhet një Shoqëri Tregtare që preferon të bëjë biznes si person juridik dhe jo si individ per-

son fizik; harton një statut të shoqërisë si individ/person juridik ose me individë të tjerë/persona të tjerë juridikë; dhe merr përgjegjësi për detyrimet e krijuara gjatë ushtrimit të veprimtarisë me të gjitha pasuritë e biznesit. Personi juridik regjistrohet si i tillë në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Nëse një Person Juridik ka një xhiro vjetore të biznesit nga 0 deri në 2 milionë lekë ai nuk është subjekt i TVSH-së (përveç kur blen mallra ose shërbime impor-

ti për t'i shitur ose ushtron profesion që i nënshtrohet TVSH-së pavarësisht xhiros) dhe Tatimit mbi Fitimin, por ka detyrime për të deklaruar dhe paguar Kontributet e Sigurimit Shoqëror dhe Shëndetësor; Tatimin mbi të Ardhurat nga Punësimi dhe Tatimin në Burim (nëse i ka si përgjegjësi tatimore) si dhe ka detyrimin për të deklaruar Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin. Për këtë kategori Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin është me shkallë 0%.



### Çmimet e importit, sërish në rënie për tremujorin II

Çmimet e produkteve industriale të importit janë ende në rënie. Të dhënat INSTAT treguan këtë javë se indeksi i çmimeve të importit ra me 1.2% në tremujorin e dytë të këtij viti, duke konfirmuar presione shumë të dobëta nga jashtë për inflacionin në vend. Për të tretin vit radhazi, çmimet e importit po qëndrojnë në territor negativ, çka tregon për presione të dobëta inflacioniste nga jashtë. Rënia e çmimeve të importit ngelet kryesisht rrjedhojë e çmimeve të ulëta të lëndëve të para dhe kërkesës ende të brishtë në tregjet botërore. Megjithatë, në tremujorët e fundit kjo tendencë është theksuar edhe nga mbicimi i lekut në kursin e këmbimit valutor. Forcimi i lekut ka qenë veçanërisht i theksuar në tremujorin e dytë dhe besohet se efekti në rënie e çmimeve të importit të ketë qenë i konsiderueshëm. Në ekonominë shqiptare, kjo është përcjellë në çmime ndjeshëm më të lira importi në produktet e degëve kryesore të ekonomisë, nga industrisë përpunuese, te ajo nxjerrëse dhe te sektori i energjisë. Rënia me 0.8% e çmimeve të industrisë përpunuese ka qenë vendimtare në tendencën e indeksit të çmimeve të importit. Rënia e çmimeve ishte veçanërisht e theksuar për energjinë, me 7.3% më pak krahasuar me një vit më parë.

## Siguracionet e makinave, jo më pa prerë kuponin tatimor

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve i bën me dije shoqërive të sigurimit, risigurimit dhe agjentëve të tyre, detyrimin për përdorimin e pajisjeve fiskale, që buron nga ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" dhe më konkretisht nenin 54 dhe 55. Këto shoqëri e kanë këtë detyrim, si tatimpagues për përdorimin e pajisjeve fiskale, pavarësisht se janë institucione financiare. Në dispozitat ligjore të referuar më sipër përcaktohet se: "Të gjithë tatimpaguesit e shtypjeve me pakicë, që shesin mallra apo ofrojnë shërbime në mjedisë apo njësi të përhershme, të



hapura për publikun, duhet të instalojnë pajisje fiskale dhe të lëshojnë kupona tatimorë për çdo transakcion. Subjektet, që detyrohen të lëshojnë kupona tatimorë lëshojnë njëherazi edhe faturë, nëse shitja apo shërbimi i kryer është për një përdorim tregtar dhe, për këtë shkak, blerësi është i

detyruar ta kërkojë faturën. Gjithashtu, në nenin 55, pika 1, përcaktohet se: "Tatimpaguesit, që kryejnë qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve, për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës, janë të detyruar të instalojnë dhe të përdorin sistemin fiskal, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiskale, për regjistrimin e pagesave me para në dorë dhe për lëshimin, në mënyrë të detyrueshme, të kuponit tatimor". Qëllimi i Administratës Tatimore është trajtimi i njëjtë dhe në mënyrë të barabartë i të gjithë tatimpaguesve, si dhe respektimi korrekt e i njëjtë i dispozitave ligjore nga ana e tyre.

## Tregu i fruta-perimeve, monopol, Autoriteti i Konkurrencës nis hetimin

Magazinimi dhe tregtia me shumicë e produkteve agrourbore në Tiranë është në një situatë monopol sipas Autoritetit të Konkurrencës. Ky institucion vlerëson se i vetmi treg është ai në hyrje të autostradës Tiranë-Durrës. Nga hetimi rezulton se ndodhemi në një situatë urgjence për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të paraparueshëm për konkurrencën në këtë treg. Abuzimi vërehet në çmimet e qirasë që janë disa herë më të larta se çmimet e aplikuar në këtë zonë, ndërkohe që tregtarët nuk kanë alternativa të tjera për të marrë mjedisë me qira. Norma e fitimit, sipas



raportit të Autoritetit të Konkurrencës është mjaft e lartë nga qiratë që aplikohen. Tjetër abuzim është ai me çmimet e energjisë dhe ujit që u faturohen tregtarëve, duke aplikuar tarifa më të larta se ato të vendosura nga Entet Rregulluese. Autoriteti i konkurrencës ka vendosur që kompania pronarë e tregut të hartojë kontrata të reja qiraje duke përdorur kushte të barabarta mes palëve. Po ashtu duhet të aplikojë çmime të arsyeshme të orientuara drejt kostos dhe çmimit mesatar të qirasë të zonës gjeografike dhe të ndalojë menjëherë faturimin e energjisë ujit më tarifa më të larta se çmimi ligjor i OSHEE dhe ujësjellësit të Tiranës. Brenda 30 ditësh nga marrja në dëni e vendimit kompania duhet të paraqesë pranë Autoritetit të Konkurrencës Kontratën e rishikuar të qirasë, në zbatim të pikave të mësipërme. Në rast të kundërt Komisioni i Konkurrencës vendos gjoba periodike deri në 5% të xhiros mesatare ditore të vitit financiar paraardhës, deri sa ndër-marrja të veprojë në përputhje me këtë vendim.



## Arrestohet i "forti" i Shijakut me pistoletë me mulli dhe automatik me silenciator

**SHIJAK** - Policia e Shijakut ka arrestuar një 42-vjeçar, pasi është kapur duke lëvizur me pistoletë pa leje. Në pranga ka përfunduar Artur Prolla 42 vjeç, të cilit gjatë kontrollit në banesë i është gjetur edhe një automatik me silenciator. Burime zyrtare nga policia lokale bënë me

dije se Prolla është prangosur mbremjen e së premtes gjatë operacionit të koduar "Smith 2". Sipas bluve, këtij shtetasi në vendin e quajtur Koxhas/Kodër, gjatë kontrollit fizik iu gjet dhe iu sekuestrua në cilësinë e provës materiale një pistoletë "SMITH & WESSON" me mulli dhe me 5

fishkë kalibri 38 mm. Ndërsa, gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e tij iu gjet dhe iu sekuestrua dhe një automatik tip Skorpion M-84 me silenciator, me një krehër me fishkë. "Nga ana e uniformave blu po punohet për dokumentimin e veprimtarive të tjera kriminale ku

dyshohet se është i përfshirë ky shtetas. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për veprime të mëtejshme për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit" parashikuar nga neni 278/1 dhe 4 të Kodit Penal", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

Brikena Metaj


TEPELENË

Dy ditë pas vrasjes me plumb në kokë të 43-vjeçarit Alket Muho, "News24" dhe "Gazeta Shqiptare" udhëtuan drejt fshatit të thelle malor të Rabie në Memaliaj ku ndodhi ngjarja e rëndë. Mësohet se Muho u qëllua për vdekje teksa po kulloste bagëtitë. Konfliktet disa vjeçare mes tij dhe kushërinjve për çështjet e pronës (një rrugë) çuan drejt aktit makabër. Policia vuri në pranga dy autorët e krimit, Hetem Muhon dhe djalin e tij 20-vjeçar. Alket Muho u vra barbarisht ndërsa ishte duke kullotur tufën e bagëtive, që i sillnin të vetmet të ardhura për familjen prej tre anëtarësh në fshatin e largët Rabie, që administrativisht i takon bashkisë Memaliaj. Fshati i fshehur mes maleve, në një terren tepër të thyer malor ka shumë pak shtëpi të banuara, të shpërndara në pyllin e dendur. Viktima jetonte me bashkëshorten dhe djalin e mitur 5-vjeçar në një kasolle të ndërtuar me dërrasa, ku skamja dhe mizerja flasin në çdo cm. Kjo hapësirë shërbente për gjithçka. Një krevat, një divan i vjetër ku flinte fëmija i vogël, një televizor mbi komodinë dhe një sobë druri ishin pasuria e tyre, ndërsa brenda ishin ende të nderura rrobat e lara. Alket Muho u masakrua me rreth 10 plumba për një rrip toke që lidhte dy banesat e vetme në atë hapësirë, tokë që Muho e shfrytëzonte për të nxjerrë bagëtitë në tokat e familjes për t'i kullotur. Prej vitit 2013 familja e Alketit dhe e kushërinjve të tij, ishin në konflikt të vazhdueshëm. Viktima njihej si njeri gjaknxehët dhe agresiv. Ndër vite mes dy familjeve nuk kanë munguar përplasjet fizike dhe as përballjet gjyqësore, deri sa mesditën e 6 shtatorit 2018 konflikti përfundoi tragjikisht. Babë e bir, 59 dhe 20 vjeç, ekzekutuan në

Në fshatin Rabie, ku viktima jetonte me gruan dhe djalin e mitur në skamje

# Ngjarja në Memaliaj, Alket Muho u ekzekutua teksa kulloste bagëtitë

## 43-vjeçari u vra nga kushërinjtë për një rrugë



Banesa e 43-vjeçarit të vrarë Alket Muho



Vendi ku ndodhi vrasja

mënyrë makabre të afërmin e tyre, 43-vjeçarin Alket Muho. Jeta e vësh-tirë e Alketit në këtë fshat të largët u mbyll kështu, mes maleve, në tokën për të cilën gjithë jetën u konfliktua me të afërmit. I

ardhur nga një divorc, me dy fëmijë, një 15 vjeç nga martesa e parë dhe 5-vjeçarin e mitur nga martesa aktuale, ai u la si të vetmen pasuri 50 krezë bagëti e imët dhe një rrip toke që i mori jetën.



### ARRESTIMI I AUTORËVE

Burime zyrtare nga policia vendore e Gjirokastrës bënë me dije mbremjen e së premtes se pas hetimeve intensive u bë e mundur arrestimi i autorëve të krimit: Hetem Muho 59 vjeç dhe Dino Muho, 20 vjeç, banues në Sarandë. "Ndalimi i tyre, (babë e bir) u bë pasi dyshohet se në bashkëpunim me njëri-tjetrin, të enjten rreth orës 11:35, kanë vrarë me armë zjarri shtetasin A.M., 43 vjeç, banues në fshatin Rabie. Nga tërësia e veprimeve dyshohet se dy autorët e kanë vrarë shtetasin A.M. për shkak të konflikteve të përsëritura me motive pronësie, në fshatin e origjinës së autorëve", thuhet në njoftimin e policisë.

### SHKURT

**Plagosi me thikë pronarin e lokalit, pranga 40-vjeçarit**

**DIBËR** - Një konflikt për motive të dobëta ka degeneruar deri në përdorimin e thikave dhe për plagosuri dhe agresori nisën të konfliktoheshin në lokal. Sapo u njoftuan për ngjarjen, blutë shkuan në vendin e ngjarjes, ku kanë konstatuar se në lokalin e shtetasit me inicialet B.C, ky i fundit po konfliktohej me shtetasin me inicialet B.B, 40 vjeç. Gjatë përleshjes ka mbetur i plagosur rëndë me mjete të ftohta (thikë) pronari i lokalit. Ky i fundit u transportua me helikopter për ndihmë më të specializuar në Tiranë. Nga kryerja e veprimeve të para hetimore nga grupi hetimor dyshohet se konflikti ka nisur për motive të dobëta (grindje e çastit) ndërmjet dy shtetasve.

Pas ngjarjes autori i dyshuar është larguar, por falë reagimit në kohë të strukturave të DVP Dibër, është bërë e mundur gjetja, kapja dhe shoqërimi në ambientet e policisë, i të dyshuarit B.B, i cili rezultoi i dëmtuar lehtë gjatë konfliktit. Vijon puna për dokumentimin e plotë të ngjarjes.

## Kapen me armë dhe drogë, ja si u zbuluan dy shqiptarët në Itali

**ITALI** - Policia italiane ka arrestuar dy shqiptarë, të cilët akuzohen si pjesë e një rrjeti kriminal. Dy shqiptarët me inicialet S.A., 33-vjeç dhe T.E., 34 vjeç u kapën pranë shtëpisë në Via Giuseppina, pasi bënë lëvizje të dyshimta. Gjatë kontrollit në banesë, policia gjeti armë dhe drogë, ndërsa kishte



kohë që i gjurmonte dhe përgjonte dy shqiptarët. Ata kanë befasuar policinë

me justifikimin për armët. Njeri nga shqiptarët tha se e mbante për t'u vetëmbrojtur, ndërko-hë që tjetri, tha se as e kishte idenë që në banesë kishte armë funksionale. Ata ishin pjesë e krimit të organizuar të shqiptareve të zonës dhe frekuentonin mjedise të veçanta të përfshira në prostitucion.



Policia: Pas denoncimit po punojmë me intensitet për gjetjen e tyre

VLORE

Dy të rinj nga Vlorë janë deklaruar të zhdukur nga familjarët e tyre, prej më shumë se 2 muajsh, ndërkohë që ende nuk dihet fati i tyre. Bëhet fjalë për 34-vjeçarin Albano Xhaferri dhe Elvis Troqen, të cilët janë larguar nga banesat e tyre në muajt qershor dhe korrik të këtij viti dhe që prej atëherë nuk janë kthyer më. Zhdukja e dy të rinjve është bërë publike vetëm falë denoncimit të prindërve të tyre. Burime për "Gazeta Shqiptare" bënë me dije fillimisht është zhdukur Albano Xhaferri dhe më pas shoku i tij, Elvisi. Babai i Albanos, Lutfi Xhaferri tregoi dje me detaje për "News 24" dhe "Gazeta Shqiptare" për zhdukjen misterioze të të birit. Ai tha se kishte vetëm pak muaj që djali i tij 34-vjeçar ishte kthyer nga Belgjika ku kishte jetuar për një periudhë kohe. Gjithashtu, ai u shpreh se për të fundit herë e ka parë të birin mbrëmjen e 18 qershorit rreth orës 23:00, kur një makinë erdhi dhe e mori për ta çuar në shtëpi. "Erdhi një djalë, një makinë. S'ka marrë as pasaportë, asgjë. Kjo ndodhi rreth orës 11:00 të darkës. Thonë për njërin që e mori. Lajmëruam djalin tonë, tjetrin, erdhi nja 8-9 ditë e pa që s'berë gjë dhe iku", pohoi Lutfi Xhaferri. Zhdukja e babait të dy fëmijëve është denoncuar vetëm pak ditë më pas në policinë e qytetit bregdetar, por më kot, pasi nuk ka asnjë të dhënë për fatin e tij. Ndërsa në korrik është zhdukur dhe Ervis Troqe. Dy të rinjtë kanë pasur njohje njëri me tjetrin, pasi kanë qëndruar për disa muaj në Belgjikë. Për të dyja rastet policia lokale nuk ka asnjë informacion, megjithatë burime të besueshme pohuan për "Gazeta Shqiptare" se ka dyshime të forta se dy personat e zhdukur janë përfshirë në ngjarje kriminale.

# Dy të rinj nga Vlorë të zhdukur prej dy muajsh, prindërit apel policisë: Na gjeni djemtë

## Albano Xhaferri dhe Elvis Troqe njiheshin, kanë qëndruar disa muaj në Belgjikë



Lutfi Xhaferri duke folur për 'GSH'



34-vjeçari i zhdukur Albano Xhaferri

Bëhet fjalë për një përplasje mes dy grupeve kriminale në qytetin bregdetar, ç'ka ka shkaktuar viktima kohët e fundit. Më 3 shtator ish-kryeministri Sali Berisha postoi një mesazh të atij që quante "prindi digital", ku denoncohej humbja e djalit. "Doktor përshëndetje jam një prind që më ka humbur djalin në Vlorë, ka dy muaj, e kanë marrë. Bëj denoncim në Vlorë, policia e Vlorës nuk vepron, vetëm ju mund të më ndihmoni. E di shumë mirë kush ma ka marrë djalin dhe nuk po bëhet asgjë" shkruante prindi i njërit prej të zh-

**POLICIA**

Prindërit e dy të rinjve të zhdukur Albano Xhaferri dhe Elvis Troqe kanë shkuar disa herë në policinë e Vlorës, ku kanë përsëritur apelin që të intensifikohen kërkimet për djemtë e tyre. Ndërkaq, policia ka bërë me dije se që prej denoncimit të familjarëve të dy personave në fjalë po punon me intensitet për gjetjen e tyre.

**MESAZHI I BERISHËS**

Më 3 shtator ish-kryeministri Sali Berisha postoi një mesazh të atij që quante "prindi digital", ku denoncohej humbja e djalit. "Doktor përshëndetje jam një prind që më ka humbur djalin në Vlorë, ka dy muaj, e kanë marrë. Bëj denoncim në Vlorë, policia e Vlorës nuk vepron, vetëm ju mund të më ndihmoni. E di shumë mirë kush ma ka marrë djalin dhe nuk po bëhet asgjë" shkruante prindi i njërit prej të zhdukurve duke kërkuar të mbetet anonim.

dhukurve duke kërkuar të mbetet anonim. Prindërit e dy të rinjve kanë shkuar disa herë në polici, ku

kanë përsëritur apelin që të intensifikohen kërkimet për djemtë e tyre. Ndërkaq, policia ka bërë

me dije se që prej denoncimit të familjarëve po punon me intensitet për gjetjen e tyre.

**Precedenti, zhduken dajë e nip në Shkodër**

Që prej datës 23 gusht rezultojnë të zhdukur dy persona në Shkodër: Gëzim Hysaj banues në njësi administrative Postribë dhe Agron Mollaj, në fshatin Dobraq të njësisë administrative "Rrethina" kanë dalë nga banesat e tyre dhe nuk janë kthyer më. Të dyja familjet nuk kanë asnjë ide se ku ndodhen 56-vjeçari Hysaj dhe 47-vjeçari Mollaj (janë dajë e nip). Kanë qenë bashkëshortet e dy personave në fjalë që kanë bërë denoncim në policinë vendore të Shkodrës. Pas kallëzimit policia ka nisur kërkimet për dy shtetasit e zhdukur: Bashkëshortja e Gëzimit Hysaj, Saimira dhe bashkëshortja e Agron Mollaj, Merita në një intervistë dhënë dhjetë ditë më parë për "Gazeta Shqiptare" kanë treguar me detaje se si janë larguar këta dy persona nga banesat e tyre me 23 gusht dhe se si pas një ore telefoni i Gëzimit ka dalë i fikur; ndërsa Agroni nuk kishte fare telefon me vete. Të dyja gratë i kanë bërë apel policisë për gjetjen e bashkëshortëve të tyre.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
 SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Rinovimi i suportit vjetor të HP Data Protector"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 3,450,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
 BIC: STANALTR  
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Rinovimi i suportit vjetor të HP Data Protector"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **04 Tetor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
 SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje e suportit vjetor per serverat e tipit Lenovo / IBM System te Bankes se Shqiperise"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,520,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
 BIC: STANALTR  
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje e suportit vjetor per serverat e tipit Lenovo / IBM System te Bankes se Shqiperise"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **03 Tetor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

## PENSIONET E PLEQËRISË KOMPENSIMET MUJORE

Voltiza Duro

Të gjithë individët që marrin pension pleqërie, invaliditeti apo familjare, në masën e plotë apo edhe të pjesshme mund të përfitojnë një kompensim të të ardhurave mujore deri në 760 lekë. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot të gjitha kriteret që duhet të përmbushin të moshuarit për të marrë këtë pagesë kompensuese si në qytet edhe në fshat. Kështu kanë të drejtë të përfitojnë deri në 760 lekë në muaj, të gjitha pensionet e pjesshme të pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare, që përfitojnë një masë pensioni më të vogël se pensioni bazë. Kjo për llogaritet si raport i produktit të shumëzimit të pensionit të caktuar me 760 lekë dhe ajo që del pjesëtohet me pensionin bazë. Gjithashtu, këtë kompensim mujor e marrin edhe individët që përfitojnë pensione të plota minimale të pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare si dhe ata që marrin pensione të pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare, që e kanë kufirin deri tek shuma e pensionit të plotë bazë minimal plus 500 lekë, në zbatim të VKM nr. 401. Kjo e ardhur është pjesë përbërëse e të ardhurave nga pensioni dhe përfitohet së bashku me pensionin.

**KOMPENSIMI PËR PENSIONIN E FSHATIT**

Në buxhetin e shtetit parashikohet kompensimi deri në 690 lekë edhe për të ardhurat mujore të pensioneve të fshatit për të gjithë ata që marrin pension pleqërie, invaliditeti dhe familjar fshatit. Përfitues nga ky kompensim mund të jenë të gjithë ata që marrin pensione të pleqërisë të plota dhe të pjesshme, ata që përfitojnë pension invaliditeti të plotë, të reduktuar apo të pjesshëm si dhe ata që marrin pension familjar të plotë ose të pjesshëm. "Përfitohet: a) Deri në 690 lekë në muaj, të gjitha pensionet e pjesshme të pleqërisë, të invaliditetit dhe familjar, që përfitojnë një masë pensioni më të vogël se pensioni bazë. Kjo llogaritet si raport i produktit të shumëzimit të pensionit të caktuar me 690 lekë dhe prodhimi që del, pjesëtohet me pensionin bazë të miratuar; b) 690 lekë në muaj, të gjitha pensionet e plota minimale të pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare; c) Deri në 690 lekë në muaj, për të gjitha pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe familjar, që e kanë kufirin deri tek shuma e pensionit të plotë bazë minimal plus 690 lekë, dhe nga kjo shumë zbresim pensionin e caktuar brenda këtij kufiri; d) Kjo e ardhur është pjesë

Kriteret dhe dokumentacioni që duhet të dorëzojnë të moshuarit. Kompensimi i energjisë elektrike

# Pensionistët në fshat dhe qytet, kush përfiton kompensimin prej 760 lekësh

ISSH: Si mund të merrni shtesën prej 190-500 lekë në muaj

përbërëse e pensionit dhe përfitohet së bashku me pensionin." bën me dije ISSH.

**KOMPENSIMI DERI NË 500 LEKË**

Në bazë të ligjit "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve"; këtë lloj kompensimi deri në 500 lekë e përfitojnë të gjitha pensionet e pleqërisë, të plotë, të pjesshëm, të reduktuar dhe pensionet familjare të plota e të pjesshme të qytetit. "Masa e përfitimit: 500 lekë në muaj, për të gjitha pensionet e pjesshme të pleqërisë; 500 lekë në muaj, për të gjitha pensionet e plota minimale të pleqërisë; Deri në 500 lekë në muaj, për të gjitha pensionet e pleqërisë e të ardhurave nga pensioni dhe përfitohet së bashku me pensionin. "thekson Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

**KOMPENSIMI DERI NË 200 LEKË**

Këtë lloj kompensimi mbi të ardhurat mujore të pensioneve të qytetit në masën deri në 200 lekë e përfitojnë të gjitha pensionet e pjesshme të pleqërisë, të invaliditetit dhe pensionet e pjesshme familjare të qytetit. Gjithashtu, këtë përfitim e marrin të gjitha pensionet e plota minimale të pleqërisë, invaliditetit dhe familjare të qytetit; si dhe të gjitha pensionet e pleqërisë dhe familjare të qytetit, pasi t'u jenë llogaritur të gjitha kompensimet. Kjo e ardhur është pjesë përbërëse e të ardhurave nga pensioni dhe përfitohet së bashku me pensionin.

**KOMPENSIMI DERI NË 190 LEKË**

Kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve të qytetit deri në masën prej 190 lekësh e përfitojnë të gjitha pensionet e pjesshme të pleqërisë, të invaliditetit dhe pensionet e pjesshme familjare të qytetit; të gjitha pensionet e plota minimale të pleqërisë, invaliditetit dhe



familjare të qytetit; si dhe të gjitha pensionet e pleqërisë dhe familjare të qytetit, pasi t'u jenë llogaritur të gjitha kompensimet.

**KOMPENSIMI PËR PERSONAT NË NGARKIM TË PENSIONISTËVE**

Instituti i Sigurimeve Shoqërore thekson se mund të përfitohet edhe një tjetër lloj kompensimi për personat në ngarkim që ka përfutuesi i pensionit të pleqërisë, invaliditetit dhe familjar. Këtë kompensim e përfitojnë: të gjithë pensionistët që marrin pension, që kanë anëtarë të familjes në ngarkim dhe që janë me banim të përhershëm në qytet;

kur kanë në ngarkim fëmijë nën moshën 18 vjeç ose deri në 25 vjeç, kur vazhdojnë shkollën e lartë; si dhe kur kanë persona të tjerë në ngarkim dhe nuk janë në marrëdhënie pune. Ndërkaq masa prej 414 lekësh në muaj jepet për çdo person të familjes në ngarkim në rastet kur fëmijët janë nën moshën 18 vjeç ose deri në 25 vjeç, kur vazhdojnë shkollën; si dhe kur nipat, mbesat, kur nuk i kanë prindërit, bashkëtojnë me pensionistin dhe janë nën moshën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç kur vazhdojnë shkollën. Ndërkohë pagesa në masën 207 lekë në muaj, jepet kur një nga prindërit është në marrëdhënie pune, ose në pension. ISSH thekson se ky kompensim nuk përfitohet nga pensionistët që realizojnë të ardhura nga veprimtaria ekonomike si të punësuar, punëdhënës, të vetëpunë-

suar, ose kanë tokë në pronësi. Për të përfituar nga kjo masë pagese, të interesuarit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e përcaktuar si fotokopje e letërnjoftimit elektronik; certifikatë familjare; vërtetim nga shkolla; vërtetim nga zyra e tatimeve, taksave dhe nga bashkitë dhe komunat, për mospatje të aktivitetit; vërtetim nga zyra e punës, si punëkërkuar, për personat që janë në ngarkim dhe nuk janë në marrëdhënie pune; si dhe një deklaratë personale.

**KOMPENSIM PREJ 648 LEKËSH**

Nga kompensimi prej 648 lekësh në muaj për mbrojtjen e shtresave në nevojë për efekt të energjisë elektrike, deri në 300 kwh në muaj, mund të përfitojnë 2 kategori. Respektivisht mund të marrin këtë kompensim kryefamiljarët që përfitojnë pension invaliditeti shtetëror dhe pension invaliditeti të plotë në fshat dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar në sektorin privat si dhe kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie shtetëror ose pension pleqërie fshatit, por që janë me banim në qytet dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar. Dokumentacioni që nevojitet për të fituar të drejtën e përfitimit përfshin: deklaratën personale; fotokopjen e Letërnjoftimit; fotokopjen e kontratës të energjisë elektrike, lidhur midis OSSH-së dhe personit; fotokopjen e Librezës së energjisë; që vërteton senukka detyrime të pagapaguara; si dhe një certifikatë familjare.

### LLOGARITJA E MASËS

Kështu kanë të drejtë të përfitojnë deri në 760 lekë në muaj, të gjitha pensionet e pjesshme të pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare, që përfitojnë një masë pensioni më të vogël se pensioni bazë. Kjo për llogaritet si raport i produktit të shumëzimit të pensionit të caktuar me 760 lekë dhe ajo që del pjesëtohet me pensionin bazë.

### KOMPENSIMI PËR MBROJTJEN E SHTRËSAVE NË NEVOJË NGA RRRITJA E ÇMIMIT TË ENERGJISË

#### Kush e përfiton:

Kryefamiljarët që përfitojnë pension invaliditeti shtetëror dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik ose të vetëpunësuar në sektorin privat;

Kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie shtetëror dhe jetojnë të vetëm ose kanë fëmijë në ngarkim, të cilët janë pa të ardhura.

#### Dokumentacioni që kërkohet:

Deklaratë personale, që ndodhet, pranë Agjencive Lokale të Sigurimeve Shoqërore; Fotokopje e kontratës të energjisë elektrike, lidhur midis OSSH-së dhe personit; Certifikatë familjare;

Për fëmijët mbi moshën 18 deri në 25 vjeç, vërtetim që vazhdojnë shkollën.

#### Masa e përfitimit:

640 lekë në muaj. Ky shpërblim tërhiqet në postën paguese së bashku me pensionin.

### KOMPENSIMI I TË ARDHURAVE MUJORE TË PENSIONISTËVE NË MASËN DERI NË 500 LEKË

#### Masa e përfitimit:

500 lekë në muaj, për të gjitha pensionet e pjesshme të pleqërisë; b) 500 lekë në muaj, për të gjitha pensionet e plota minimale të pleqërisë;

Deri në 500 lekë në muaj, për të gjitha pensionet e pleqërisë, që e kanë kufirin deri tek shuma e pensionit të plotë bazë minimal plus 500 lekë, e cila llogaritet si diferencë ndërmjet kufirit të mësipërm me pensionin e caktuar brenda këtij kufiri;

Kjo e ardhur është pjesë përbërëse e të ardhurave nga pensioni dhe përfitohet së bashku me pensionin.



Presioni i BE-së bëri që Prishtina zyrtare t'ia lejojë vizitën në Gazivodë presidentit të Serbisë

# Vuçiç viziton Kosovën dhe liqenin e Gazivodës

*Vizita ndodh vetëm një ditë pas dështimit të takimit të Brukselit*

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç, viziton Kosovën me gjithë paralajmërimet që ai mund të mos e realizojë këtë vizitë për shkak që autoritetet e Prishtinës nuk ia kishin miratuar fillimisht të gjithë itinerarin e vizitës së paralajmëruar në Kosovë. Prishtina zyrtare e kishte lejuar Vuçiçin që të qëndrojë në Kosovë, por jo edhe ta vizitojë liqenin e Gazivodës, bisedimet rreth të cilit janë të nxehta se kujt i takon ky liqen që ka një rëndësi të veçantë.

"Do të shkoj në Kosovë dhe do ta filloj vizitën në liqenin e Gazivodës dhe në qendrën ekologjike atje. Pres që gjithçka të kalojë mirë dhe pres që atje në mënyrën më normale t'iu drejtohem njerëzve dhe t'u tregoj se sa është i rëndësishëm liqeni i Gazivodës, jo vetëm për serbët, por edhe për shqiptarët në Kosovë", tha Aleksandër Vuçiç.

Pak para kësaj deklarate, diku rreth mesnatës, ministri i Punëve të Jashtme i Kosovës, Behxhet Pacolli, konfirmoi se Prishtina zyrtare ia ka lejuar presidentit Vuçiç që ta vizitojë Gazivodën. "Po i është lejuar vizita. Vendimi është marrë para gjysmë ore. Kemi pasur presion nga Bashkimi Evropian dhe aleatët, nuk kemi pasur zgjidhje tjetër", tha Behxhet Pacolli.

## MASA SIGURIE

Aleksandër Vuçiç, nga mëngjesi i së shtunës deri të dielën pasdite qëndron në disa lokalitete në veri të Kosovës. Për sigurinë e tij



do të kujdesët policia e Kosovës me një plan të posaçëm operativ, për shkak të sigurisë së tij. Serbët në veri të Kosovës kanë mbushur rrugët me flamujt e Serbisë dhe pankarta duke i uruar mirëseardhje Presidentit të Serbisë. Aleksandër Vuçiç, tha se "gjatë kësaj vizite në Kosovë (në një tubim në veri të Mitrovicës) do ta mbajë fjalimin më të rëndësishëm në jetën e tij për t'u shpjeguar qytetarëve serbë procesin e bisedimeve dhe çfarë mund të përfitojnë ata dhe Serbia". Megjithatë sipas tij, "Serbia ka mundësi të kufizuara në Kosovë".

Vizita në Kosovë e Presidentit të Serbisë, ndodh vetëm një ditë pas dështimit të takimit të Brukselit, ku Aleksandër Vuçiç dhe Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, takuan ndaras shefen e diplomacisë evropiane Federika Mogherini, por, ata dy, nuk u takuan së bashku, ashtu si vepronin herëve tjera. Vuçiç tha se kësaj radhe nuk është takuar me Thaçin për shkak të qasjes së Prishtinës ndaj procesit. Për më shumë ai tha se "gjatë tre ditëve të fundit kishte pasur shumë presion mbi deputetët e Listës "Srpska", që të votojnë për shëf të delegacionit negociues Kosovës me Serbinë, zëv-

endëskryemministër në Kosovë, Fatmir Limajn". Këtë të fundit Serbia e akuzon për krime lufte, ndonëse në një proces të gjatë në Tribunalin e Hagës. Limaj është shpallur i pafajshëm.


## REAGIMET OPOZITARE

Partitë opozitare në Kosovë dështimin e takimit në Bruksel ndërmjet Vuçiçit e Thaçit e cilësuan si një lloj fitore të tyre për shkak të kundërshtimit që po i bëjnë ata Presidentit që mos ta diskutojë në Bruksel çështjen e kufijve të Kosovës. Partia më e madhe opozitare Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) vlerëson se arsyeja kryesore e dështimit të takimi

## TAKIMI I BRUKSELIT

Me gjithë zhvillimet e së premtes në Bruksel dhe debatet e ashpra Brenda skenës politike kosovare, të dy presidentët ai i Serbisë, Aleksandër Vuçiç dhe ai i Kosovës, Hashim Thaçi, thanë se dialogu Kosovë-Serbi do të vazhdojë me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Para referendumit Shkupi ka nevojë për çdo lloj mbështetjeje

mi Thaçi-Vuçiç, ka të bëjë me zhvillimet politike brenda Kuvendit të Kosovës. "Presioni i opozitës për miratimin e Rezolutës, përmes së cilës do të ndalej procesi i pazareve me kufijtë e Republikës së Kosovës, ka dërguar sinjal në Bruksel se z.Thaçi nuk mund të bisedojë për këtë temë. LDK do të vazhdojë fuqishëm ta kundërshtojë këtë formë të dialogut, ku presidenti pa mandat nga Kuvendit i Kosovës t'i prijë këtij procesi, si dhe të ndalojë secilin institucion që hyn në aventura ku mund të cenohet territori, integriteti dhe sovraniteti i vendit", thuhet në reagimin e LDK-së.



**Merkel në Maqedoni:  
Në kërkim të historisë së suksesit në Ballkan**

Maqedonia nuk ka parë shumë personalitete të larta politike dhe diplomatë të lartë që nga fundi i luftës në Kosovë në vitin 1999. E kycur në mes të Greqisë në jug, Bullgarisë në lindje, Shqipërisë dhe Kosovës në perëndim e Serbisë në veri, ish-republika jugosllave me 2 milionë banorë nuk ka qenë opsioni i parë i vizitës për ndonjë lider botëror deri më tani. Historitë e suksesit mes politikanëve evropianë janë të rralla këto kohë, aq më pak ato të Ballkanit të trazuar. Maqedonia ka shansin të bëhet një histori e tillë suksesit, por vetëm, nëse e ndryshon emrin në Republika e Maqedonisë së Veriut.

Më 17 qershor, kryeministri maqedonas, Zoran Zaev dhe ai grek, Alexis Tsipras nënshkruan marrëveshjen, të njohur si marrëveshja e Prespës, gati 27 vjet pas negociatave të vështira dhe grindjeve lidhur me emrin historik, Maqedoni. Shumë politikanë evropianë psherëtinë të lehtësuat, ndërkohë që të tjerë, si përfaqësuesja e BE për Politikën e Jashtme, Federica Mogherini dhe ministri i Jashtëm gjerman, Heiko Maas e cilësuan atë "historike".

Menjëherë pas kësaj, Maqedonia mori ftesën për t'u bashkuar NATO-s, e megjithëse Berlini bëri përpjekje për hapjen e shpejtë të negociatave me BE, ato u bllokuan nga Franca e Holanda dhe u shtynë me një vit. Të dyja këto hapa u panë si inkurajim për qeverinë e Shkupit dhe qytetarët e Maqedonisë për të mbështetur referendumin e 30 shtatorit.

## LIDHJA ME PUTIN



George Papadopoulos, ish-këshilltar i fushatës presidenciale të Donald Trumpit, veprimet e të cilit ishin shkas për hapjen e hetimit rreth ndikimit rus, u dënua me 14 ditë burg të premtën. Gjykatësi që dha vendimin tha se zoti Papadopoulos kishte zgjedhur interesat vetjake dhe sakrifikuar interesat e vendit. Dënimi i George Pa-

## Këshilltari i fushatës Trump, dënohet me 14 ditë burg

padopoulos-it ishte shumë më i lehtë nga dënimi maksimal prej gjashtë muajsh që kërkohet nga qeveria, por dënimi më i rëndë nga sa kishin kërkuar avokatët e tij. Megjithatë, avokati mbrojtës Thomas Breen tha se vendimi ishte i drejtë. "Ne jemi shumë të kënaqur me vendimin e gjykatësit. Mendoj se ai mori parasysh të gjitha faktet. Disa njerëz mund të

mendojnë se dënimi është i lehtë, ndërsa disa se është vendim i tepërt. Por nuk kam dyshim në mendjen time se gjykatësi vendosi për dënimin që ai mendoi se ishte më i drejtë" tha avokati. Gjykatësi amerikan Randolph Moss tha se mashtrimi i Papadopoulos-it "nuk ishte gjenjeshër fisnike" dhe se ai kishte gjenjyer sepse donte një vend pune në ad-

ministratën Trump dhe nuk donte të rrezikonte këtë mundësi duke u lidhur me hetimin rus. Papadopoulos, i pari ndihmës i fushatës së zotit Trump i dënua si pasojë e hetimit të prokurorit të posaçëm Robert Mueller, tha se ndihej "thelësisht i turpëruar" që i kishte gjenjyer agentëve të FBI-së kur ata e morën në pyetje vitin e kaluar, dhe pranoi se veprimet e tij mund të kishin penguar punën e tyre.

Procedurat për marrjen e tapisë ndiqen nga Agjencia e Legalizimeve

Ornela Manjani

# ALUIZNI, 355 personat që do të marrin lejet

## Përfituesit në qarkun e Shkodrës

**A**LUIZNI publikon listën me 355 persona që kanë ndërtuar pa leje dhe kanë gati lejet e legalizimeve. Përfituesit janë në qarkun e Shkodrës. Drejtoria e ALUIZNI-t Shkodër bën të ditur se qytetarët që gjejnë emrin në listë të paraqiten pranë kësaj Drejtorie për të tërhequr lejen e legalizimit, në rast të mosparaqitjes së tyre brenda një jave, leja do të dërgohet nëpërmjet shërbimit postar në adresën e objektit të legalizuar. ALUIZNI bën të ditur se brenda pak kohësh të gjithë përfituesit do të pajisen me tapitë për pronën dhe se vonesat në shqyrtimin e dosjeve dhe pajisen me leje kanë marrë fund.

### TAPITË

Procedurat për marrjen e tapisë do të ndiqen nga ALUIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në hipotekë. Menjëherë pas regjistrimit të certifikatës së pronësisë, përfituesit do të njoftohen

për tërheqjen saj. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarrimin e procesit të legalizimit, por e gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Paturive të Paluajtshme do të bëhet nga Agjencia. Ndërkohë që sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m<sup>2</sup>. Sipërfaqet mbi masat



e përcaktuara në këtë pikë, të cilat për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shiten poseduesit të ndërtimit

pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Gjithsej leje legalizimi të dhëna në periudhën 2006-2015 janë 57.000. Ndërkohë që çdo muaj ALUIZNI bën gati rreth 3 mijë leje në të gjithë vendin. Sipas ligjit në fuqi, kur ndërtimi pa leje disponohet nga një subjekt, kontrata e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore dhe objektit që legalizohet regjistron në emër të subjektit që disponon ob-

jektin. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve. Në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirish dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë përveç pjesës takuese edhe pjesët fizike respektive, nëse ndërmjet tyre përputhet vullneti.

BASHKIA SHKODER			
NR EMER	ATESIA	MBIEMER	VENDODHJA
1	SUAD	ZUA	ARILLA RAJONI 1
2	METUSH	ALI	KURTULAJ RAJONI 1
3	GJOVALIN	PJETER	CUBI RAJONI 1
4	HILMI	YMER	IMERI RAJONI 1
5	MALIQ	ABDULLAH	SHMIDRA RAJONI 1
6	KAPLLAN	REXHEP	SELA RAJONI 1
7	BEDRI	METUSH	HASANAJ RAJONI 1
8	QERIM	AHMET	VUCAJ RAJONI 1
9	BAHRI	SHERIF	TARAMANI RAJONI 1
10	HAMDI	NUH	MUSTAFA RAJONI 1
11	FEJZI	XHEVDET	HAFIZI RAJONI 1
12	ADEM	JAKUP	LIKAJ RAJONI 1
13	NAZMI	ISUF	GUZI RAJONI 1
14	ISTREF	IDRIZ	SMAKAJ RAJONI 1
15	FATJON	XHEVAHIR	HOTI RAJONI 1
16	NIMETULLA	MUHAMET	BEKTESHI RAJONI 1
17	NAIL	MUSA	RAMJA RAJONI 1
18	NAZIRE	ZYBER	FACI RAJONI 1
19	RROK	LULASH	GURI RAJONI 1
20	RROK	DED	MALVATAJ RAJONI 1
21	ASLLAN	ELEZ	GJONAJ RAJONI 1
22	ALIM	REXHEP	BEQIRI RAJONI 1
23	LULZIM	ESAT	ETHEMI RAJONI 1
24	AGIM	SULEJMAN	SHMIDRA RAJONI 1
25	BERHAN	ISA	SYLJA RAJONI 1
26	ARJET	MITHAT	HOTI RAJONI 1
27	YLLI	ZEJNEL	SHEHAJ RAJONI 1
28	RIZA	DAN	MEHMETAJ RAJONI 1
29	HALIT	KASEM	VULASHI RAJONI 1
30	ISMET	CUF	MATAJ RAJONI 1
31	HAKI	HASAN	FASLUA RAJONI 1
32	XHEVDET	HAMZA	DUSHKU RAJONI 1
33	HASAN	MUSA	RAMJA RAJONI 1
34	XHEHAL	REXHEP	KRAJA RAJONI 1
35	RIFAT	YMER	LUIGJ RAJONI 1
36	BASHKIM	SHAQIR	CURRAJ RAJONI 1
37	REMZI	TAIP	HURMI RAJONI 1
38	XHEVAHIR	HAJDAR	MATAJ RAJONI 1
39	ZADE	HAXHI	MATAJ RAJONI 1
40	MYFTINIA	SHKODER	RAJONI 1
41	GJON	PREKE	MARKAJ RAJONI 2
42	MUSTAFA	RAMADAN	FOILETA RAJONI 2
43	FATMIR	KASEM	HALLUNAJ RAJONI 2
44	ARBEN	MARK	PJETRI RAJONI 2
45	TONIN	ZEF	GJONI RAJONI 2
46	FIQIRET	RAMADAN	SKUTINA RAJONI 2
47	ZUA	SULEJMAN	LINA RAJONI 2
48	LUIGJ	NIKE	KOLAJ RAJONI 2
49	NIKE	PREKE	PEPNIKU RAJONI 2
50	ZAMIRA	VISHA	ETHEMI RAJONI 2
51	GERALD	ZUA	BASHA RAJONI 2
52	FADIL	MAN	ELEZI RAJONI 2
53	BAHRI	NUH	HOXHA RAJONI 2
54	OSMAN	TAHIR	KALOSHI RAJONI 2
55	SADIK	UC	SMALLAJ RAJONI 2
56	LAZER	PRAL	MACAJ RAJONI 2
57	GAZMEND/SHERIF	SHEUKI/HAJDAR	MANI/HEPAJ RAJONI 2
58	ANGJELIN/LEZE	DED/PRELE	SHPELLA RAJONI 2
59	ADRIAN	LUIGJ	PJESHKA RAJONI 2
60	DED	KOLE	KODRA RAJONI 2
61	MITHAT	XHEVDET	GREZDA RAJONI 2
62	ADLIE	RIFAT	MEHMETAJ RAJONI 2
63	CLIRIM	MEM	FIKAJ RAJONI 2
64	QAMIL	BEJTO	DRANGU RAJONI 2
65	MUHAMET	MYRTO	KUKAJ RAJONI 2
66	ARMANDO	LAZER	MACAJ RAJONI 2
67	BERHAN	MUSTAF	DRAGONI RAJONI 2
68	PLLUMB	NIKE	PRENDI RAJONI 3
69	LULASH	ZEF	TATGJONAJ RAJONI 3
70	ARION	MARK	CUKAJ RAJONI 3
71	PREL/GEZIM	DEDE	DOCAJ RAJONI 3
72	LUSH	LIN	GURI RAJONI 3
73	EDUARD	KOLE	ZEFI RAJONI 3
74	GJON	RAKE	DOCAJ RAJONI 3
75	LIZA	MARK	MARASHI RAJONI 3
76	KARMELINA	LUIGJ	QAFZA RAJONI 3
77	REXHEP	FADIL	ISUFI RAJONI 4
78	PETRIT	GJERGJ	LISAJ RAJONI 4
79	HAKI	LATIF	URA RAJONI 4
80	BAHRI	IDRIZ	MEMCAJ RAJONI 4
81	VILDAN	XHEVDET	BEKTESHI RAJONI 4
82	LEONAT	MUHAMET	HAMZI RAJONI 4
83	VUKSAN	PREKE	GILAJ RAJONI 4
84	MARJAN	PRAL	KUNORAJ RAJONI 4
85	LULZIM	NUH	ÇOKU RAJONI 4
86	NDUE	ZEF	MARKAJ RAJONI 5
87	DED	NDOC	CURRI RAJONI 5
88	EDUARD	MARK	MARKU RAJONI 5
89	DEDE	MARK	LUFJA RAJONI 5
90	NORA	NDOC	MARKU RAJONI 5
91	ZEF	MARK	PERBIBAJ RAJONI 5
92	LULASH	NDOC	MHILLI RAJONI 5
93	FRANG	NDUE	GURI RAJONI 5
94	VITORE	LAZER	PROBIBAJ RAJONI 5
95	ROZI	RROK	PALI RAJONI 5
96	LUL	NIK	VOCI RAJONI 5
97	FRED	LUK	BABAJ RAJONI 5
98	MHILL	LULASH	KRONI RAJONI 5
99	LAZER	SHAN	LULASHI RAJONI 5
100	ZEF	GJIN	PERGJONI RAJONI 5
101	ANGJELIN	SIMON	DABERDAKU L. NDOC MAZI
102	NADIR	YMER	ZHEJANI L. SALO HALILI
103	TONIN	KOLE	TEMALI L. 3 HEROUTE
104	AFERDITA	FASLI	GJUBINI L. GUERRILE
105	ARJOLA	SADIK	CENI L. PARTIZANI
106	QEMAL	ENVER	BEKTESHI L. GUERRILE
107	QEMAL	ENVER	BEKTESHI L. GUERRILE
108	FATMIR	HALIT	RRABOSHTA L. NAIM GJVLBEGU
109	ELMIRA	XHEVAT	KOÇJA L. SKENDERBEG
110	FILIP	GJON	VILA L. TOM KOLAJ
111	ABDULLAH	ALI	SYLJA L. FAHRI RAMADANI
112	GENTIAN	LUAN	MEMCAJ L. NAIM GJVLBEGU
113	YMER/JONIDA	XHEHAL	DULI L. NAIM GJVLBEGU
114	METLLI	MUSTAFA	BINAJ B. SHKODER
115	RAMADAN	MUHAMET	MUSLUA L. 10 KORRIKU
116	MRI	KOLE	PRRONI L. SKENDERBEG
117	ZYLHA	SULEJMAN	MILOTI L. PERASH SHKODER
118	ERKAND	MEHDI	QERIMAJ L. MANUSH ALIMANI
119	NIKOLIN	GJON	DEDVUKAJ L. MANUSH ALIMANI
120	SOKOL	SULEJMAN	LICI L. PARTIZANI
121	SHERIF	ZEK	HYKAJ L. GUERRILE
122	KIRZEN	SHKELZEN	BUSHATI L. KONGRESI I PERMITIT
123	SOKOL	SULEJMAN	LICI L. NAIM GJVLBEGU
124	BAHRI	CUF	MANI L. AHMET HAXHIJA
125	VAID	NUH	ÇOKU L. DANIEL MATLUA
126	MARUJE	KOLE	NIKOLLI L. PERASH
127	ILLU	KOLE	DUSHKJA BERDICE E MADHE, BERDICE
128	ZEF	NIKOLL	DANI BERDICE E MADHE, BERDICE



129	ANGJELINE	GJON	CAPALIKU	BERDICE E MADHE,BERDICE
130	ELIS	EJELL	TUKU	BERDICE E SIPERME,BERDICE
131	MIRJAN	ESAT	URA	BERDICE E SIPERME,BERDICE
132	PREK	NDUE	MARKU	BERDICE E SIPERME,BERDICE
133	NUSH	GJON	GJOKA	BERDICE E SIPERME,BERDICE
134	GJELOSH	VAK	KOLA	BERDICE E SIPERME, BERDICE
135	PJERIN	SHAN	SHATI	BERDICE E SIPERME,BERDICE
136	LUKE	PJETER	TUKU	BERDICE E SIPERME,BERDICE
137	BESIM	SABRI	SALA	BERDICE E MESME,BERDICE
138	XHEMAL	DAN	DARA	BERDICE E MESME,BERDICE
139	KRESHNIK	FADIL	RAMAJ	BOKS I RI, VELIPOJE
140	GJOVALIN	KOLE	NIKOLLI	GOMSIQE E RE, VELIPOJE
141	ARQIPESHKIVIA METROPOLITANE SHKODER-PULT			GOMSIQE,
VELIPOJE				
142	ANTON	GJOKE	NIKOLLI	GOMSIQE, VELIPOJE
143	ANTON	GJOKE	NIKOLLI	GOMSIQE, VELIPOJE
144	ARQIPESHKIVIA METROPOLITANE SHKODER-PULT			GOMSIQE,
VELIPOJE				
145	SHPRESA	ZEF	NIKOLLI	GOMSIQE E RE, VELIPOJE
146	GJON	PASHKO	GJELOSHI	SEKTOR, VELIPOJE
147	TOME	GJERGJ	GJERGJI	SEKTOR, VELIPOJE
148	SELMAN	HASAN	RUKAJ	SHTOJ I RI, RRETHINA
149	SULEJMAN	SHYQYRI	KAPJA	SHTOJ I RI, RRETHINA
150	BASHKIM	IBRAHIM	HEKURI	SHTOJ I RI, RRETHINA
151	GEZIM	XHEVAT	LEKAJ	SHTOJ I RI, RRETHINA
152	KADRI	BINAK	HAKAJ	SHTOJ I RI, RRETHINA
153	NDUE	MARK	TETHERMJA	SHTOJ I RI, RRETHINA
154	ZEF	SHAN	SHELISHTJA	SHTOJ I RI, RRETHINA
155	MYFTINJA SHKODER			SHTOJ I RI, RRETHINA
156	GJON	DED	GJEÇAJ	MURIOQAN ,ANA MALIT
157	PLLUMB/MALVINA RI, RRETHINA		TOM/GJIN	DELJA SHTOJ I
158	AGRON	NAZIM	HAXHIJA	SHTOJ I VJETER, RRETHINA
159	IDRIZ	IBRAHIM	PEPAJ	DOBRAC, RRETHINA
160	HETE/MYLFETE	ALI/AVDI	LISAJ	DOBRAC, RRETHINA
161	REXHEP	HALIL	BERISHAJ	DOBRAC, RRETHINA
162	KIN	NDOC	ZOJZA	HOT I RI, RRETHINA
163	VIKTOR/LAZER	LAZER/NIKE	MURRIZAJ	HOT I RI, RRETHINA
164	LIRIM	PASHKO	VITAJ	HOT I RI, RRETHINA
165	NDUE	MARK	KASNECI	HOT I RI, RRETHINA
166	SEJDI	SADRI	MESI	HOT I RI, RRETHINA
167	MIR	MARK	LUMI	HOT I RI, RRETHINA
168	PASHKO	FRANO	VUKAJ	HOT I RI, RRETHINA
169	AHMET	JUP	VATAKSI	ZUES, RRETHINA
170	BARDHYL	RUZHDI	OGRAJA	ZUES, RRETHINA
171	ILMI	IDRIZ	ZALLI	ZUES, RRETHINA
172	LULJAN	XHEMAL	HASAJ	DOBRAC, RRETHINA
173	HYJNI	MYFTAR	LUKAJ	DOBRAC, RRETHINA
174	SADRI	ADEM	HYSAJ	DOBRAC, RRETHINA
175	QAZIM	SADIK	CEKAJ	DOBRAC, RRETHINA
176	SHKELQIM	HASAN	CEKAJ	DOBRAC, RRETHINA
177	TONIN	NDOC	ÇARDAKU	BLERAN, RRETHINA
178	XHOVALIN	SHAN	LAMI	BLERAN, RRETHINA
179	MYFTINIA SHKODER			GUCI E RE, RRETHINA
180	MUHAMET	ISUF	BURMI	GOLEM, RRETHINA
181	AFRIM	RIZA	BRACAJ	MES, POSTRIBE
182	QEMAL	ADEM	BRACAJ	MES, POSTRIBE
183	HYSEN	SALI	KALLAJ	MES, POSTRIBE
184	JANI	IDRIZ	ÇALLAJ	MES, POSTRIBE
185	MYZAFER	HASAN	CELAJ	DRAGOÇ, POSTRIBE
186	IBRAHIM	TAF	HALILI	DRAGOÇ, POSTRIBE
187	FETAH	ÇEL	HALILAJ	DRAGOÇ, POSTRIBE
188	GAZMEND	XHEVDET	HALAJ	DRAGOÇ, POSTRIBE
189	LULZIM	FAHRI	ÇELAJ	DRAGOÇ, POSTRIBE
190	LIRIM	GJETO	BIBAJ	BOKS, POSTRIBE
191	XHEVDET	BESHIR	SPAHUA	BOKS, POSTRIBE
192	SEJDI	ZENEL	REPAJ	BOKS, POSTRIBE
193	LATIF	MUSA	PLANGAJ	BOKS, POSTRIBE
194	BUJAR	MUSA	PLANGAJ	BOKS, POSTRIBE
195	CUF	SHABAN	ALUJAJ	MYSELM POSTRIBE
196	ASTRIT	JONUZ	THORJA	MYSELM, POSTRIBE
197	QAMIL	ISA	VELLA	MYSELM, POSTRIBE
198	ERMIR	ILIA	BUSHI	KULLAJ, POSTRIBE
199	DED	MARK	MARKU	VUKATANE, GUR I ZI
200	MYFTINIA SHKODER			VUKATANE, GUR I ZI
201	KISHAKATOLIKE VUKATANE			VUKATANE, GUR I ZI

202	XHAMIA VUKATANE			VUKATANE, GUR I ZI
203	MARK	SIMON	KOLA	RRENC, GUR I ZI
204	PALE	JAKE	ZHALA	GUR I ZI
205	GJOVALIN	LAZER	RROKU	GUR I ZI
206	YLBER	KASEM	KASEMI	GUR I ZI
207	LUMTURI	XHELIL	SELIMI	GUR I ZI
208	DONIK	EJLL	VASA	GUR I ZI
209	BESIM	CAN	ABDIJA	GUR I ZI
210	LIN	DEDE	CARRAJ	GUR I ZI
211	XHAFER	CAN	DYLI	GUR I ZI
212	MUSA	HAMD	LINI	MURIOQAN ,ANA MALIT
213	SAMI	RIFAT	XHAKA	MURIOQAN ,ANA MALIT
214	AFRIM	MUHAMET	LEKAJ	MURIOQAN ,ANA MALIT
215	VAB	RAMADAN	CENI	MURIOQAN ,ANA MALIT
216	TAHIR	RIZA	KODRA	MURIOQAN ,ANA MALIT
217	CUF	HALIL	BREGU	MURIOQAN ,ANA MALIT
218	HAJRI	RAMADAN	ORUÇI	MURIOQAN ,ANA MALIT
219	A/NI	HALIL	LEKAJ	MURIOQAN ,ANA MALIT
220	RUDINA	LAZER	TOPALLI	MURIOQAN ,ANA MALIT
221	VALENTIN	PASHUK	TOPALLI	MURIOQAN ,ANA MALIT
222	SHTJEFEN	PALE	DODA	MURIOQAN ,ANA MALIT
223	GJON	RROK	FROKU	MURIOQAN ,ANA MALIT
224	VINÇENS	TOM	DODA	MURIOQAN ,ANA MALIT
225	PASHUK	KOLE	NIKOLLA	MURIOQAN ,ANA MALIT
226	ZEKE	LUIGJ	LUIGJI	MURIOQAN ,ANA MALIT
227	NAZMI	RAMADAN	TAJA	MURIOQAN ,ANA MALIT
228	AGIM	REXHEP	KASEMI	MURIOQAN ,ANA MALIT
229	XHEVDET	SULEJMAN	LANDA	MURIOQAN ,ANA MALIT
230	HASIM	RESHIT	KRAJA	MURIOQAN ,ANA MALIT
231	ENVER	ADEM	BEQIRI	MURIOQAN ,ANA MALIT
232	HAMD	KAPLLAN	TELUKA	OBLIKE E MADHE, ANA MALIT
233	HILMI	SHEUQET	PRRONI	OBLIKE E MADHE, ANA MALIT
234	QAZIM	REXHEP	SADELI	OBLIKE E MADHE, ANA MALIT
235	NAZIM	BEQIR	CENI	OBLIKE E MADHE, ANA MALIT
236	DOD	VAS	PALAJ	DAJÇ

BASHKIA VU DEJES

NR	EMER	ATESIA	MBIEMER	VENDODHJA
1	DAVID	ILLI	SIMONI	KOSMAÇ, B. VU DEJES
2	MYZAFER	QAZIM	SALIH	KOSMAÇ, B. VU DEJES
3	INJAK	FRANO	LUKAJ	RRANXA, B. VU DEJES
4	FILIP	RROK	GORRILLA	RRANXA, B. VU DEJES
5	ARDIAN	GJON	GJUSHI	RRANXA, B. VU DEJES
6	LUKE	JAKAJ	SIMONI	STAJKE, B. VU DEJES
7	AGE	MARASH	DAJANI	STAJKE, B. VU DEJES
8	FEDERIK	VASE	GAVOÇI	STAJKE, B. VU DEJES
9	PAULIN	NDOC	HAXHARI	STAJKE, B. VU DEJES
10	GJON	SIMON	GEGAJ	STAJKE, B. VU DEJES
11	FRANÇESK	PASHUK	DAJAN	STAJKE, B. VU DEJES
12	ARDIAN	ZEF	DOÇI	STAJKE, B. VU DEJES
13	LEK	MARK	TUSHAJ	KAÇE, B. VU DEJES
14	ZEF	PJETER	BASHAJ	KAÇE, B. VU DEJES
15	ANGJELIN	LEK	PECI	KAÇE, B. VU DEJES
16	NDOC	MES, POSTRIBE	DODE	ZEFI
17	NDUE	NDREC	SHTJEFNI	NARAÇ, B. VU DEJES
18	ARBEN	GJON	PRENGA	MJEDE, B. VU DEJES
19	MYFTINJA SHKODER			MJEDE, B. VU DEJES
20	SOKOL	SHTJEFEN	VASJA	MJEDE, B. VU DEJES
21	BEQIR	ISUF	LISI	MJEDE, B. VU DEJES
22	FRED	MARK	VASJA	MJEDE, B. VU DEJES
23	FIQIRETE	QAMIL	TOSKA	MJEDE, B. VU DEJES
24	ARTAN	MARTIN	UKAJ	MJEDE, B. VU DEJES
25	MEDI	SHYQYRI	DINI	MJEDE, B. VU DEJES
26	BAJRAM	SADRI	BJESHKA	LAÇ, B. VU DEJES
27	PAL	NDUE	BRACI	LAÇ, B. VU DEJES
28	PLLUMB	KOLE	BRUNGA	LAÇ, B. VU DEJES
29	NDUE	GJON	BRACI	LAÇ, B. VU DEJES
30	DANDE	MARK	TOLI	LAÇ, B. VU DEJES
31	ANTON	PREMT	M BROZI	LAÇ, B. VU DEJES
32	LEK	NDUE	TUSHANI	LAÇ, B. VU DEJES
33	NIK	DED	DEMAJ	LAÇ, B. VU DEJES
34	NIKOLIN	TOM	MORINA	LAÇ, B. VU DEJES
35	ALEKSANDER	NDUE	NDRECA	LAÇ, B. VU DEJES
36	MARTIN	ZEF	TUSHA	LAÇ, B. VU DEJES

37	GJERGJ	NIKOLL	LUKA	LAÇ, B. VU DEJES
38	MARK	ZEF	GJINI	LAÇ, B. VU DEJES
39	NDUE	GJON	PRENGA	LAÇ, B. VU DEJES
40	MARK	DEDE	TANUSHI	LAÇ, B. VU DEJES
41	OSMAN	AVDI	BREGU	LAÇ, B. VU DEJES
42	TOME	ZEF	GJINI	LAÇ, B. VU DEJES
43	ANGJELIN	NDUE	HUBA	LAÇ, B. VU DEJES
44	ZEF	BARDHOK	TOTAJ	LAÇ, B. VU DEJES
45	ONE	JAK	JAKINI	LAÇ, B. VU DEJES
46	TONIN	MARK	TANUSHI	LAÇ, B. VU DEJES
47	ZEF	FROK	TUSHA	LAÇ, B. VU DEJES
48	ZEF	NDREC	FROKU	LAÇ, B. VU DEJES
49	MARK	ZEF	SULI	LAÇ, B. VU DEJES
50	LEK	NDUE	HUBA	LAÇ, B. VU DEJES
51	MARK	GJON	NIKA	LAÇ, B. VU DEJES
52	NIKOLLE	NDREC	NDRECA	LAÇ, B. VU DEJES
53	KASTRIOT	KOL	PERNDREU	LAÇ, B. VU DEJES
54	BEHAR	FAHRI	HOXHLLAKU	MELGUSHE, B. VU DEJES
55	GJON	PASHKO	SHPATI	MELGUSHE, B. VU DEJES
56	MUSA	DAUT	SEFERAJ	MELGUSHE, B. VU DEJES
57	MIKEL	SHTJEFEN	BUZUKAJ	MELGUSHE, B. VU DEJES
58	HILE	EJLL	LAÇINAJ	MELGUSHE, B. VU DEJES
59	EJLL	BROZ	VELAJ	MELGUSHE, B. VU DEJES
60	BASHKIM	ELJAZ	SHEGAJ	MELGUSHE, B. VU DEJES
61	GJEKE	PJETER	BUZUKAJ	MELGUSHE, B. VU DEJES
62	PASHUK	RROK	LAÇINAJ	MELGUSHE, B. VU DEJES
63	RROK	PASHUK	TOPALLI	NENSHAT, HAJMEL, B. VU DEJES
64	LAVDI	XHEMAL	PASHKAJ	BARBULLUSH, B. VU DEJES
65	SHTJEFEN	KOLE	XHAJI	BARBULLUSH, B. VU DEJES
66	ARTUR	SALO	GERMAJ	BARBULLUSH, B. VU DEJES
67	ISLAM	GANI	KAMBERI	BARBULLUSH, B. VU DEJES
68	ELMI	SHABAN	KAPIDANJA	BARBULLUSH, B. VU DEJES
69	PASHUK	HILE	MILLIA	KUKEL, BUSHAT, B. VU DEJES
70	PREKE	TOME	LUSHI	MALI I JUSHIT, B. VU DEJES
71	PASHKO	NDUE	PACANI	L KAPEDAN, B. VU DEJES
72	GJOVALIN	MARK	MARKU	BUSHAT, B. VU DEJES
73	MARTIN	FROK	DOÇI	BUSHAT, B. VU DEJES
74	MYFIT	HAMD	ZAGANI	BUSHAT, B. VU DEJES

BASHKIA MALESI E MADHE

NR	EMER	ATESIA	MBIEMER	VENDODHJA
1	METUSH	ZENEL	ZEKAJ	KOPLIK I SIPERM
2	ADRIATIK	ZEKE	DEMIRAJ	DEMIRAJ, MALESI E MADHE
3	JAKUP	DERVISH	HYKAJ	BORIÇ I MADH, GRUEMIRE
4	MUHAMET	HAXHI	GJOLAJ	LLAZAN, MALESI E MADHE
5	ISA	RAMADAN	GJONAJ	KOPLIK, MALESI E MADHE
6	MYFTINIA MALESI E MADHE			KTOSH, GRUEMIRE
7	MYFTINIA MALESI E MADHE			DEMIRAJ, GRUEMIRE
8	MYFTINIA MALESI E MADHE			QENDER KOPLIK
9	MYFTINIA MALESI E MADHE			DEMIRAJ, GRUEMIRE
10	PETRIT	LEKE	GONAJ	GRIL, GRUEMIRE
11	FADIL	RAMADAN	KUKAJ	KOPLIK, MALESI E MADHE
12	PASHKO	DED	LELÇAJ	IVANEJ, MALESI E MADHE
13	ANTONIO	GJOVALIN	STAKA	GRUEMIRE ÇESME, MALESI E MADHE
14	ELJAZ	ZEKE	KURTULAJ	KOPLIK B. MALSI E MADHE
15	HYSEN	ALI	HYSEJNI	KOPLIK B. MALSI E MADHE
16	KADRI	BISHO	BRACAJ	KOPLIK B. MALSI E MADHE
17	ALI	BAJRAM	METVETAJ	KOPLIK B. MALSI E MADHE
18	BESNIK	HYSE	IBRAJ	LAÇJE MEHAJ, MALESI E MADHE
19	ABDULLAH	MUJO	DULAJ	RAZEM MALESI E MADHE

BASHKIA PUKE

NR	EMER	ATESIA	MBIEMER	VENDODHJA
1	SKENDER	RAM	ZENUNI	PUKE
2	MYFTINJA SHKODER	PUKE		PUKE
3	ARDIT	RAGIP	ARIFAJ	PUKE

PERKTHYESI

# Burri shtatpaktë, Pashk Gjeçi: U hap dera e Dantja më la vetëm

Fatmira Nikolli

Në burrë shtatpaktë, i kërrusur aq sa mosha dhe hekat, i kanë lejuar t'ia përthyejnë kurrizun, shfaqej dhe shuhej mes pluskimit të vërshimit njerëzor të qytetit që huajti si vendbanim, qytetit që nuk mundi të ishte djep, por do të ishte purgator mundimesh rraskapitëse dhe parajsë kaplimi të eterit të hirshëm. Rendite ngeshëm me vështrimin përdhe pa i rënë në sy akujt. Hynte nga dera e një auditori, dilte nga kthina e një heshetjeje që zvargej pas tij si një hije, e... kërrusej në zhguallin e shfletimit dhe shkrimin duke jetuar botët në frymëmarrjen e një kraharori që kërcente tinëzish nën përkatë e vjetruara. Albert Vataj jep një përshkrim besnik të imazhit që shumëkush ruan për burrin e heshitur që si murg i fjalës, diku i struktur në një strehë modeste pranë "Shallvareve" solli në shqip disa prej veprave madhore të letërsisë.

"Botimet Çabej" logoja e të cilave gjendet mbi librat që Gjeçi shqipëroi, shënojnë në këtë shekull të tij se gjuha shqipe rritet sa herë matet me lisat e gjatë. "Është 100-vjetori i lindjes së Pashk Gjeçit. I atij që e rriti shqipen tonë duke e matur me lisat më të gjatë të letërsisë botërore: E mati me Odiseun e Homerit, e mati me Danten duke e renditur përkthimin shqip të 'Komedisë' në tre përkthimet më të mira të të gjitha kohëve. E mati me 'Faustin' e Gëtes duke i dhënë zë shqip dilemave të ndërjegjes universale. Shqipja dhe ne krijesat e saj i jemi mirënjohës këtij Mjeshtri' të cilit do t'i shkonte sot krejt për shtat vargu i tij shqip nga Fausti: 'Çka farfurit, pa lindun mirë ka vdekun / E thjeshta u shkon breznive e paprekun'. Ka qenë ky përkujtimi që Botimet "Çabej" kanë bërë për përkthyesin e njohur në 100-vjetorin e lindjes me 7 shtator: "Në emër të brezive shqipfolëse, edhe të atyre që ende s'kanë lindur, të falemi nderës, Pashk! Paç jetë të gjatë mëse një shekull! Mos u lodh me ne, sa herë lexojmë pak e flasim shumë. E në 'kaploftë' ndonjëherë lodhja a mërzia njerëzore, thuajti vetes varget e tua të Faustit: 'Të bajmë edhe një hap der te ai gur' / Atje le të pushojmë mbas kësaj qetie / Sa herë jam ulë vetar, kokën ndër duer /


lodhë lutjesh, agjinimi dhe urie", lexojmë në faqen zyrtare të Botimeve Çabej. Ndonëse zyrtarisht përvjetori kaloi në heshitje, ata që e kanë njohur atë dhe punën e tij, si edhe Albert Vataj kanë kujtuar se Pashk Gjeçi, erdhi dhe iku në heshitje për të lënë ndër ne jo vetëm një vepër të ngjizur në caqet e përjetimit, por edhe kujtimin e brishtë të struktur në përvojat e atyre që e njohën.

"Me një jetë modeste, pa privilegje, megjithëse ishte nga të paktët që i meritonte. Rendi i përlulur dhe sfidues me kohën dhe pasionin e shqipërimin. Përgjatë dyzet vjetëve ka jetuar në një dhomë shumë të ngushtë. Aty ka përjetësuar emrin e tij, megjithëse në ngrysje të kësaj jete nuk ndihet mirë me shëndet. Këtë askush nuk e di. Ashtu siç pak vetë e dinë që 'Komedia hyjnore' erdhi nga Pashko Gjeçi", thotë Vataj.

Në fakt, kur shpirti i tij u nda prej trupit në vitin 2010, ai doli për në banesën e fundit, po prej asaj dhome të ngushtë në qendër të qytetit që qe jeta e tij e 'deka' e tij që e la mënjandë, në një prej rrrathëve të ferrit, pa e vrarë, po pa e falur, vetëm se diti dhe vetëm se qëndroi i papërkulur në shpirt, siç u përkul në trup.

Atëherë pasi u lodh prej hjekave në 92 vjet, një ditë i dha fund, në kthinën e katit të dytë, duke bërë t'i mblidheshin së vdekuri ata që e harruan së gjalli, për të mar-

## 100 vjet nga lindja e përkthyesit që jetoi e iku në heshitje



Pashk Gjeçi

rë prej lavdisë së tij, edhe orët e fundit të tij mbi dhe. Prej "Arrës së Madhe" në Shkodër, të Jezuitët, i dashuruar pas Çabejt, pasi mësoi latinishten "ngjall" në prej gjuhës së vdekur poezi duke e sprovuar dorën e mendjen në shqipërim. Mandej nisi shkollimin në Romë, diplomohet me temë mbi Dom Ndre Mjedën dhe kthehet të japë mësim në Shkodër. Kur ata që fituan luftën

erdhën në pushtet, ai shkon në Durrës dhe dukej se çdo gjë po shkente në udhë të mbarë deri kur më 4 shtator 1947 ndalohej me akuzën "Pjesëmarrje në grup kundër pushtetit" dhe dënohet me pesë vjet heqje lirie. Mandej nisnin vuajtjet. "P. Zefi thoshte se Pashku pat nisë ta përkthente Danten me mend qysh gjatë burgut. Lirohet më 1952 lirohet dhe vendoset edhe

njëherë në Shkodër me familje, ku bën punë të rënda krahu për të jetuar. Më 1953-'54, TOB-i i kërkon të përkthejë veprën "Traviata" duke qetur kështu shpëtimin te Verdi nga puna e krahut.

Më 1954-'58 punon si mësuës në shkollën tetëvjeçare



të Fushë-Krujës, kohë që i shërbeu për përkthimin e 'Komedisë Hyjnore' të Dantes, Purgatorit dhe Parajsës", shënon Vata. Më 1962 botohet e plotë "Komedia" me parathëniet të Ll. Siliqit dhe Pashkut i jepet shpërblymimi prej 300 mijë lekësh të vjetra. Më 1963 nis përkthimin e "Odiseës" së Homerit nga greqishtja e lashtë, duke pasur variantet italisht dhe frëngjisht të veprës. Më 1964 martohet me Gjystimë Kapedanin, bano-n me të emën, të shoqen

dhe të bijën në po të njëjtën banesë me një dhomë. Çifti u nda mbas jo shumë vitesh. Më 1965 vazhdon si mësuës në shkollën e natës në Kombinat. Nga 1968 gjer më 1972 jep latinisht në Fakultetin e Mjekësisë. Ndërkohë, më 1969 'Komedia Hyjnore' botohet në Kosovë. Martohet me Nezaqet Gaganin e ato kohë latinishtja hiqet nga programi mësimor. Në moshën 85-vjeçare, ai tregon se si ish-i burgosur politik e sollën në qytezën e vogël të Fushë-Krujës, ku u emërua mësuës në shkollën shtatëvjeçare. "Aty vendosa të përktheja poetin e famshëm italian Dante Aligerin, poezitë të të cilit unë kisha filluar që t'i përktheja që kur isha 17 vjeç në bankat e Liceut të Shkodrës. Përkthimin e "Komedisë Hyjnore" të Dantes, unë e mora përsipër për arsye se ai ishte përkthyer edhe në Bashkimin Sovjetik, e përkthyesit të saj i ishte dhënë çmimi "Stalin". Shfrytëzoja orët e para të mëngjesit para se të fillonte mësimi dhe çdo ditë hidhja në letër nga katër vargje në gjuhën shqipe. Disa prej këtyre vargjeve, në mos gaboj ato të "Ferrit", ia tregova mikut tim të ngushtë Lazar Siliqit, i cili i botoi menjëherë në revistën "Nëntori". Ndonëse ato u pëlqyen mjaft dhe u vlerësuan nga shumë njerëz dashamirës, kritika e asaj kohë heshti, sepse nuk mund të shkruante për një ish-të burgosur politik. Meqenëse i kisha vënë detyrë vetes që ta përktheja me çdo kusht Danten, vazhdoja të punoja çdo ditë dhe kishte raste për një varg më duhej tre katër ditë punë. Pasi kisha përkthyer mijëra vargje në ato tre vjet, katër vargjet e fundit i kam përkthyer një ditë të shtunë kur tre kolegët e mi kishin shkruar në Tiranë. Ato i mbarova aty rreth orës katër të mëngjesit dhe kur i mbarova, m'u duk se u hap dera e prej aty doli Dantja e më la vetëm", - kujtonte Pashko Gjeçi atë çast kur mbaroi së shkruari në shqip një nga kryeveprat e letërsisë botërore, "Komedia Hyjnore" të Dante Aligerit. Nga miqësia me Jusuf Vrioinin, të njohja me Gjergj Fishën, a bisedat me Ernest Kolliqin, ai mundi ta radhiste veten mes emrave të tyre falë orëve të natës ku në ferrin që jetoi shqipëroi natë e ditë botë hyjnore të gjuhëve të tjera. Gjeçi vdiq më 20 janar 2010 duke e lënë bosh vendin e tij në letrat shqipe.

### PROTESTA

Pas deklaratës që kreu i Bashkisë së Tiranës Erion Veliaj bëri të premtën për çështjen e ligjit për teatrot kombëtare, ka reaguar edhe Aleanca për mbrojtjen e tyre. Në një deklaratë ajo thotë se njoftimi i shpërndarë nga zyra e shtypit e Bashkisë së Tiranës rikonfirmoi edhe njëherë qëllimin e drejtë të qëndresës së protestuesve. "Kryetari i Bashkisë dje ka njoftuar mediat dhe publikun se 'besoj në një draft të dakordësuar me Komisionin Evropian. Ne shumë shpejt do të kemi ligjore të nevojshme, procesin e nevojshëm transparent dhe të hapur për të gjithë...". thotë Aleanca.

## ALEANCA PËR MBROJTJEN E TEATRIT: DUAM RRËZIMIN E LIGJIT

Në mënyrë të tërthortë, me këtë njoftim, sipas Aleancës, Kryetari i Bashkisë ka konfirmuar se: • "Ligji special" aktual ishte një çmenduri, një kontratë vjedhjeje e mbrojtur në formë ligji, i cili shkelte qartësisht Kushtetutën dhe Marrëveshjen e Stabilizimit Asocimit. Prandaj ishte përherë e pamundur që Komisioni Evropian të mbyllte syrin ndaj një shkelje të tillë; • Duke rikërkuar hapjen e një diskutimi transparent e gjithëpërfshirës me artistët dhe qytetarët Kryetari i Bashkisë rikonfirmoi se, në fakt, nuk ka pasur kurrë një debat të tillë më parë; • Çfarëdo që të ndodhë tashmë, ky ligj do të jetë përherë një

njollë turpi për ata që e ideuan, nisën dhe mbështetën si akt. Vjedhja dhe abuzimi i pushtetit nëpërmjet këtij ligji janë tërësisht evidente. Precedenti që ai krijonte në shkeljen e barazisë, të drejtës së pronës, të drejtës së konkurrencës, do ishin të tmerrshme për çdo qytetar të Shqipërisë". Aleanca bën me dije se për këto arsye ka besuar përherë se kauza e Teatrit është kauza e gjithsecilit. Sipas saj, nëse qeveria mund të kryente një akt të tillë në mes të Tiranës, nuk do të kishte asnjë pronë apo të drejtë që nuk mund të rrezikohet në çdo cep të vendit. Aleanca rikonfirmoi për

publikun se do të vazhdojë betejën e saj deri në zgjidhjen përfundimtare të problemit. "Kjo do të thotë rrëzimin përfundimtar të ligjit dhe restaurimin e plotë të godinës së Teatrit Kombëtar. Vetëm në këtë mënyrë ideja për shembjen e saj do të mbyllet përfundimisht. Çdo zgjidhje më e pakët se kaq, duke mos e prekur godinën, por duke e lënë të degradojë, do të ishte thjesht një shtyrje e problemit për një kohë të mëvonshme. Aleanca është e gatshme të diskutojë dhe propozojë që sot të gjitha rrugët që çojnë në këtë përfundim". e mbyll deklaratën grupi i protestuesve.



# SPINARICA, PORTI DETAR I APOLONISË

NGA ARISTOTEL MICI

**D**isa vjet me parë, duke dashur të jepja mendimin tim rreth një porti detar të Apolonisë, e trajtova studimin në mënyrë hipotetike. Po me kalimin e kohës, duke vëzhguar fakte të reja, gjellita detaje me interes dhe arrita në idenë se porti detar i Apolonisë nuk ishte më një iluzion hipotetik, po një realitet. Për të ndriçuar sado pak këtë ide, do të parashtrojmë në këtë trajtesë disa fakte konkrete, disa motive sugjestive që kanë të bëjnë me anën

perëndimore të hinterlandit të këtij qyteti antik. Argumentet dhe arsyetimet, që po radhisim kanë karakter të përzier historik, gjeologjiko-hidrik, toponomastik, kishtar, etnografik dhe gojëdhanor, të cilat hasen në trevën e rrethinave të Apolonisë. Me këtë rast e quajmë me vend, që para se të japim arsyetimet tona lidhur me portin detar dhe gjirin e Apolonisë, të bëjmë edhe një përshkrim të shkurtër rreth historisë shekullore të këtij qyteti të famshëm në brigjet e Adriatikut...

→ Vizion në faqen 14

## Një mësim nga nobelistja bjelloruse

NGA BEN ANDONI

# S

vetllana Aleksieviç, nobelistja bjelloruse u përkthye menjëherë në shqip. Më së shumti në Kosovë. Kuptohet se interesi i parë i shqiptarëve ishte ai komercial. Në do të shikosh për ndonjë stil të lartë, elemente të rralla të kompozicionit ke humbur kohë. Kjo sepse ajo nuk të jep asnjë mundësi të tillë dhe për më tepër nuk duket se e ka pasur sfidë në përpjekjet e saj letraro-gazetareske.

Aleksieviç nuk do të bëhej fare e njohur aq sa duhet, paçka se ishte përkthyer dhe auditori ndërkombëtar kishte kohë që e kish në duar, nëse një vendim i beftë i Komitetit të Çmimeve të Nobelit nuk do t'i jepte çmimin e lartë në vitin 2015. Në të gjithë atë që bëri kjo gazetare, e cila u shndërrua në një shkrimtare të njohur ishte dëshmimi pa zbulim por në një kënd tjetër i ngjarjeve më të mëdha historike. Ajo i zhveshi atje ku nuk mban më. Që do të thotë, ajo tregoi zonat toksike për sytë menefregistë të botës, ndërsa për ata që kishin harruar Luftën e tmerrshme Botërore u sollli edhe njëherë personazhet e gjalla e të panjohura me rrefimin e protagonisteve femra. Me syrin e njeriut të kujdesshëm të letrave hoqi heroizmin patetik, frymën panegjirike, shmangu lëndat dhe rrefeu sesi gruaja e hapësirës sovjetike përballi luftën, u nënshtrua prej saj, denatyrizua, pati frikë dhe gjeti forcë prej saj dhe si u njëjua me të me natyrshmërinë e qenies që i bashkangjitet vdekjes.



→ Vizion në faqen 15

A

ARGUMENT

Shqipëria është mbushur me pseudo të desidencës dhe histori të stisura të pas luftës që e bëjnë qesharake një narracion të tërë, ashtu si komunistët dolën bluf me ngritjen e një idili luftime, që në të vërtetë nxori zbuluar shpesh gjëra të paqena dhe heronj të stisur. Ndryshimi, ja për këtë na duhet letërsia dhe njerëzit e drejtë, ata që i duhen çdo rregjimi sepse i duhen vetë historisë njerëzore...



## Një mësim nga nobelistja bjelloruse

NGA BEN ANDONI

Vijon nga faqja 1

Në këto episode, ti gjen realisht frymë zime të jashtëzakonshme dhe histori njerëzore, ku i bëhet himn qenies së thjeshtë femërore dhe njeriut të vogël, atë që historia nuk begenis ta marrë në konsideratë, kurse letërsia me elementët e saj e fut në hapësirat e figuracione duke e shëmtuar skajshëm ose duke e zbuluar në një formë të tillë artificiale, që ti ia di kuptimin ende pa e lexuar. Aman, ti nuk e di dot se çfarë mendon një sanitare që tërheq pa ditur dy robër, një rus dhe një gjerman dhe kur e kupton dhe do të marr vendimin ekstrem, kujtohet se mbi të gjitha ata janë të barabartë sepse janë dy jetë njerëzore. Ti nuk mund të kuptosh sesi është të të marrin njeriun më të afërt, me të cilin ke kaluar jetën për një kapriçio të regjimit, vetëm gjysmë dite pasi ai është kthyer nga robëria naziste. Ti nuk kupton pse një femër kërkon të lyhet kur sapo ka nisur bombardimin dhe do të vritet në 90% të rasteve, ashtu si nuk kupton një heroinë ruse që nuk bërtet kur i presin këmbën vetëm se ka turp për atë statuerë që ka treguar deri atëherë. Një mozaik i tërë historish femërore dhe femërore në librin e kësaj autore të bëjnë të kuptosh sesi është realisht lufta. Pa zbuluar. E vërtetë, si dy pika loti. Si është historia e vërtetë dhe më shumë se kaq, pse jeta është e bukur edhe kur lind nga vdekja.

Shumë vite më parë, një regjisor i njohur rus, në periudhën e fundit të marrëdhënieve në mes të dy vendeve tona kishte ardhur në Shqipëri për të bërë një film monumental për historinë e Luftës. E shoqëron një ish-partizan, Sofokli Lazri, më vonë një nga njerëzit më me ndikim në strukturën e lartë të drejtimit në Shqipëri. Historitë që ndan me regjisorin janë të bukura por nuk thotë asgjë. Të dy e dinë fare mirë këtë fakt. Shqiptari, si një njeri që e njeh kulturën e di mirë

kërkesën dhe ndihmën që kërkon regjisor. I duhet një fabul, që të ketë bazë të vërtetë për realizimin e tij. Koha e gjatë e të dyve me njëri-tjetrin ka rezultuar e kotë, derisa një moment i vjen ndërmend një histori e bukur dhe e jetuar e një bashkëvendasi të tij. I tregon historinë e Zaho Kokës, trimit që hapi luftën me fashistët në Bregdet dhe vdekjen e jashtëzakonshme të së dashurës së tij. Por, i tregon edhe sesi "e shpiku" luftën heroikë që të vetëvritet sepse jeta tashmë ishte e kotë për të. Regjisorin rus do të mahnitej. "Kjo është" - i tha. Paradoksalisht filmi do mbeste në mes sepe marrëdhëniet e vendeve dhe geopolitika ka logjikë tjetër. U fut në letargji dhe historia, sepse në fakt, përveç, z. Lazri, nuk u trajtua asnjëherë mirë. Fryma panegjirike e mori në qafë një nga historitë më të bukura të luftës, që do t'i shërbente letërsisë dhe jo vetëm.

Si për ironi të kohërave, Xhimi Lazri, i biri i Sofos, e ka përkthyer mesazhin nga rusishtja autore bjelloruse, me një regjistër shumë të përshtatshëm, por mbi të gjitha me një shpirt që tregon realisht një përballje të madhe historike dhe një respekt për luftën. Mësimi i librit është i bukur: Neve kemi nevojë për dëshmi të tilla, të tilla që tregojnë realisht përballjet njerëzore pa zbuluarime dhe pa panegjirizma. Këto të bëjnë të kujtosh realisht se çfarë ka ndodhur dhe jo vetëm.

Për fat të keq, Kosova, as 20 vjet pas luftës ka premisa ta mbyllë luftën me histori shumë qesharake, ku po shpallen heronj, njerëz që s'kanë fare lidhje me luftën dhe po ngrihen shumë kinse. Shqipëria është e tejmbushur me pseudo të desidencës dhe histori të stisura që e bëjnë qesharake një narracion të tërë, ashtu si komunistët dolën bluf me ngritjen e një idili luftime, që në të vërtetë nxori zbuluar shpesh gjëra të paqena dhe heronj të stisur. Ndaj, për këtë duhet letërsia dhe njerëzit e drejtë, ata që i vlejshëm çdo rregjimi sepse i duhen vetë historisë. Asaj të thjeshtës, që e bënë njerëzit realë.

A

ARGUMENT

NGA ARISTOTEL MICI

### APOLONIA - MAGNA URBS ET GRAVIS'

Qyteti antik i Apolonisë u themelua rreth fillimit të shekullit VI para Krishtit nga kolonistë helenë të ardhur nga Korinthi, Korkyra (Korfuzi), po ndoshta edhe nga Dyrri (Durrësi i sotëm). Apolonia qe vendosur që prej asaj kohe në tre kodra, të cilat arrijnë një lartësi deri 105 metra mbi nivelin e detit.

Ky qytet - shtet, (polis), jetoi për rreth nëntë shekujsh, që nga shekulli i VI para Krishtit dhe deri nga fundi i shekullit të IV pas Krishtit. Gjatë kësaj periudhe historike në Apoloni u përzënë me njera tjetrën tri kultura të lashtësisë: kultura ilire, ajo e helenëve dhe kultura romake.

Midis këtyre shekujve Apolonia do të rritej e zgjerohet nga koha në kohë. Në këtë qytet do të ndërtoheshin pallate luksoze e faltore madhështore, si tempulli i Artemidës, godina e administratës qeverisëse, biblioteka, odeoni, theatri i Madh. Pjesa qendrore e qytetit do të rrethohej nga një mur i trashë, me gjërësi 2.5 metra dhe me një gjatësi prej katër kilometrash. Për këto ndërtime u sollën gurë të skalitur me dimensione nga 60 centimetra deri në dy metra. Vetëm për të ngritur murin rrethues të qytetit duhet të jenë sjellë në Apoloni 100,000 metra kub gurë dhe tulla.<sup>2</sup>

Po ky qyteti qe bërë i famshëm dhe për arkitekturën e artin e tij. Shkolla Apoloniante e retorikës dhe e filozofisë kishte fituar emër dhe tërhiqte të rinjtë e shtrave të larta të shoqërisë së kohës antike. Për këtë mjafton të përmendim se në Apoloni ka studiuar për retorikë dhe filozofi edhe perandori Oktavian Augusti. Për më tepër, ai do të ndodhej këtu më 15 mars, 44, para Krishtit, kur në Romë komplotistët do të vrisnin ungjin e tij, Jul Çesarin. Po ashtu, në këtë kohë ndodhej për studime në Apoloni edhe një personalitet tjetër i asaj periudhe, Agripa<sup>3</sup>, që më vonë do të njihet si një nga strategët më të shquar romak, emrin e të cilit mban Pantheonin dy mijëvjeçar i Romës.

Oratori i famshëm romak, Ciceroni, i cili e vizitoi qytetin e Apolonisë, mbeti i mrekulluar nga pamja e këtij qyteti madhështor, me gjashtëdhjetë mijë banorë, dhe shkroi për të këto fjalë lapidare "Magna Urbs et gravis" që duan të thonë "qytet i madh dhe hijerëndë"

Qyteti antik i Apolonisë do të vazhdonte jetën e tij urbane deri në shekullin e katërt, pas Krishtit. Po që, më vonë, në shekujt e parë të kohës së Mesjetës, ky qytet do të tëkurrej dalëngadalë në një qendër të vogël peshkopale dhe administrative dhe me një emër fshati të shkurtuar nga ana fonetike, Pojan, si rikujtim i Apolonisë së dikurshme.

Një burim nga antikiteti tregon që Apolonia lidhej me detin Adriatik me anë të Vjosës, që kalonte nëpër trevat e saj, në faqen lindore të qytetit, ku duhej të këtë qenë një port lumor. Por kur shikojmë sot gurët e stërmëdhenj të murit ciklopiq, në hyrje të tempullit të Artemidës, si edhe gurët e tjerë të godinave antike, del pyetja se si janë mbartur ata gurë me ato peshë dhe përmasa aq të mëdha vetëm nëpërmjet një porti lumor? Pyetja tjetër që del është se nga janë gjetur ata gurë të rëndë për ato ndërtime?! As fushat, dhe as kod-

Autori mundohet të provojë qenësinë si port të qytetit të rëndë antik të Apolonisë.



rat e Myzeqesë nuk kanë asnjë lloj guri. Pra, ata gurë duhet të jenë sjellë nga vende të largëta, ndoshta nga ishujt shkëmborë të Mesdheut a po të detit Egje. Dhe mjeti kryesor për t'i mbartur deri tek porti lumor i Vjosës duhet të kenë qenë anijet e asaj kohe. Po a do të ishte i mjaftueshëm vetëm porti lumor i Vjosës për të përballuar gjithë ato mijëra e mijëra tonelata me gurë?! Dalin dy arsye që të bëjnë të dyshosh se porti lumor i Vjosës ka qenë mundësia e vetme e lidhjeve të Apolonisë me detin.

E para, si port lumor ai duhet të ketë qenë një port me kapacitet të kufizuar nga ana hapsinore për nevojat e një qyteti shtet (polis) prej 60,000 banorësh.

Arsyeja e dytë që të bënë të dyshosh për këtë çështje është fakti që ana lindore e kodrës së Apolonisë është shumë e thepisur, gjë që do ta bënte tepër të vështirë mbar-tjen e peshave të atilla, për t'i ngritur ato deri tek kulmi i kodrës në kuotën 105 metra lartësi. Prej aty, ato materiale shumë të rënda do të transportoheshin nga ana perëndimore e kodrës, ku shtrihet kryesisht qyteti. Në ndryshim nga ana lindore, faqja perëndimore e kodrës është shumë më e butë dhe bime shtruar buzë kënetës det, që ndodhej menjëherë nën kodrën e Apolonisë, kënetë e cila është e dallueshme edhe sot e kësaj dite. Këto rrethana të bëjnë të mendosh për mundësinë e ekzistencës së një porti detar ndën kodrën e këtij qyteti antik.

Sidoqoftë, Apolonia si qytet antik pati një emër të nderuar dhe jetoi për rreth nëntë shekuj. Po nga fundi i shekullit të katërt, pas Krishtit do të bjerë në dekadencë të plotë. Dy do të ishin shkaqet kryesore të rrënimt të saj, tërmeti i madh i vitit 345, si edhe devijimi i lumit të Vjosës, që, siç pohon Profetori plak, i ndjeri, H. Ceka, "në këtë kohë, nga fundi i shekullit II apo fillimi i shekullit III, pas Krishtit, Vjosa çan një shtrat të ri disa kilometra më në jugë". Dhe ky është mendimi më i drejtë lidhur me pozicionin e devijimit të Vjosës. Shtrirja hapsinore e Apolonisë, jashtë murit të saj rrethues, do të kuptohej më mirë, po të kemi parasysh disa qendra të vjetra banimi, që gjenden përfaqësisht, pra disa gjurmë të njohura e të panjohura. Të tilla janë: fshati Shtyllas, Kënetë e Hoxharës, Lumi i Vjetër (i quajtur figurativisht dhe Lumi i Vdekur), Bishti i Urës, "Tek Rrjedh ujë", Kurora e Laçanit, Ghëni e Premtja në Laçan, Gjoli i Portidit, Gjoli i Gallanit, Gjoli i Gjemisë, Sllaniku pranë Boçovës.

Midis këtyre emrave toponimikë, vendin e parë e zë Shtyllasi, një fshat kodrinor, ngjitur me Apoloninë antike, nga ana lin-





# Spinarica, porti detar i Apolonisë

dore e saj. Nuk ka nevojë të jesh arkeolog, që të kuptosh se emri "Shtyllas" vjen nga ajo shtylla antike nëntë metra e lartë, që ngrihet në majë të kodrës së këtij fshati. Ajo shtyllë, që është e vetmja pjesë e mbetur "në këmbë" e një tempulli të madh, tregon se deri ku arrinte shtrirja e Apolonisë jashtë mureve rrethues. Për këtë shtyllë ekziston edhe një gojëdhënë, sipas së cilës, dikur, në kohë të vjetra, atje, tek ajo lidheshin anijet, që vinin nga deti. Kuptohet se në këtë rast imagjinata popullore na ka bërë një rrëfim të hiperbolizuar, kur na e shpji detin deri në majë të kodrës së Shtyllasit. Po me gjithë ekzagjerimin e gojëdhënës, marrim vesh nga mesazhi i saj se deti e ka pas lagur Apoloninë, natyrisht, jo në majë, po në rrëzë të kodrës. Ky është njoftimi parë që na bën të ditur lidhjen e Apolonisë me detin. Pra, kujtesa popullore na tregon se Apolonia ka qenë një qytet bregdetar, dhe, që brenda gjirit të saj, do të ketë pasur edhe portin e vet detar.

Po në qoftë se Shtyllasi ndodhet lartë në kodër, në anën jug-lindore të Apolonisë; në anën perëndimore të saj gjendet Këneta e Hoxharës, si një pellg i madh ujqor, i cili për rastin tonë, vlen të diskutohet, se ç'është ky pellg ujqor?

## GJIRI DETAR I APOLONISË APO KËNETA E HOXHARËS ?

E vërtetë është se Këneta e Hoxharës prej shumë kohë shtrihet ndën kodrën e Apolonisë si një lagunë, në formën e një patkoi, që ngjante si gjiri deti. Gjatë dimrit, kur ngrihet niveli i detit nga lartësia e dallëve, anës perëndimore të saj nuk i dallohet me sy kufiri, sepse ajo bëhet gati njësh me detin, duke u kthyer kështu në një *kënetë-det*, siç po e quaj *une ne kete trajtesë*. Kurse në muajt e verës Këneta thahej, duke marrë pamjen e një gysmë shkretëtire. Ajo sipërfaqe ujore tani mbase nuk është më, si rrjedhojë e pun-

imeve bonifikuese, po që deri në mes të shekullit të kaluar ishte kreu e dukshme si një gjiri i gjërë deti në formën e një "patkoi" të madh ndën kodrën e anës perëndimore të Apolonisë. Kjo pamje ujore, në formën e *patkoi*, që e rrethuar nga disa fshatra, të cilët fillonin me Pishë Poron, Dëllinjasin, Fikthin, Jaruhën, Boçovën, Sopin, Pojanin, Hoxharën, ku merr kthesën ana perëndimore e "krahut të patkoi" për gjatë shtrimit të Lumit të Vjetër, duke u shtrirë në të gjithë bregun e tij, nga fshati Shën-Pjetër deri tek kisha e Shën e Premtes, të Kurora e Laçanit dhe tek Pirgjet e Laçenjve, buzë bregut të *dikurshtëm* të detit Adriatik.

Gjatë shekullit të XIX-të, mbase edhe ca dekada më parë, ky masiv ujqor do të quhej Këneta e Hoxharës, nga emri i fshatit Hoxharë, që ishte kryeqendra e çifligut të bejlerëve të Pjerit, ku ata ngritën dhe konakët e tyre si vazhdim i sarajëve në qytet. Kështu, nga emri i çifligut, Këneta mori emrin e *Hoxharës*, duke u lënë në harresë si emri i *Pojanit*, si edhe ai i *Apolonisë*.

Kjo kënetë, me gjithë xhepat dhe bryllakët e saj kishte një sipërfaqe harkore rreth 50 kilometra katrore. Ishte ashtu një *det-kënetë*, një gjiri lagunor: Kjo lagunë përgjatë vjeshtës dhe dimrit lidhej me detin përmes grykave të saj, po kur fillonte vera, këto lidhje ndërpriteshin dhe ujtë e kënetës, nga java në javë, avullonte derisa Këneta shterronte, duke nxjerrë tabanin e saj të shëllirte e shumë të kripur.

Nga ana e formimit të saj Këneta e Hoxharës i përgjante Kënetës së Nartës, pra i ngjet një gjoli, që ushqehet me ujën e kripur të detit. Po ndersa Këneta e Nartës e

ruajti kanalim ndërlihdhës me detin për gjithë kohën. Këneta e Hoxharës i humbi ato lloj gryka ndërlihdhesh si pasojë e lëvizjeve hidrike të ekuilibrit të detit.

Këneta e Hoxharës nga pikëpamja e formimit ngjan edhe me Karvasthanë si kënetë, po me ndryshimin se edhe Këneta e Karvastasë, si ajo e Nartës, i ka ruajtur kanalet lidhëse me detin, kurse Këneta e Hoxharës jo.

E bëmë këtë arsyetim me analogji midis tipeve të kënetave të kripura, për të mbështetur idenë që Këneta e Hoxharës, jo vetëm që ka origjinë detare, po ka qënë pjesë e detit, ose më qartë gjiri i detit Adriatik ndën kodrën e Apolonisë. Me këtë mënyrë arsyetimi, duam të kundërshtojmë edhe mendimin e shprehur nga ndonjë komentues gjeografik, që deklaroi se "*Semani dhe Vjosa kishin formuar në Hoxharë një kënetë të madhe nën kodrat e Apolonisë antike*". Një deklaram i tillë, që është shkruar edhe në Fjalorin Enciklopedik, nuk i përgjigjet të vërtetës për këto arsye:

**Së pari**, se të dy lumenjtë, si Semani dhe Vjosa, nuk janë lumenj të kripur, kurse Këneta e Hoxharës ishte me ujë të kripur, kripësia e ujit të së ciles ndryshonte sipas muajit dhe zonës.

**Së dyti**, lumenjtë e përmendur nuk e përmbysnin Myzeqenë çdo vit, kurse Këneta e Hoxharës thahej e mbushje me ujë në çdo vit në periudha sezonale të ndërvarura nga kushtet atmosferike dhe niveli i valëve

të detit.: Ajo, Këneta e Hoxharës, thahej çdo vit në fillim të verës dhe fillonte të mbushje me ujë në muajt e vjeshtës e të dimrit.

**Së treti**, për rreth periferisë së kënetës rriteshin bimë të tokave të kripura si jam-ruku, fshesa kripje, çoli, laboti i eger, grëmi i egër dhe të tjera bimë, që duan toka shumë të kripura dhe nuk rriten në toka me ujëra të ëmbla. Kjo tregon se shkalla e kripësimit të ujit ishte e fortë edhe në brigjet e kënetës.

**Se katërti**, në qendër të kënetës, atje ku kryqëzohen diagonalet e lagunës, që lidhin Pojanin me Shën-Pjetërën dhe Hoxharën me Boçovën, atje ku thellësia është më e madhe, pas avullimit të ujit, formohej një shtresë kripe. Atëherë, kjo pjesë e kënetës kthehej ashtu në një kripore primitive. Jam dëshmitar okular për këtë realitet dhe mbaj mend se deri në mesin e viteve pesëdhjetë të shekullit të kaluar, në fillim të çdo vere turma njerzish nga fshatrat rreth e rrotull vinin dhe mblidhnin kripë me shporta, me kosha e shosha. Ky episod është më domethënës që e kundërshton idenë se Këneta e Hoxharës është formuar nga uji i Semanit dhe i Vjosës.

**Së pesti**, banorët e krahinës rreth e përfaqë kënetës së Hoxharës e quajën tabanin e tokës së saj *si tokë shëllirë, dhe tokë trok*, dhe jo tokë të ujërave të ëmbla.

Të gjitha gjatat, si me sipër, japin të kuptosh se Këneta e Hoxharës duhet të jetë krijuar nga një gjiri i detit Adriatik ndën kodrën e Apolonisë, i cili, me kalimin e shekujve, me lëvizjet hidrike të ujërave detare u kthye në një lagunë, që komunikonte me detin Adriatik përmes grykave të njohura e të panjohura sot. Ky fenomen i lëvizjeve hidrike te detit është aq i dukshëm në bregun tjetër të tij, në bregun italian, konkretisht në Venecia, ku valët e Adriatikut futen deri në qytet, duke lëpirë edhe shkallët e katedrales së Shën-Markut. Ndërsa në bregun shqiptar, vetëm disa kilometra në veriperëndim të Apolonisë, në Gjirin e Semanit, deti ka prirje të futet në tokë. Si rast konkret për këtë fenomen të ekuilibrit hidrik të detit po tregojmë një shembull nga jeta reale: Në mes të shekullit të kaluar, ndër-marrja komunale e qytetit të Pjerit, ndërtoi dy rreshta me godina të thjeshta, tip kabina për pushuesit. Po ç'ndodhi!? Pas 40 e ca vjetësh ato godina u pushtuan nga valët e detit; pra deti mori tokë. Po kështu ndër kohë, më në jug, deti lë vend, ose largohet duke krijuar terrene moçalor. Po kjo dukuri e ekuilibrit detar të Adriatikut nuk është e re, ajo është një veti e tij e ngaherëshme. Dhe kur në dyzet vjet deti mori aq tokë në një anë dhe lëshoi aq vend moçalor në anën tjetër, çfarë duhet të ketë bërë ai për gjatë njëzet e ca shekujve në grykën e ish Gjirit të Apolonisë, që shumë më vonë do të quhej Këneta e Hoxharës? Gjatë kësaj kohe shekullore deti Adriatik është spostuar pak nga pak, duke lënë prapa një terren me pirge rëre (bëse), ose "duna" dhe gjole të kripur, që dalë nga dalë e zunë grykën e ish gjirit të Apolonisë, duke e kthyer atë në një lagunë të mbyllur për gjatë verës. Po, ndër kohë, ajo do të mbushje me ujë në vjeshtë e sidomos në dimër nëpërmje grykave të ndryshme, që janë të dallueshme edhe sot e kësaj dite.

Këneta e Hoxhars ka qenë e lundrueshme për nevoja peshkimi me lundra që voziteshin me shkop të gjatë. Lundrat, që përdorshin kishin formën e "sovajkës", pra të hulluara nga të dyja anët dhe nuk voziteshin me lopatë, po ngiteshin me një dru të gjatë, që në të folmen e karahinës quhet "koll". Këtë dru të gjatë lundërtari e vendoste në tabanin e lagunës, dhe shtynte me të tokën, po edhe toka, sipas ligjit të fizikës, ligji të veprimtimit dhe të kundërveprimtimit, e shtynte lundrën dhe ashtu realizohej vozitja mbi ujën e lagunës, që dikur pati qënë *kënetë-det*. Druri i gjatë, pra "koll", i shërbente lundërtarit edhe për të bërë kthesat, a po t'i jepte drejtimin lundrës. Nga kjo anë, dashje, pa dashje, këto lundra primitive të Kënetës së Hoxharës të kujtojnë "gondolat" e gjirit të Venecias, se edhe ato vihen në lëvizje po me anë të atij druri të gjatë, "kol-





➔ Vizion nga faqja 15

li", që venecianët e quajnë "palo".

Këneta e Hoxharës, para se të fillonin punimet nga ndërmarja e bonifikimit në mesin e shekullit të kaluar, siç është thënë më sipër, mbushje me ujë për gjatë vjeshtës dhe dimrit dhe thahej në mbarim të pranverës. Nga kjo anë këneta e Hoxharës ngjan edhe me regjimin ujqor të Lumit të Vjetër (nënkupto gjithnjë Lumi i Vdekur), i cili po ashtu, thahej në muajt e pranverës dhe "ringjallej" me ardhjen e vjeshtës. Gjithë lumenjtë e shpjenë ujin nga toka në det, kurse Lumi i Vjetër, bënte të kundërtën, merr ujin e detit dhe e sillte në vendet e ulta, duke mbushur Kënetën e Hoxharës. Ky vepër i këtij lumi, ose ky komunikim midis detit dhe lagunës bregdetare, ish më i dukshëm veçanërisht tek një kurorë e lumit, që populli e quan "Tek Rrjedh Ujtë". Ky emër toponimik është shumë domethënës për vazhden e arsyetimit tonë, sepse, atje tek ai vend, uji i kripur i lumit, që mbushje nga deti, lëpinte bregun dhe, pastaj teptiste me vrull në kënetë. Po, ashtu, si ky rast, ka pasur edhe shtigje ose gryka të tjera, ku uji i detit çante drejt lagunës. Ky fenomen ndodhte atëherë kur vinte "bura", kur shtoheshin erërat dhe ngriheshin dallgë të larta sa futeshin në grykën e Lumit të Vjetër, dhe në grykat e tjera si Vija e Mollës, e cila ishte një rrjedhë e hollë dhe e gjatë dhe, që lidhte detin me kënetën, duke e mbushur atë me ujë të kripur. Me këto fakte mbrojnë idenë se Këneta e Hoxharës ka origjinë detare dhe para se të bëhej kënetë, ka qenë gji deti, Gjiri i Apolonisë. Kjo kënetë nuk ka qenë si kenetat e tjera të Myzeqesë me ujëra jo të kripara, të cilat nuk kishin asnjë lidhje me detin dhe mbusheshin nga ujërat e shiut, a po nga ujërat e përrrenjesh, nga ujërat e rrëqeve dhe nga kanalet, si dhe prej degëve të lumenjëve, siç kanë qenë kënetat e Sheqit, kënetat e Grizës, kënetat e Rroskovecit e ndonjë tjetër.

Duke qenë se dikur Këneta e Hoxharës ishte një gji deti anës faqes së zbutur të Apolonisë, lejohej të hamendësojmë mundësinë e ekzistencës së një porti detar për nevojat e banorëve të sajë. Një port i tillë do ta lidhte me shumë Apoloninë me detin Adriatik. Në këtë rast, kisha e Shënë-Premtes në Laçan, si monument historik, mund të shërbejë si çelës për të rënë në gjurmë të portit të Apolonisë, ashtu siç e kam cilësuar edhe më parë në një studim botuar në Dielli, më 2014.

Kisha e Shën e Premtes në Laçanë është një godinë e vjetër kulti, që ka një pozicion dhe një vend-ndodhje shumë domethënës. Ajo gjendet në pikën më skajore të krahut perëndimor të "patkoit ujqor" të Apolonisë, atje tek mbaron gryka e Lumit të Vjetër, buzë bregut të dikurshëm të detit, ku duhej të ketë pas qenë një qytezë e banuar nga familjet detarësh, lundëtarësh, po edhe peshkatarësh. Atje, tek ky vend, dikur, i populluar, kjo kishë duhej të ketë qenë epiqendra e asaj qyteze të zhdukur.

Kjo kishë, e cila ndodhet në një terren të pabanuar, si në një gjysëmshkretëtirë, pa asnjë shtëpi për qark, pa as edhe një kasolle, a po tend barinjësh pranë, të tërheq vemendjen me ekzotikën e vet.

Kështu, për specifikën e saj, kisha e Shënë-Premtes, si një faltore e moçme, duhet marrë si pikë orientuese, për të shikuar në thellësi të shekujve lidhur me pellgun ujqor të Apolonisë, pra të gjirit të saj detar, në kërkim të portit të mundshëm.

Ashtu si e mbaj mend, deri në vitin 1955, kur e kam vizituar tok me shkrimtarin Jakob Xoxa,<sup>3</sup> kisha e Shën e Premtes ngrihej në një vend gjysëm të shkretët, tek Kurora e Laçanit, në bregun e majtë të Lumit të Vjetër, afër grykës së tij. Nga jugu kishite kufi një rrëqe të kripur, që quhej Vija e Mollës dhe nga ana tjetër, në lindje shtriheshin kënetat e kripur e Hoxharës, kurse në anën veriore të saj ndodhej një pyll i degraduar me vidha, verrinj, frashër dhe dëllinj, po ku nuk mungonin ferrat dhe shkurret e marinave. Ky ishte Pylli i Shënë -Premtes, që nuk prekej për dru zjarri nga banorët e

zonës për qark. Ky pyll dukej nga portiku i Apolonisë si në pëllëmbë të dorës tok me gjithë kishën e Shënë-Premtes. Jo kujdesi shtetëror, po "hija" e vet shënjtore kishite ruajtur për shekuj me radhë edhe kishën edhe Pyllin e Shënë-Premtes. Mbas mend mirë se në të majtë të këtij pylli ndodheshin edhe disa rrënjë ullinj, në grup, si një korije e vogël ngjitur me drurët pyjorë. Ishin ullinj me kokërra të vogla dhe bërthamë të madhe, por shumë vajës. Në të folmen e vendit quheshin "ullastra", mbase nga latinishtja "oleastro", ulli i egër. Prania e atyre ullinjve afër kishës së Shënë-Premtes të kujtonte me një herë ullinjët tek kodra e Apolonisë, atje tek hyrja e tempullit të Artemidës. Në rastin konkret kjo dukuri është domethënës, sepse flet për një pikëtake

"Laçove" vendi u quajt Laçanë, kurora e lumit atje u quajt kurora e Laçanit dhe kisha filloi të thërritej po ashtu Shën e Premtja në Laçan".

Është e qartë se në këto rrëfime kemi të bëjmë me një bestytini. Po me gjithë atë, brenda kësaj bestytinie, lihet i nënkuptuar një realitet gojëdhanor. Në këtë rast, me shejtanët, që vini nga deti, duhen marrë me mend grupe piratësh, grabitsish, ose ushtri të fisve barbare, që sulmonin duke u futur nga ana e detit dhe terrorizonin familjet e pambrojtura të qendrës së banimit rreth Shënë-Premtes në Laçan. Kështu që kjo qendër e populluar dhe e pasur u kthye, ndër kohë, në shkretim. Po para se të meditojmë për qytetërimin e mundshëm të këtij vendi të braktisur, vendit ku ndodhet sot



# Spinarica, porti detar i Apolonisë

## Spinarica

Me gjithëse Spinarica pas vitit 1370 nuk do të duket më nëpër harta dhe dokumente historike, ajo me siguri që nuk humbi e as u fshi brenda një viti. Jetëgjatësia e saj ndërvarej nga deti Adriatik, i cili në vendin ku që shtrirë ajo, kishite prirje të largohej pas. Sa më shumë largohej deti, aq më tepër pakësohej aktiviteti portual i Spinaricës. Në mungesë të dokumenteve për këtë dukuri, na vjen në ndihmë gjuhësia me anë të toponimisë.

godinën do ta merrte në mbrojtje Instituti i Monumenteve dhe do t'i vinte një çati të re përsipër. Pra shkurt, ndërtesa e kishës së Shënë-Premtes është e veçantë nga gjithë kishat. Specifika e saj duket se pari nga teknika ndërtimore, ku bije në sy mesjetëria greko-romake, po edhe vendosja bizantine me ajodhimë nga ana lindore. Për vjetërsinë e saj mjafton të shikosh me vemendje gurët e themelit dhe tullat e mureve. Së dyti, altari (nënkupto *abside-n*) nuk është i ndarë nga plateja, kështu që altari më tepër është simbolik se sa funksional, së treti, në kishën e Shën e Premtes mungojnë simbolet religjioze, nuk ka asnjë afresk, asnjë skulpturë, asnjë imazh të ndonjë shenjtori të krishter; asnjë gjë të gëdhëndur në mur, madje asnjë shënjë të kryqit. Pra, kemi një godinë të fortë dhe shumë të vjetër, nga njera anë, dhe nga ana tjetër, një kishë në gjendje primitive. Po që të dyja këto anë, si konstrukti rëndë dhe fortë dhe gjendja primitive e faltores së Shënë-Premtes flasin për lashtësinë të herëshme të themelimit të saj. Për përfytyrimin tonë, kisha e Shënë-Premtes, që ndryshon nga paraqitja dhe kompletimi i kishave të tjera, nuk duhet parë si rast i veçantë nga Apolonia, po si një pjesë integrale e hinterlandit të saj më të afërt, ose të paktën një vazhdim i vonuar i qytetërimit të atij qyteti antik, si një relikte e gjallë, mbase e portit të dikurshëm detar të Apolonisë. Nga kjo anë, nga ana e antikitetit, kisha e Shënë-Premtes të kujton "Shtyllën" e Shtyllasit, një





### ...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri ishte relativisht e mirë, por me jo shumë substancë. Temën kryesore e mori një shkrim për Prengë Bibë Dodën dhe një apel që bënte studiuesi Ndrek Gjini, i cili jeton në botën britanike. Një kostum i Prengë Bibë Dodës i është dhuruar udhëheqësit sovjetik Hrushov, nga Enver Hoxha në vizitën e tij historike në Shqipëri. Duhet thënë se shkrimi më shumë i kushtohet një minihistorie të familjes së njohur mirditore, por redaktori zgjodhi këtë titull. Themi se shkoi mirë, por shkrimi ishte i hartuar jo shumë mirë. Gjithsesi, Ndreka është interesant në parashkrimet e tij edhe pse ka pak tipare spektakulare në gjërat që shkruan për vendin. Ndoshta prej largimit për një kohë të gjatë. Redaktori u mor pak me një përkujtim të Teodor Kekos, një koleg të vjetër që kanë ndarë pak gjëra në të gjallë, por jo ndonjë miqësi të ngushtë. Bashkë me shkrimin e tij botoi dhe një letër të së shoqes, në vazhdim të përhershme të mesazheve në eter që ajo po bën për të ndjerin dhe pastaj do t'i mbledhë në një libër. Për fat, shkrimi u pëlqye dhe redaktori i vjen mirë. Të paktën, Dorit i është bërë nderimi i duhur dhe vetë redaktori e ka plotësuar këtë

angazhim ndër vite. Në këtë numër u botua një shkrim i një punëtoreje të arsimit, e cila i kishte dedikuar diçka librit të Demir Gjergjit, një letrar lirik i këndshëm dhe gjithnjë dashamir me Milosao. Poezitë e këtij numri i takonin Fasli Halilit dhe na vjen mirë që atij i kishin pëlqyer dhe përveç kësaj edhe i kishin sjellë shumë kënaqësi. Është e habitshme mënyra sesi percepton tashmë jetën që e rrethon dhe megjithëse figuracioni duket si tejet klasik përmban të gjithë dhimbjen e një brezi që priste shumë nga Shqipëria por që shpreh zhgënjimin se asgjë nuk u realizua, ashtu si duhej. Autori botoi dhe një tregim të Teodor Kekos, që duhet thënë se kishte një lloj vlere. Numri mendojmë se ishte i mirë, por mendojmë se mund të tregonte shumë më tepër cilësi nëse do kishte një shpërndarje më të mirë të materialeve. Redaktori punoi disi i sforcuar, ndërsa layout në këtë numër ishte i mirë. Numri ishte fare i zakonshëm dhe pak patetik në thelb.



kolonë, që duket për kundruall kësaj kishe në distancë si një gisht gjiganti drejtuar qiellit. Dhe ashtu si "Shtylla" e Shtyllasit, nëntë metra e ca e lartë, qendron në këmbë e patundur si shprehje e qytetërimit antik, dhe Shëne-Premtja në Laçanë qendron dhe ajo ende e fortë, po si një godinë "e gjallë" prej një kohe të vjetër. Po ndërsa "Shtylla" e Shtyllasit tregon kulmin e lulëzimit të Apolonisë, "godina" e Shëne-Premtes duhet të shprehë fundin e saj, ose më mirë fundin e fundit të Apolonisë, pra mbarimin e portit të saj detar, që siç po përpjejm ta parash-troj, është SPINARICA. Në mbështetje të këtij mendimi na vjen në ndihmë dhe " *pohimi i disa autorëve, që argumentojnë tashmë idenë se Spinarica e Mesjetës nuk është gjë tjetër veçse porti i dikurshëm i Apolonisë antike*"<sup>10</sup>. Atëherë, në se pranohet si e argumentuar kjo ide e këtyre autorëve, domethënë se Spinarica është vazhdim i qytetërimit të Apolonisë antike, për rrjedhojë, edhe kisha e Shëne-Premtes, si zemra e qytetës, duhet të jetë vazhdim i atij civilizimi. Teknika e muraturës së ndërtimit mund ta nxjerrë faltoren rreth shekullit XIII, po gjykimi historik, dhe sociologjik mund të shkojë përtej gjykimit inxhinierik. Pra, jo si godinë, po si vend i shenjtë mundet t'i përkasë asaj periudhe kur ky qytet, në Mesjetën e largët, nuk kishte më asnjë autoritet dhe kish humbur çdo lloj pushteti, për të mbrojtur jetën edhe banesat e qytetarëve. Pra, mund të ketë qenë ajo periudhë kohore, kur vinin nga deti dhe shtetërit e këqij, (Laçot) siç i ka quajtur populli keqbërësit grabitqarë, që masakronin banorët në shtëpitë e tyre deri sa i detyronin të braktisnin vendin, atë vend që mori pastaj emrin **Laçan**, emër toponimik ky, që përforcohet nga një tjetër toponim, që populli e quan "**Kurora e Laçanit**"<sup>11</sup>. Ndërkaq, duke komentuar vjetërsinë dhe vendin ku ndodhet realisht kisha e Shëne-

### Aludimet për Apoloninë

Një mikro-toponim nga mund të nxjerrim një të dhënë më tepër rreth portit detar të Apolonisë është edhe tog fjalësh Bishiti i Urës, që është një rip toke në lindje të fshatit Shën-Pjetër, që futet në kënetë si gadishull i vogël, dhe i afrohet Pojanit fare pranë. Ky fshat ka edhe në perëndim të tij një "bish" toke tjetër të future në kënetë, që quhet Bishiti i Kaminave, duke marrë ashtu një kuptim real, sepse aty ndodhen vërtetë kaminat e vjetra dhe të reja. Kurse Bishiti i Urës formonte një enigmë, për të cilën nuk e vriste mendjen kurrëkush.

Premtes në Laçan, duam të shprehim vretjen tonë lidhur me gjykimin e Prof. A Meksit rreth kësaj kishe. Në librin e tij për kishat<sup>11</sup>, ai e ka vendosur atë në fshatin **Sop**, duke e quajtur "kisha e Sopotit". Ky lokalizim është i gabuar. Sgarojmë se Sopi është një fshat ngjitur me Pojanin, kurse kisha e Shëne-Premtes ngrihet në anën e kundërt të kënetës, në breg të Lumit të Vjetër, në Laçanë. Për të bërë atë udhë, pra për të ikur nga Sopi deri tek ndodhet kisha, në Laçan, do të duhet të kalosh disa fshatra anës e përgark kënetës siç janë Sopi, Jaruha, Sllaniku, Boçova, Fikthi, Pishë -Poro e deri në Kerrnicë, e në Povelçë. Për nga distanca, kësaj i thonë një lloj si të shpeshë kishën e Shën-Prokopit të Tiranës diku midis Mëzezit dhe Kasharit..... Ndërkaq, lokalizimi i kësaj kishe larg vendit të real, e shkëput atë nga mikrotoponimia rrethuese, nga legendat dhe rrëfimet e ndryshme të trualtit të vet, gjë që vetiu vështirëson përcaktimin e kohës së themelimit të saj si faltore. Në librin e tij Prof.Meksi shkruan

*se përta i përket kohës së ndërtimit të kishës duhet të nisemi, në mungesë të të dhënave burimore a po mbishkrimeve, nga teknika e ndërtimit të mureve. Me të njëjtën teknikë është ndërtuar trapezaria e Manastirit të Pojanit, e cila datohet në fund të sh. XIII. Kështu mendojmë se duhet të jetë ndërtuar edhe kisha e Sopotit - [Pra, nënkupto Kisha e Shën e Premtes në Laçan- shenimi ynë AM]. Mirëpo, duke u mbështetur te ky pohim, vetiu me anë të deduksionit, dalim tek pyetja, se pse ata ndërtuesit e lashtë të kishës së Shën e Premtes në Laçanë të mos jenë mbështetur tek kisha e Shën-Mrisë së Pojanit, po tek trapezaria ? Pse të kenë marrë ata si shembull ndërtimor teknikën e "Trapezarisë" të kësaj kishe dhe jo atë të vet kishës?, ndër kohë, kur ata kishin për qëllim të ndërtimit një kishë dhe jo ndonjë godinë dosido.?*

Po edhe historiani i ri, I. Gjika, në një artikull të botuar në "Mapo", nxitohet kur nuk merr para sysh toponiminë e krahinës dhe e vendos këtë kishë, ku nuk duhet të jetë, në Hoxharë. "Në Myzeqe të Fierit, - shkruan ai- në vendin e quajtur Hoxharë, ndodhet një objekt kulti i braktisur prej kohësh. Është kisha e shën e-Premtes".<sup>12</sup> Ky

Shën e Premtes, që është kundrull Apolonisë, ndodhet afër grykë-derdhjes së Lumit të Vjetër, pikërisht të Kurora e Laçanit. Në këtë rast çudija është se ka grykë-derdhje, po nuk ka det. Atëherë, ku derdhej Lumi? Në të vërtetë, historikisht, Lumi i Vjetër derdhej në det, po ndër shekuj deti ka ikur më tutje, pra është spostuar afro dy kilometra më larg.

E bëmë këtë prezantim faktshë, për t'iu përgjigjur indirekt pyetjeve: Pse ka qenë ngritur kjo kishë? Kujt i është dashur në një vend të shkretë që të ngrerë një godinë me materiale aq të rënda dhe të kushtueshme për atë kohë historikisht të largët? Cilës kohe i përket kjo kishë? Sa kohë ka zgjatur shërbimi religjioz i kësaj kishe? Pse e braktisën besimtarët faltoren e tyre? A mund të jetë kjo kishë vazhdim i vonuar i qytetërimit apoloniat? Po, si shihet, gjithë gjasat rreth saj të shpjenë tek mendimi se kjo kishë, duhet të jetë epigendra e një qytetërimi të hershëm **iliro-arbëror** të braktisur gjatë shekujve.

Mesa duket, Shën e Premtja në Laçan ka qenë faltore e një qyteze bregdetare. Duke u nisur nga disa të dhëna arkivale si edhe përshkrime detajesh prej historianëve, dalim në përfundimin se Shën e Premtja është një godinë historike, që tregon vendndodhjen e një porti të vjetër si mund të ishte Spinarica. Tek kjo ide të shpije një konstatim i historianes Lucia Nadin, profesoreshë në Universitetin e Venecias, cila në një botim të saj, kur përmend praninë veneciane në bregdetin shqiptar, tregon se disa qytete mesjetare komunikonin me Venecian qysh nga shekulli i njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë e trembëdhjetë. Pasi flet për portin e Durrësit, ajo na tregon të tjera porte siç ishin Butrinti, Parga, **Spinaritza**, ishulli i Sazanit, Lezha, Tivari, Shkodra<sup>13</sup>. Duke lexuar këto rreshta, të shkon mendja tek vend-ndodhja e këtyre qendrave qytetare të Mesjetës, dhe vemë re se përveç Spinaricës, të gjitha qyteteve të sipërpërmendura, u dihet vend-ndodhja,



kurse *Spinaritës* jo. Kështu që ky port mesjetar, i cili ka jetuar të paktën, sipas dokumenteve shkrimore, prej vitit 1205 dhe deri në vitin 1370, del të jetë pa vendndodhjen e vet përkatëse. Atëherë, duke qenë se në Laçan, buzë detit, ekzistojnë një kishë e mesjetës, me ngjasje të jetë e shekullit të XIII, mbase dhe më e vjetër, kemi arsye kështu, ta piketojmë Spinaricën e periudhës mesjetare pikërisht këtu, në Laçan. Për të arritur tek mendimi se këtu duhet të jetë vendndodhja e këtij porti, na vijnë në ndihmë edhe të dhënat shkrimore, që tregojnë përfarësisht vendin ku duhej të ish

→ Vizion nga faqja 17

Spinarica. Dhe ja një fakt në librin “*Historia e Artikitekturës*” që në f. 6, shkruan: “*Rruga e Muzakies, rreth 50 km. e gjatë, në Kuç bigëzohej. Një degë vazhdonte deri në Apoloni ose Spinaricë*”. Nga këto fjalë kuptohet se Spinarica gjendet diku pranë Apolonisë. Atëherë, për të lokalizuar Spinaricën, ku ka vend më të mundshëm se sa trualli i Shënë –Premtes në Laçan, karshi Apolonisë, në buzë të detit, atje, ku qëndron në këmbë ky monument i fortë kishtar i Mesjetës.

Çështja e lokalizimit të Spinaricës ndriçohet edhe më shumë, nga një detaj tjetër, që sjell para studiuesve Prof. P. Xhufi në veprën e tij “*Nga Paleologët tek Muzakajt*”, ku përshkruhet ky paragraf: “Një anije raguziane e nisur nga Durrësi u detyrua për një avari të ankorohej në vendin e quajtur **Slanicë** pranë **Spinaricës**. Këtu u shkarkua ngarkesa me mall, që pastaj u shpërnda në shtëpitë e Buvalcariorum de la Polina...Polina është emri mesjetar i Apolonisë së lashtë dhe i Pojanit të sotëm”<sup>15</sup> Nga ky episode kuptohet se Laçani, trualli ku gjendet Shënë e Premtja, është Spinarica. Pra kemi tre caqet e një trekëndëshi në perimetrin e lagunës së Hoxharës: Apolonia në lindje, Slanica, në jug-perëndim të Apolonisë, dhe Spinarica (nënkupto) Shënë e Premtja në Laçan nga ana e perëndimit. Dhe për të qenë sa më preciz, duhet të theksojmë që, nëqoftëse Spinaricën e lokalizojmë rreth Shënë-Premtes në Laçan, pra në fund të bregut perëndimor të ish -Gjirit të Apolonisë, Slanica duhet kërkuar kundruall saj, në anën jugore të ish gjirit, në fshatin Bogovë, të vendi i quajtur Slanik, po jo në Vjosë, sepse ajo ndodhet disa kilometra larg ish Gjirit detar të Apolonisë.

Lumi i Vjetër  
Një toponim me rëndësi në hinterlandin e Apolonisë është edhe *Lumi i Vjetër*, që realisht është shtrati më i vjetër i lumit të Semanit, i cili shumë kohë më parë ndrori drejtim në veri-perëndim, andej nga vazhdon rrjedhjen e tij edhe sot, disa kilometra më larg. Me kalimin e viteve shtrati vjetër i lumit nisi të thahet, sidomos gjatë stinës së verës, aq sa peshkatarët, gjathtarët dhe bujqit e zonës nisën ta quajnë figurativisht dhe *Lumi i Vdekur*.

Konturet e shtratis të Lumit të Vjetër janë më se të dallueshnë edhe sot e kësaj dite. Që në femijëri dhe në rininë time të parë i kam përshkruar në këmbë të dyja brigjet e këtij lumi. Ai shkëputet nga rrjedha e “gjallë” e Lumit të Semanit në fushëtirën e fshatit Shterpas. Atje, ky lumë, me far pak ujë, kalon pastaj në fshatin Seman, të cilin e ndanë nga Kavakllia. Pas pak kilometrash ai ndanë dhe fshatin Raman nga Gjokallia. Duke ecur drejt jug-perëndimit, veçon nga njeri tjetri edhe dy fshatra të tjera, Shën-Pjetër dhe Topojën. Duke bërë gjarpërime dhe kurora, le pas edhe këto dy fshatra edhe vazhdon udhën drejt perëndimit. Kurora e fundit e tij është ajo që quhet *Kurora e Laçanit*, ku gjendet dhe kisha e Shënë-Premtes. Kurse në të djathtë të saj është gryka e Lumit të Vjetër, ose e *Lumit të Vdekur*. Ka rëndësi të kuptohet ky lokalizim i grykës së Lumit të Vjetër, sepse është vendi ku ky lumë dikur derdhte ujën në detin Adriatik, po që deti gjatë shekujve u largua, duke lënë pas gjole dhe moçale.

E përshkrova me hollësi shtratin e *Lumit të Vjetër*, për të demonstruar në mënyrë sa më bindëse se ky lumë është shtrati më i vjetër i Lumit të Semanit dhe që nuk është dhe nuk ka si të ish për asnjë mënyrë gjurmë e Vjosës.

Së dyti, me anë të grykës së këtij lumi dua të tregoj bregun e dikurshëm të detit Adriatik.

Së treti, dua të pohoj se qyteza rreth Shënë-Premtes në Laçanit ka qenë një port bregdetar.

Së fundi, doja të sqaroja me këtë rast dhe një paqartësi shkrimore të studiuesit Ilirian Gjika, që në artikullin e tij të botuar në *Mapo*<sup>16</sup>, kur permend shkrimin tim esesisht të botuar në *Dielli*, më 2014, lidhur me portin detar të Apolonisë, autori le të nënk-



# Spinarica, porti detar i Apolonisë

uptuar sikur unë *Lumin* e *Vjetër*(ose *Lumin* e *Vdekur*) e identifikoj me *Vjosën*, gjë që nuk është e vërtetë. Pra nuk e kam shprehur këtë gjë. Përkundrazi, prania e *Vjosës* në Laçan të Shënë e Premtes nuk mund të pranohet për dy arsye: Së pari se kjo ide bie në kundërshtim me mendimin e Prof. H. Cekës, i cili deklaroi se “*Vjosa devijoi duke çarë një shtrat të ri disa kilometra në jug*” andej nga ajo vazhdon udhën edhe tani. Së dyti, si do të mundëj ky lumë që të ikte në jug, dhe të kthente pas, një qind e tetëdhjetë grade, në veri nga ana e Shënë e Premtes në Laçan dhe pastaj të niste përsëri drejtimin po për në jug, atje ku gjendet sot!

Një mikro-toponim nga mund të nxjerrim një të dhënë më tepër rreth portit detar të Apolonisë është edhe tog fjalësh *Bishti i Urës*, që është një rrip toke në lindje të fshatit Shën-Pjetër, që futet në kënetë si gadishull i vogël, dhe i afrohet Pojanit fare pranë.

Ky fshat ka edhe në perëndim të tij një “bisht” toke tjetër të future në kënetë, që quhet *Bishti i Kaminave*, duke marrë ashtu një kuptim larg, sepse aty ndodhen vërtetë kaminat e vjetra dhe të reja. Kurse *Bishti i Urës* formonte një enigmë, për të cilën nuk e vriste mendjen kurrëkush. Po nga mezi i viteve pesëdhjetë të shekullit të kaluar, enigma e *Bishtit të Urës*, filloi të fletës. Kjo ndodhi atëherë kur teknikët e bonifikimit të tokave hapën një kanal të madh kullues duke filluar nga ajo pjesë e kënetës që quhet *Vija e Ngjalës*. Kur punimet arritën në pozicionin midis Pojanit dhe Bishtit të Urës, bonifikuesit gjetën gurë në dy metra thellësi. Atëherë banorët aty afër vranë mendjen, duke thënë se kur u zbuluan gurë në kënetë, pse të mos gjejmë gurë edhe tek *Bishti i Urës*, ku mund të ketë pas qenë me gjasme një urë. Dhe nga një hendek i thellë, që e hapen si gropë, u gjetën vërtetë gurë. Kështu që enigma e Bishtit të Urës, si një metaforë e mbuluar nga dheu dhe kënetë, u zgjua nga gjumi shekullor dhe nisi të tregojë se atje dikur kish qenë një urë, që bashkonte dy pjesë të një udhe, kjo mbase është ajo rrugë, që lidhte Apoloninë me portin e saj detar.

Kështu që me shprehjen metaforike *Bishti i Urës*, si toponim, kemi një detaj më tepër, për të pranuar lidhjen e Apolonisë me portin e saj detar. Po fjala “urë” e toponimit “*Bishti i Urës*” krahas anës historike që humlont, merr edhe një kuptim *linguistik*, sepse shpreh kuptimin e një objekti siç është “urra”, e cila edhe në ilirishten e taulantëve ka pasur të njëjtën formë fonetike e morfologjike. Pra në historinë e gjuhës së folur, fjala “urë” është një dëshmi tjetër, sa

do e vogël, për të treguar prejardhjen e gjuhës shqipe nga ilirishtja.

**Toponimia rreth Shënë e Premtes në Laçanë**  
Me gjithëse Spinarica pas vitit 1370 nuk do të dukej më nëpër harta dhe dokumente historike, ajo me siguri që nuk humbi e as u fshi brenda një viti. Jetëgjatësia e saj ndërvarë nga deti Adriatik, i cili në vendin ku që shtrirë ajo, kishte prirje të largohej pas. Sa më shumë largohej deti, aq më tepër pakësohej aktiviteti portual i Spinaricës. Në mungesë të dokumenteve për këtë dukuri, na vjen në ndihmë gjuhësia me anë të toponimisë. 1)Për këtë rast le të përmendim në fillim faktin se më në perëndim të kishës së Shënë-Premtes, gjendet një gjol i vogël, me emrin **Portiq**. Siç kuptohet, rrënja gramatikore e këtij emri perbehet nga fjala “*Port*”, kurse mbarsa e fjalës “**iq**” është një prapshetë ende e gjallë në të folmen e zonës dhe formon emra zvogëlimi, ose emra zvogëlimi dhe me kuptim pejorativë. Po nga kjo prapshetë janë formuar edhe emra të tjerë si **shkuratabiq, furriq, korroziq, kaciq, iliq, kakarriq, lakuriq** (i natës) pra, ashtu si është edhe formimi i fjalës **Portiq**. Kështu shekuj më parë, banorët e kesaj zone duhet ta kenë quajtur gjolin fare pranë Shënë e Premtes “*Port-iq*”, që në kuptimin e parë leksikor do të thotë “*Port i vogël*”. Me një fjalë është e pranueshme nga goja e popullit se pranë Shënë-Premtes ka pas qenë një “*port*” detar, ku duhet të jene ankoruar lundrat e dimensioneve të ndryshme. Dhe në këtë mënyrë vrohet se porti i madh i Spinaricës është zëvendësuar nga një më i vogël, po ku deti kishte ende thellësi.

2)Në ndihmë të tezës se porti i Apolonisë , Spinarica, ka pasur një lloj vazhdimësie, na flet prania e një emri të dytë toponimik Gjoli i **Gallanit**, i cili ndodhet gjithashtu pas shpinës së kishës së Shënë-Premtes, në perëndim të saj. Nuk është e vështirë të marrësh me mend se rrënja gramatikore e këtij emri “*Galla-n*” ka lidhje me një fjalë me origjinë latino-veneciane nga sfera e lundrimit lagunor, siç është fjala “*galla*”, që në fjalorin *italisht-shqip* shpjegohet: “*rri mbi ujë, ose dal mbi ujë*”, (ifinitivo, *galleggiare= rri mbi ujë*),( *galleggiante=bovë*). Vetëkuptohet se ky toponim “**Gallan**” e merr emrin nga qendrimi i lundrave mbi ujë, ose nga lëvizja e këtyre lundrave mbi ujët e lagunës, po që, gjithësesi zanafilla e fjalës ka pas të bëjë me sferën e lundrimit, aq shumë sa i ka dhënë dhe emrin gjolit në fjalë, *Galla-n*.

3)Në favor të tezës se Spinarica ka pasur gjithnjë një farë vazhdimësie në një

# P

POEZIA



NGA MOIKOM ZEKO\*

I PADUKSHËM

Tunden në horizont erërat, me pranga rrefush, - s’dalin nga burgu i natës!

Unë jam i padukshëm, - radioaktivitet mendor, - tek të gjithë ju, dhe nëse jeni në gjumë, ose të zgjuar!

Ç’janë këto mite, maska semantike të fjalëve të mia?

Në breg të Durrësit, është thyer dhe ka mbetur anija e agimit, të *Ditës së Re!*

2008-2009

ΑΟΡΑΤΟΣ

*Οι άνεμοι σαλεύουν στον ορίζοντα, με χειροπέδες, -δεν βγαίνουν από τη νυχτερινή αγκαλιά!*

*Είμαι αόρατος, - νυχτική ραδιενέργεια, - σε όλους σας, και αν είστε κοιμισμένοι ή ζυπνίζετε!*

*Τι είναι αυτοί οι μύθοι, η σημασιολογική μάσα των λέξεων μου;*

*Στην ακτή του Δουραχίου, παραμένει ναυαγισμένο το πλοίο της χαράωνής της Νέας Ημέρας!*

2008-2009

MBRETËRESHË E ZEZË SHAHU

Më tërheqin ngjyrat e largësisë si instinktin e langoit turtujt!

Ah, t’i hapja dhe t’i mbyllja sytë, si buzët e Mona Lizës, që s’e tha kurrë, rëfimin e saj, të fshehtë!

Tri *Parajs*a jap, veç për *nollanet* prej druri, me të cilat ecja, duke trokëllitur, mbi plllocat prej guri, të oborrit, të feminisë së harruar!

Ikën koha, pastaj e plotfuqishme zotëron gjithçka Nata, si *Mbretëreshë e Zezë shahu!*

2004-2009

H ΜΑΥΡΗ ΒΑΣΙΛΙΣΣΑ ΤΟΥ ΣΚΑΚΙΟΥ

*Με έλκουν τα χρώματα των αποστάσεων, όπως το ένστικτο των κυνηγόςκυλων τα τρυφόνια!*

*Αι, ν’ ανοίγα και να κλείνα τα μάτια μου, όπως τα χείλη της Μόνας Λίζας, που δεν μαρτύρησαν ποτέ, το μυστικό της!*

*Χαρίζω τρεις Παράδεισους, μόνο για τα ζύλινα τσόκαρα με τα οποια περπατούσα, χτυπώντας τις πέτρινες πλάκες, της αιλής, της ξεχασμένης παιδικής ηλικίας!*

*Ο χρόνος φεύγει, μετά παντοδύναμη κατέχει τα πάντα η Νύχτα, όπως η Μαύρη Βασίλισσα του Σκακίου!*

2004-2009

→ Vizion në faqen 20



Poezia e Moikom Zeqos vjen e përkthyer në greqisht nga Petro Çerkezi. Në një traditë që kemi krijuar po e botojmë në dy gjuhë, në shenjë nderimi për gjuhët dhe përkthyesin, por edhe si nderim për kulturat tona

# NATA ME KATËR HËNA



## MBISHKRIM SEKRET

Vera kalbet, plot re mizash!

C'janë këto figura femrash, të ulura, në relievet e stelave antike, sikur dëgjojnë një muzikë të largët?

E ktheh Hënën së prapthi, për të lexuar një mbishkrim sekret, që ende askush nuk e di!

Gjaku im!

Gjaku, "sangium martirium".

Ëndërra e një kali plak e rrit vullshëm barin e pllajave!

2004-2009

## MYSTIKË EPIGRAΦH

To kalokaïri sapitëzi, γεμάτο νέφη από μύγες!

Ti ëstë ai që vjen nga këmbët e qytetarëve, si anëtarë të një bashkësie, si anëtarë të një bashkësie, si anëtarë të një bashkësie, si anëtarë të një bashkësie.

Anapodogriζw to φεγγάρι, για να διαβάσω μια μουσική επιγραφή, την οποία κανείς δεν γνωρίζει ακόμα!

To aïma mou!

Aïma, «sangium martirium».

To óνειρο ενός γεράλου αλόγου μεγαλώνει παράφορα τα χόρτα του οροπέδιου!

2004-2009

## ËNDËRRA MARSIANESH

Si ta kungoj këtë horizont me kupën e mbushur me Arin Blu të detit?

C'ëndërra marsianësh, më sulmojnë trurin?

Dhe djajtë biznesmenë e blejnë Meshën Elektronike të Mediolive!

Lëkurën time e var në kremastar si një rrrobë të vjetër!

Tërë letrat e mia, i nënshkruaj, me një meteor!

2004-2009

## APIANÁ ONEIΦA

Pώς μπορώ να μεταλάβω αυτόν τον ορίζοντα με το κίπελλο γεμάτο με το χρυσό γαλάζιο της θάλασσας;

Ποια Αριανά όνειρα, επιτίθενται στον εγκέφαλό

Kai oi daïmones epixerimatiēs agorázoun την ηλεκτρονική λειτουργία των μέσων ενημέρωσης!

To dérma mou to kremíw sthn kremáστρα san palíw palítw!

Όλα τα γράμματά μου τα υπογράφω με ένα μετωπίτη!

2004-2009

## MANDORLA E SHENJTËVE

Horizontet varen mbi mua si pemë yjesh!

C'është kjo dedakofoni, që e dëgjoj, si një fuqi kozmike?

Diku, u vetëvra një shkrimtar, jo me revole, a prerje venash, por nga mungesa e fjalëve fatale, ah, u vetëvra, u vetëvra!

Anija e Dehur, e Artur Rembosë, u përmbys në ujën e një vaske banjoi, plot gjak menstruacionesh, të një prostitute, të droguar!

I mbështjellë me ethet, unë tani, shfaqem, si me Mandoρίtën e Shenjtëve!

2004-2009

## OI MANTOΙΕΣ ΤΩΝ ΑΓΙΩΝ

Oi orízontes krémontai páνω mou san astrikó déntro!

Ti ëstë ai që vjen nga këmbët e qytetarëve, si anëtarë të një bashkësie, si anëtarë të një bashkësie, si anëtarë të një bashkësie, si anëtarë të një bashkësie.

Κάπου, αυτοκτόνησε ένας συγγραφέας, όχι με περίστροφο, ή κόπη φλεβών, αλλά από έλλειψη θανατηφόρων λέξεων, αυτοκτόνησε, αυτοκτόνησε!

To methusímno karáfti tou Arthúrou Rempó anetráphi sto νερό μιας μπανιέρας, γεμάτη εμμηνόρροικό αίματος, μιας ναρκωμένης πόρνης!

Tulhíméno me purétw, tóra emfanízomai, ópws me tis mantóλες των Αγίων!

2004-2009

## ZOTI TEPDIL SI GAZETASHITËS I VIJËTËR

Dëborat e shekujve më kanë mbuluar, si me shtresa gjeologjike!

Ah, ky popull i plogët, që s'është, si një kashe mishi!

Mos u trishto, Buzuku im, i harruar, me shkrimin tënd e kam bërë një armaturë hekuri, të shkëlqyeshme, më e mrekullueshme se e Akilit

të Trojës!

Gazetat, me lajmet për Apokalipsin e Ardshëm, na i shpërndan vetë Zoti, Zoti, i veshur tebdil, si gazeta shitës i vijetër!

2004-2009

## O ΠΑΡΑΛΟΣ ΘΕΟΣ ΣΑΝ ΠΑΛΙΟΣ ΕΦΗΜΕΡΙΔΟΠΩΛΗΣ

Tá aiwóna χιόνια με έχον καλύψει σαν γεωλογικά στρώματα!

Ω, αυτός ο σκηνός λαός, που δεν κινείται, σαν ένας σαρκικός θάμνος!

Μην θίβεις, ξεχασμένη μου Μπουζούκα, με τη γραφή σου έρπιαζα μια σιδερένια πανοπλία, στυλνή, πιο υπέροχη από του Αγύλλεα της Τροίας!

Oi ephmerídēs, me véa για την επερχόμενη Apokályψη, mas dianémontai από τον ίδιο τον Κύριο, o Θεός, παραδωλά ντυμένος, ως παλιός εφημεριδοπώλης!

2004-2009

## NATA ME KATËR HËNA

Kjo tufë me ishuj është gati të fluturojë!

Zgjatet trupi i këtij kali dhe përfundon në derdhje, si një lumë i çuditshëm, misterit!

Dhe horizonti është tek këmbët e mia, si një send i thyer!

A mund të jetosh, natën e pafund, nën katër Hëna?

Dhe kur vetë Vetëvrasja bëhet një akt metafizik?

Sa fjalë, që vdesin, në virgjëri, se s'u konsumuan kurrë!

2004-2009

## H NYXTA ME TËSËERA ΦΕΓΓΑΡΙΑ

Αυτό το σμήνος των νησιών είναι έτοιμο να πετάξει!

Tenótavetai to sóma autóu tou álógu kai katálygei sthn ekbólē, san éna parázēno potámi, mωstήrio!

Kai o orízontes éinai sta póδια mou, san éna spασμένο αντικείμενο!

Μπορείς να ζήσεις, την ατέλειωτη νύχτα, κάτω από τα τέσσερα φεγγάρια;

Kai ótan η ίδια η αυτοκτονία γίνεται μεταφυσική πράξη;

Pόσες λέξεις, πεθαίνουν στην παρθενία, γιατί δεν καταναλώθηκαν ποτέ!

2004-2009

## PËRPARA E KAM NJË PËRJETËSI

Përpara e kam një Përrjetësi, ngjyrë vjollcë, ose okër!

Internacionalja e të Vdekurve s'ka pse të shpiket!

Dhe fjalët ikin, refugiojnë që nga Logosi.

Njeriu e lë trupin, ku të mundet, po Shpirtin, me vehte e merr!

Zosíma, historian bizantin, thotë, se kur Aларiku, me gotët e tij, në 395 sulmoi Athinën, u zmbraps, se mbi bedena, u shfaqën fytyrat e ndritshme, të Athinasë dhe të Akilit! Ah!

Kore zërash, më rrethojnë, si pyje të magjepsur!  
2004-2009

## ΜΠΡΟΣΤΑ ΜΟΥ ΕΧΩ ΜΙΑ ΑΙΩΝΙΟΤΗΤΑ

Μπροστά μου έχω μια αιωνιότητα, μοβ ή ώχρα!

Η Διεθνής των Νεκρών δεν χρειάζεται να εφευρεθεί!

Kai oi λέξεις φεύγουν, φυγαδεύονται από τον Λόγο.

O άνθρωπος αφήνει το σώμα όπου μπορεί, αλλά το Πνεύμα, μαζί του το παίρνει!

O Βυζαντινός ιστορικός Ζωσιμά λέει πως όταν ο Αларик, με τους γότθους του, επιτέθηκε στην Αθήνα το 395, αποσύρθηκε, γιατί στις επάλξεις εμφανίστηκαν τα φαινοειδή πρόσωπα της Αθήνας και του Αγύλλεα! Αχ!

Χοροδία ήχων, με περικυκλώνουν, σαν μαγεμένα δάση!  
2004-2009

## LATINISHTJA E RINGJALLUR

Në det, më rrethojnë peshqit me gjak blu, në pllajë më vështrinë kuaj me gjak të gjelbër, ajme, sa i trishtuar jam!

Vjeshta shton sqafurin, fosforeshent të gjethëve!

Dhe ja ky agim është si latinishtja e ringjallur, për të komunikuar tërë peizazhet, deti, zogjtë, planetet!

Lëvoret e drurëve, - ç'garderrobë prej Princit!  
2004-2009

## H ΑΝΑΣΤΑΣΗ ΤΩΝ ΛΑΤΙΝΙΚΩΝ

Στη θάλασσα, με περιβάλλουν νύχια με γαλάζιο αίμα, στις πεδιάδες με κοιτάζουν όλοια με πράσινο αίμα, ουρλιάζω, πόσο λυπημένος είμαι!

To θηινόπαρο προσθέτει θείο, το φωσφορούχο των φύλλων!

Kai va autó η αυγή είναι σαν τα αναστάσιμα Λατινικά, να επικοινωνούν όλα τα τοπία, η θάλασσα, τα πουλιά, οι πλανήτες!

O φίλοις των δέντρων, η πηγκηπική ματιοθήκη!  
2004-2009

## DUNA FLORIR

Tik-taku i dilës orë, i përshkon tëtërë imazhet?

O, zogj bohémë, në labirinte ajri!

C'është kjo erë, që krijon duna floriri?

Bredh opti im, nëpër hapësirat, si në multimedia!

Dhe fusha, u, kohë më parë, qe një rrap, është si truri, që ka ëndërruar dikur!

I marr tërë gjurmët, e arta, të Princit të Vogël, të Ekyperisë, dhe me to, e bëj pullazin tim!  
2004-2009

## ΧΡΥΣΟΙ ΑΜΜΟΙΟΦΟΙ

Ta tik-tak ποιας χρονικής στιγμής διαπερνούν όλες οι εικόνες;

Ω, πηνά μπόου, σε λαβύρινθους αέρα!

Ti είναι αυτός ο άνεμος που δημιουργεί χρυσούς αμμόλοφους;

Περιπλανιέται η οπτική μου, στο διάστημα, όπως στα πολυμέσα!

Kai η κοιλιά, εδώ και πολύ καιρό, ήταν ένας πλάτανος, σαν ο εγκέφαλος, που ονειρεύεται κάπο τε!

Παίρνω όλα τα χρυσά ίχνη, του Μικρού Πιρήκτου του Εξυπερή, και με αυτά χτίζω την οροφή μου!  
2004-2009

Përktheu nga origjinali Petro Çerkezi

# LETËRSIA

Shkrimtari që udhëton me trenin rus e që ndalon në çdo stacion gjuhe, kulture e personazhi, është Maxim Osipov. Rrëfimet e tij kanë kapërcyer pragun e tregimeve krejt të zakonata, me to janë dashuruar qindra e mijëra lexues të kombësive të ndryshme, pa bujë e poh ai është ngjitur rrufeshëm në klasifikimet e kritikës bashkëkohore.

# PËR MAXIM OSIPOV

NGA MIRANDA HAXHIA

Ishte një kohë jo shumë e largët kur bënte mjekun kardiolog, por kjo lloj zeje qe e pamjaftueshme për talentin e dijet e Osipovit. Mënyra si i sheh njerëzit, ngjarjet dhe epokat tranzitore të Rusisë kanë vlerëzuar që të ndërtojë një galeri personazhesh që mbeten gjatë në kujtesë dhe të përshfaqë tregime të mrekullueshme. Libri i botuar së fundmi në shqip ' Klithma e zogut të shtëpisë' është një botim mjaft cilësor i një shtëpie të re e në dukje të parëndësishme. Fenixh por që ka ditur të fillojë historinë e saj me botime të rangut evropian, pikërisht me emrin më të kërkuar të çastit në libraritë Europiane- Maxim Osipov.

Duke marrë parasysh lehtësinë shqiptare të leximit, kohën aspak të përshatshme për të shijuar luksin e kësaj letërsie unike, si dhe vlerën hallakatëse me pushime dhe vetëm pushime, libri ka shënuar shitje të ndjeshme. Nuk është ai tip libri që shitet i gjithi brenda tre ditëve, por përhapja e tij i ngjan lumenjtë që gufmon e ngop ugarët e thata.

Karakteristika të letërsisë së re ruse që dalin si filiz të rinj prej trunqut të letërsisë së traditës ruse janë gjallesat që ngrenë lart, aq lart sa ta bëjnë të bukuroshëm e Osipovit, saqë mjaft kritikë e kanë krahasuar me Çehovin.

**Një pjesë nga tregimi 'Klithma e zogut të shtëpisë' e Maxim Osipov.**

...Një mëngjes në spital. Në shtat dërgjet në shofër, njeri i dobët, që nuk është zog shtëpie e që ka thithur gjithë tymin e cigareve, ai ka infarkt. Tmerrri i sëmundjes i kaloi, dhe ai tashmë vëzhgon si e mjekojnë fqinj.

plakun endacak pa strehë, që të kyçi i dorës ka tatuazh diellin blu, tregues se ka qenë roje kampi. Shoku elektrik e ktheu në normë ritmin e zemrës. "Gjyshi ndihet më mirë, dhe filloi të marrë frymë më rrallë", - shqiptoi shoferi mbas perdes. Në këmbëzim shikimet me të. A do ta lejojnë, vallë, të drejtojë autobusin? Dhe çështja më e rëndësishme e ditës: çfarë duhet bërë, që mos të ndeshen në dhomën e tij gruaja e vet dhe një grua tjetër, - dashnorja, ajo që e ushqen atë me shishqebap. Edhe shoferi kupton diçka për mua, kupton shumë: zogjtë e egër janë mjaft të mprenhtë. Synimi është i qartë - të duash jo vetëm të afërmit, ata të shtëpisë, por më gjerë - njerëzit dhe vendin. Për këtë lipset t'i rikujtosha, t'i sjellësh në mendje, të vëzhgosh me vëmendje, të shpikësh. Ja, diçka nga fëmijëria: unë me babanë po shkonim diku larg, nëpër vapë. Arritëm në një fshat, vdiqëm për të pirë. Babai troket në një shtëpi të panjohur, dhe kërkon ujë. E zonja e shtëpisë thotë, "nuk ka ujë", por na nxjerr qumësht të ftohtë. Ne pimë shumë, ndoshta, nja një litër e gjysmë, babai i propozon të zonjës së shtëpisë pare. Ajo mbledh supet, dhe shqipton pa ndonjë shprehje të fytyrës, që do t'i pasqyronte gjendjen e brendshme: "I dashur, mos u çmendë!!..."

A mund të tregohet një histori ruse pa Moskën? A mundet ndonjëherë? Me tërëzim tregimtar djallëzor, Maksim Ossipov na udhëqet përmes Tarussas-së bukur dhe deri në Rrethin Arktik. Ai tregon për epokën post-sovjetike të drejtuar nga kryeqyteti, temat e së cilës rrallë duken spektakolare. Ajo që është spektakolare është gjuha në të



cilën janë shkruar, gjallëria e kësaj proze, gatishmëria e saj, ritmi i saj.....

Pa e lexuar librin me tregime KLITHMA E ZOGUT TË SHTËPISË të Maxim Osipov, e ke të pamundur të përfytyrosh një vend ku jetojnë pasardhës të personazheve të Çehovit.

Shkrimtari në profesion është mjek kardiolog, por, por ngre një erë të re në fushën e letërsisë botërore si tregimtar fuqishëm. Ngjashmëritë me Anton Çehovin, nuk janë vetëm në profesionin e mjekut, por mënyrën si e përdor 'bisturinë' e zejes tjetër, shkrimtarisë.

Prozat e tij të fuqishme janë pamje të shpirtit aventurier, dialogut thukës, fabulave që nisin si ngjarje të zakonata, por që përfundojnë me një kulm epik apo tragjik më së shumti.

Duke i lexuar një për një të gjitha këto tregime, jam ndeshur me një tragjizëm të thellë dhe elegant që përfshin situata, por mbi të gjitha personazhet në botën e tyre.



Kjo lloj shkrimtarie është pak a shumë një kirurgji e jetës, e botës së brendshme dhe e pasionit të spikatur të personazheve si Bela të 'Njerëz të mirë'; Andrej Georgevic të 'Fantazia', jo Beti, por Elsa të 'Në lumin Shpreë' - është një skaj i përsosmërisë së portretit të një personazhi me aq pak mjete shprehëse.

Ka edhe dy kulme, krejt të ndryshme: udhëtimi në 'Moskë- Petrozavodsk' që na

një me botën ku jeton shkrimtari, copëza të prera nga tregimet të një figure të 'shtrirë nga Lindja në Perëndim' - Rusia e sotme. Ndonjëherë të krijohet ideja se ngjarjet ndodhin këtu, në ndonjë copë rrugë të Shqipërisë. I kemi të gjitha elementet e kësaj novele, përpos hekurudhës dhe trenave.

Dhe 'Klithma e zogut të shtëpisë', që, i vendosur në fillim të librit të turbullon me kthesat e rafinuara, të shpie jo larg, por brenda botës së njeriut. Provinca, spitali, gratë, shoferi, milicët, koloneli, babai, pronat private, besimi - rënia ekonomike, frika, shpirti - zogjtë e egër e qiellore - të gjitha sikur janë tinguj të klithmës së zogut të shtëpisë, ose më thjeshtë: merakut i përbotshtëm i shkrimtarit të mirë, në këtë rast i Maxim Osipov për të shfaqur jetën jo në fotokopje, por sikur të ishte vetë ajo.

Një novelë e shkëlqyer që më mbeti në mendje është

PËRJETËSIA. Për disa arsye:

Mënyra se si fillon kjo lloj narrative; shënimet e harruara në sirtarin e një mjeku, vendi më i padenjë për të arkivuar shpirtin dhe jetën e një njeriu të humbur. Teatri si ndërtesë, fundi i tij tragjik dhe fati i personazheve që kapërcen edhe vetë fatin e tragjedive të mëdha, të cilat aktorët përpiqen t'i vënë në skenë.

Aleksandër Ivanović, i ngjashëm me bukinistin e Cvajgut, po aq ëndërrimtar dhe një lloj eremit i dashurisë për teatrin nuk më hiqet më nga mendja.

Duket sikur autori merret me gjera të vogla, të parëndësishme. Kjo përshkrimi e parë të mbetet e papërfillshme përballë botës së fuqishme shprehëse, formës së një dialogu plot kthesa dhe kthime, +një lloj labirinti psikologjik; E pamundur të mos e shpeshë deri në fund një tregim a novelë që nis, sepse kërkon, hamendëson, por kurrsesi nuk parashikon dot si është fundi.

Nëse ndonjë artist e ka merak fatin dhe lidhjen me të, të lexojë 'Njeriu i epokës së Rilindjes', duket sikur e shpërfill trashigimin e fatit të tyre, por krejt e kundërta ndodh: autori novela është një herje e ndërjegjësimit qytetar: vëmendja ndaj njeriut. Deformimi i natyrës njerëzore. Aventura e madhe e rusëve. Shpirti që digjet mbi hirin e lavdisë së humbur.

"Rusia, - (thotë një udhëtar në novelën 'Moske- Petrozavodsk) - i ngjan vendeve. Udhëtojnë nëpër të vetëm nga lindja në perëndim dhe nga perëndimi në lindje, duke përjashtuar trupin e vëmendjes, të populluar mjaft dendur, në të mund të zhvendosesh nga veriu në jug dhe nga jugu në veri."

➔Vijon nga faqja 18

lloji porti fare të vogël, na afrohet edhe një toponim tjetër, "Gjoli i Gjemisë", që ndodhet po në perëndim të Shën-Premtes së Laçanit. Ky gjol, pjesë e lagunës së Apolonisë, dikur, jo shumë larg në kohë, ka pas qenë port, ku vinin e qendronin gjemjtë. Ka rëfime gopore se ai ishte një port që shërbente jo zyrtarisht, deri sa i hap port i Sëmanit. Në këtë port të vogël, atje të Gjoli i Gjemisë, shitje krijesit kripa në verë dhe zhuka gjatë vjeshtës dhe dimrit. Shenjomë se bima e zhukës, që shërben për litar, për sporta e kosha, për shpinore dhe stromë karrikesh ka qenë burim të ardhurash për banorët e zonës rreth lagunës së Apolonisë. Kjo tregëti e vogël, me sa kuptohet, pa doganë, i jepte një lloj vazhdimësi këtij porti jo zyrtar, si një jehonë e zbetë e portit të Spinariçës së dikurshme. I radhitëm këto raste të mikro-toponimeve, që ndodhen në perëndim të Apolonisë, prapa kishës së Shën-Premtes në Laçan, atje ku mbaron Lumi i Vjetër, me qëllim që të forcojmë idenë se Shën e Premtja, me doemos, duhet të ketë pas qenë epëndra e një porti të zhdukur në ish Gjirin e Apolonisë. Dhe ky port, bazuar në fakte që përmendëm, rezultojnë të jetë

Spinariça.

Me këtë rast,Shenjomë se sa kohë që argumentohet teza se Spinariça e ka vend-ndodhjen për rreth kishës së Shene Premtes në Laçan, bie hipoteza e Prof. Dyselie, i cili mendon se Spinariça duhet të ketë qenë në Zvernek. Ky mendim i tij nuk mbrohet dot as nga dokumentave historike dhe as nga ana e terrenit gjeografik.

Lidhur me idenë e lokalizimit të Spinariçës si port i Apolonisë, jam mbështetur edhe në disa shenime arkivale rreth porteve arbërore, si dhe në komente të historianëve specialistë të Mesjetës dhe të kohës antike nga të cilët po veçoj: Prof. H. Ceka, Prof. A. Meksi, Prof. P.Xhufi, Prof. L.Nadin, historiani I. Gjika.

Rëndësi të veçantë për argumentimin e idesë rreth portit detar të Apolonisë kanë pasur toponimet, që gjenden në hapësirën e hinterlandit të saj. Po, mbi të gjitha, duhet të theksoj se çelësi kryesor për të mburrjtur tek ideja e lokalizimit të këtij porti, të quajtur **Spinariça**, siç e kemi theksuar dhe më parë,<sup>17</sup> është **Shën-Premtja në Laçan**.

<sup>17</sup>Bibliografi A.Baçi, A. Meksi, Historia e Arkitekturës, Tiranë 2009.

A. Meksi, Arkitektura e Kishave të Shqipërisë, Eugen, Tiranë, 2014.  
A. Mici, Rreth Portit Detar të Apolonisë, gazeta Dielli, 16 gusht 2014.  
H. Ceka, Apolonia, Tiranë, 1998.  
Herodoti, Historik, Libri IX, f. 540, Tiranë, Botimet IDK, 2014  
I. Gjika, Kisha e harruar e Shën e Premtes, MAPO, 17 dhjetor, 2015.  
L. Nadin, Venezia e Albania, Veneto, 2014.  
P. Xhufi, Nga Pellagot tek Muzakajt, Tiranë , 2009

2015 - 2017  
Massachusetts  
Shënime  
<sup>1</sup> Fjala të eratorit të famshëm romak, Ciceronit, që duan të thonë: Qytet i madh dhe hijerëndë  
<sup>2</sup> H. Ceka, Apolonia, Tiranë, 1998, f.12  
<sup>3</sup> M. Agrippa, (63-12, Para Krishtit), strateg i Romës së vjetër. Për nder të tij që në shek. I në Romë, u ngrit Pantheonit i lartë me kupolë ovalë.  
<sup>4</sup> H. Ceka, Apolonia, Tiranë, Shqipia e botimeve N. Frashëri, 1999, f.112  
<sup>5</sup> R. Saraçi, Fjalori Enciklopedik Shqiptar, f. 1156  
<sup>6</sup> Laguna që shtrihet në rreze të kodrave të Apolonisë u quaj "Kënetë e Hoxharës" gjatë shekullit të XIX, mbasse dhe pak dekada më parë, kur fshati Hoxharë, që është ngjitur me Pojanin, u bë kryeqendër e ciftit të bejlerëve të Fierit. Aty bejlerët ngritën edhe konakët e tyre si vazhdim i sarajevë që kishin në qytet. Kështu që emri i ciftit të Hoxharës arriti të dalë para emrit antik të Apolonisë, ose dhe atij të Pojanit të sotëm.  
<sup>7</sup> A. Mici, Rreth Portit Detar të Apolonisë, Gazeta Dielli, 16 gusht 2014  
<sup>8</sup> Shkrimtari Jakov Xoxa mbeti i impresionuar me pamjen dhe gjendjen ekzotike të kishës së Shën-Premtes, disa nga episodet e romanit "Lumi i Vëdekur" në do t'i vendoste për rreth kësaj kishë.  
<sup>9</sup> Të dhënat për dimensionet e kishës së Shën e Premtes më janë sjellë të verifikuara edhe nga ing. Ardian Tanku, autor i shoqërisë "Rilindje e Apolonisë"  
<sup>10</sup> I.Gjika, MAPO, artikulli "Kisha e Harruar e Shën-Premtes", 17 dhjetor 2015.  
<sup>11</sup> A. Meksi, Arkitektura e kishave të Shqipërisë, Eugen, Tiranë, 2004, f.189  
<sup>12</sup> I. Gjika, MAPO, artikulli, 17. Dhjetor, 2015  
<sup>13</sup> L.Nadin, Venezia e Albania/Una Storia di Incontar e Secolari Legami Regione del Veneto 2014, p. 26-27  
<sup>14</sup> A. Baçe, A. Meksi Historia e Arkitekturës, Tiranë, 1998, f. 6  
<sup>15</sup> P.Xhufi, Nga Pellagot tek Muzakajt", Tiranë f.135  
<sup>16</sup> I.Gjika, MAPO, Shën-Premtja - kishë e braktisur; 17 dhjetor, 2015  
<sup>17</sup> A. Mici, Rreth Portit Detar të Apolonisë, gazeta Dielli, 16 gusht, 2014



Opinioni *i* Ditës

# Berisha nuk ka të drejtë të flasë për kufij

Nga Rexhep Qosja

(vijon nga faqja 1)

... Sali Berisha, tha në takimin me kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti.

Ishte kjo fjalë e ngarkuar me retorikë pseudoatdhetare dhe me fyerje ndaj të gjithë atyre që për bisedimet Kosovë-Serbi nuk mendojnë si ai!


Në këtë turr të tij sulmues, Sali Berisha nuk ngurroi t'i quajë argatë të Serbisë të gjithë ata që flasin për korrigjimin e kufirit, a për lëvizjen e kufirit, a për shkëmbimin e territorit midis Kosovës e Serbisë.

Në qoftë se ka politikan shqiptar që nuk ka të drejtë politike e morale të flasë për çështjen e kufijve të Kosovës ky është para së gjithash Sali Berisha.

Dhe, them kështu sepse Sali Berisha është ai që nga postet më të larta të Shqipërisë shtetërore ka mohuar mundësinë që Kosova të bëhet shtet ndonjëherë!

Dhe, them kështu sepse Sali Berisha është ai që duke e quajtur Kosovën djep të binjakëve shqiptarë e serbë e ka ndarë Kosovën!

Dhe, them kështu sepse Sali Berisha në vitet e despotizmit të tij, kur drejtpërdrejt e kur përmes Malit të Zi, duke e thyer embargon e vendosur prej faktorëve ndërkombëtar ndaj Serbisë, me naftën e Shqipërisë e ka furnizuar ushtrinë



serbe që masakronte shqiptarë në Kosovë.

Për këto arsye e quaj të palejueshme gatishmërinë e kryetarit të Vetëvendosjes, Albin Kurti, që në kohën kur BE-ja dhe SHBA-të po bëjnë përpjekje për t'u arritur marrëveshje midis Kosovës dhe Serbisë të dëgjojë re-

torikën e një njeriu që ka humbur të drejtën politike e morale për të folur për kufijtë e Kosovës.

Kjo që them për Albin Kurtin nuk do të thotë se unë pajtohem me sjelljet e qëndrimet politike, të bëra para se të mendohen, të kryetarit të Kosovës, Hashim Thaçi. Jo. Unë me dëshpërim i dëgjoj e i

shikoj në televizione varavingat politike të këtij despoti, i cili atë që e thotë në mesditë e mohon në mbrëmje, e ripohon të nesërmen dhe e mohon sërish në mbrëmje. Varavingat e tij politike janë bëtë shumë komprometuese për mendjen politike të Kosovës.

Dhe, them në fund, se të

gjithë ata që po mohojnë idenë e korrigjimit të kufirit, të lëvizjes së territorit midis Kosovës e Serbisë nuk duan të shohin se junta e sotme politike e Kosovës e ka lëvizur tashmë kufirin shtetëror të Kosovës me Maqedoninë dhe me Malin e Zi, kurse me Aneksionin e Marrëveshjes për caktimin e kufirit me Malin e Zi mundësia e lëvizjes së mëtejme të këtij kufiri është e hapur! Dhe, kështu e ka shkelur dhe e mbanë të shkelur Kushtetutën e Kosovës! Dhe, po u kërkua prej saj, do të vazhdojë të shkelë e të tkurrë Kosovën edhe më tej. Deri kur?

Dhe, të them në fund se ata që po flasin kundër korrigjimit të kufirit, kundër lëvizjes së kufirit verior dhe kundër shkëmbimit të territorit mes Kosovës dhe Serbisë po flasin duke pasur parasysh postet e tyre, të sotmen e tyre, mundësitë e tyre për të qenë çka dëshirojnë të jenë e në asnjë çast duke pasur parasysh edhe të ardhmen paqësore të Kosovës, të ardhmen paqësore të fëmijëve tanë, të pasardhësve tonë!

Ata po tregohen çka janë në të vërtetë: njerëz politikë pa vizion politik!

E ata që merren me politikë sot e nuk mendojnë, e nuk e dinë se si duhet të jetë Kosova pas 20 vjetësh, ata s'kanë të drejtë morale të merren me politikën e shtetit.

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE  
LAJMET E FUNDIT NE  
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Opinion *i* Ditës

# Ndryshimi që prisnim nga Rama!

Nga Lutfi Dervishi

(vijon nga faqja 1)

... qeveri. Ministrat në fakt nxijnë për 11 muaj fytyrën në Tiranë dhe 1 muaj i mbetet për të nxirë trupin në plazhet e Shqipërisë. Por nëse tolerohet nxirja e fytyrës së individit nuk mund të tolerohet nxirja e fytyrës së qeverisë.

Vetë kryeministri e la krejt të hapur mundësinë e ndryshimit kur tha se me secilin ministër kishin një kontratë performace. Dhe kur vjen te performanca - nuk ka Facebook e Instagram që të zbulon bilancin.

Analistët dhe vëzhguesit e jetës politike nënvizojnë se pyetja nuk ishte A, por Sa të thella do të ishin ndryshimet në qeveri?

Fjala e mbajtur në Asambledë Kombëtare nga kryeministri paralajmëroi një cunam të vërtetë. Po të mos e dalloje nga timbri zërit dhe figura të krijuar përshlypja se po fliste lideri opozitës.


Nuk kemi mbaruar bypasin e Fierit (5-6 km të mbetura) dhe të Vlorës, nuk kemi mbaruar rrugën e Elbasanit (10 km rrugë e mbetur). Zemërimi kryeministrit duke pasur parasysh se nuk ka përgjigje për pyetjen: çfarë rruge keni mbaruar këto 5 vjet, është më se legjitim.

Ata në sallë dhe vëzhguesit në kafene menduan se ministri i parë që duhet ndryshuar është Damian Gjokuri.

Kryeministri u shpreh krejt i pakënaqur me drejtimin e Ministrisë së Bujqësisë. Të gjithë zyrtarët, tha ai, nuk e kuptojnë se çfarë bëjnë në zyra. E hëngri dhe Niko Pëleshi.

Edhe në frontin e punëve me jashtë nuk është se kemi shkëlqime. Bisedimet me Brukselin nuk u hapën. Me Athinën nuk ka progres. Në Kosovë nuk merret vesh në është bishti më i rëndësishëm. U krijua për një moment ideja se iku edhe Ditmir Bushati. Gjykuar nga vizitat në familjet e varfra ku varfëria është skalitur me shumë se në prozën e poezinë e Migjenit, ndryshime të shpejta dhe pa shumë diskutim priteshin edhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale.

Për punë e rendit, ndryshimet jo vetëm i kërkon opozita, por është krejt e qartë se i kërkon edhe situata. Një postim i deputetit Gjetan Gjetani ishte qershia mbi tortë. Shkarkimi live i Gjetanit - sigurisht që do të pasohet edhe nga shkarkimi ministrit të Rendit. Kur u shkarkua Gjetan Gjetani që skuqet kur flet - pritej të skuqeshin edhe të paktën gjysma e qeverisë. Te çështja e rendit dhe lidhjeve me krimin - kryeministri sigurisht nuk do të toleronte sineritetin brutal të kryetarit të grupit parlamentar Taulant Balla që pohoi



se kishte miqësi me një të ndaluar me biografi problematike në Itali dhe Shqipëri.

Për financat dhe ekonominë - si mund të ecë përpara nga në mënyrë anglistheje - shifrat sado të mira të dalin në 'Facebook' nuk mbulojnë dot realitetin e një ekonomie në paralizë ku malli kryesor i eksportit mbeten: 400 mijë shqiptarë që plotësojnë lotarinë amerikane.

Kryeministri u shpreh dakord me një propozim të beftë të kryetarit të opozitës për veting, por nënvizoi se nuk duhet të harrojmë vetingun që po ndodh - me ritmet e të cilit nuk janë të kënaqur as ata që po shkarkohen. Ministria e Drejtësisë një tjetër dikaster ku priten ndryshime.

Në fakt udha më e shkurtër do të ishte të përmendej se cili

dikaster do të mbetet pa ndryshuar: dhe i vetmi duket ai i Mbrojtjes.

Në kohën që anëtarët e asamblesë, anëtarët e qeverisë dhe publiku i gjerë po priste kumtimin e ndryshimeve, kryeministri mori frymë thellë dhe kumtoi ndryshimet, ... jo në qeveri, por në parit. Në fakt, jo ndryshimet, por ndryshimin.

I vetmi ndryshim i madh i shtatorit 2018 ishte Musa Ulqini. Pas marrëveshjes së 17-18 majit 2017 me liderin e opozitës, kjo ishte lëvizja e dytë e madhe që nuk u parashikua as nga opinionin publik, as nga ministrat, dhe sigurisht edhe këtë radhë analistët mbeten me gisht në gojë. Askush nuk guxon të komentojë efekte që do të ketë në qeverisjen e vendit ndryshimi i Musa Ulqinit.

Vetë kryeministri e la krejt të hapur mundësinë e ndryshimit kur tha se me secilin ministër kishte një kontratë performace. Dhe kur vjen te performanca - nuk ka Facebook e Instagram që të zbulon bilancin.

## HOROSKOPI

### DASHI

Mos u përqendroni tek fati dhe përpikuni të përmirësoni shëndetin tuaj. Është koha e duhur që të kontrolloni peshën dhe të nisni ushtrimet fizike. Sot nuk do të keni shumë durim.

### DEMI

Do të kaloni një ditë shumë të këndshme me fëmijët tuaj. Do të kryeni aktivitete të shumëllojshme. Ka gjasa që sot të përfshihen në një lidhje romantike. Ka mundësi që në punë të përballemi me disa probleme.

### BINJAKET

Duhet të mendoheni mirë nëse keni ndërmend të investoni, pasi mund të gaboni. Anëtarët e familjes ose partneri/partnerja do të shkaktojnë disa probleme. Do të keni probleme serioze me partnerin/partneren nëse i tregoni se çfarë duhet të bëjë.

### GAFORJA

Bëni kujdes me shëndetin dhe rregulloni punët. Sot do të fitoni mjaftueshëm para, por rritja e shpenzimeve nuk do t'ju lejojë të kurseni. Do të kaloni një ditë shumë të bukur me partnerin/partneren, që do ju mbështesë për problemet tuaja.

### LUANI

Do të ndihen shumë mirë nga ana shëndetësore pavarësisht se do të kaloni një ditë plot tension. Bëni kujdes me çështjet bankare. Nuk është dita e duhur për të dominuar, pasi mund të shkaktoni probleme.

### VIJGJERESHA

Do të keni një dëshirë të madhe për të udhëtuar dhe për të shpenzuar para por nëse e bëni një gjë të tillë do t'ju vijë keq më pas. Do të përjetoni disa vëshirësi me anëtarët e familjes, por mos lejoni që kjo t'ju shkatërrojë qetësinë.

### PESHORJA

Nuk do të bëni progres për shkak të pesimizmit tuaj. Është koha e duhur që të kuptoni se shqetësimet kanë ndikuar negativisht në aftësinë tuaj për të menduar siç duhet. Do të keni rritje të shpenzimeve, që gjë do t'ju sjellë shqetësim.

### AKREPI

Dikush që ju i besoni nuk do t'ju tregojë të gjithë të vërtetën rreth një çështjeje. Aftësia juaj për të bindur të tjerët do t'ju ndihmojë në zgjidhjen e problemeve. Me kurajën e fortë që ju karakterizon, do të fitoni dashurinë.

### SHIGJETARI

Sot do të kryeni disa aktivitete sportive, të cilat do t'ju mbajnë në formë të mirë fizike. Nuk është dita e duhur për të investuar apo për të spekuluar. Stili ekstravagant i jetesës suaj mund të shkaktojë tensione në shtëpi, kështu që shmangni daljet natën vonë.

### BRICJAPI

Sot do ti kushtoheni shëndetit dhe look-ut. Gjithashtu, do të kaloni një ditë shumë të këndshme në çift. Mos ndërmerrni vendime të nxituara për të cilat mund të pendoheni më pas. Për çiftet e martuar, është dita për të përjetuar anën e mirë të martesës.

### UJORI


Mos shpenzoni shumë për argëtim apo për look-un tuaj. Migtë dhe bashkëshorti/ bashkëshortja juaj do t'ju bëjnë të ndiheni mirë dhe të lumtur. Në punë do të ndiheni i veçantë sot. Dikush nga e kaluara ka gjasa t'ju kontaktojë.

### PESHQIT

Shëndeti i një prej anëtarëve të familjes suaj do t'ju shkaktojë tension. Ka gjasa që partneri/partnerja juaj t'ju zhgënjëjë dhe do të jetë shumë e vështirë ta bindni atë t'i qëndrojë planit tuaj.



**Fjalëkryqi (1)**



- 37. Eshhtë shërbimi me letra
  - 39. Inicialet e Asimov.
  - 40. Një rreth pa ekstreme.
  - 41. Eshhtë syzë në komodinë.
  - 42. Ndezur përgjysmë
  - 44. Janë diletantë.
  - 45. Memoria në computer.
  - 46. Janë engjëj të Korit të lartë.
- VERTIKAL
- 2. Ishin ushtarët e Pirros
  - 3. Ekstreme në sektor.
  - 4. Një katastrofë.
  - 5. Kapur pa kufij.
  - 6. Një pjesë e territorit.
  - 7. Janë divane të sajaura.
  - 8. Janë ndenjëse në park.
  - 9. Eshhtë mbikëqyrje ndaj të miturit.
  - 10. Harris aktor.
  - 11. Qyteti i përjetshëm.
  - 12. Janë filmat me drita të kuqe.
  - 14. Tigri i Malajzisë i Emilio Salgarit.
  - 16. Ai i Madh u udhëhoq nga Mao Ce Dun.
  - 18. Eshhtë vegël e... rrethimit.
  - 22. Fillojnë sefte.
  - 24. Janë besimet e besimtarëve.
  - 25. Janë skuadra.
  - 27. Janë linjat me tragete.
  - 28. I preu Seneka.
  - 30. Një pjesë e relacioneve.
  - 31. Janë vendet ku prehen heronjë.
  - 33. Eshhtë detar si ai i Durrësit.
  - 34. ... Villa në futbolin anglez
  - 36. Loriku kuqez.
  - 37. Edith e La vie en rose.
  - 38. Një mund të jetë fetar.
  - 41. Janë tek në samba.
  - 43. Bëjnë durim me uri.
  - 44. Në krye të armatës.


- HORIZONTAL
- 1. Arbana aktor.
  - 7. Kështu janë enigmat.
  - 13. Bëjnë shumë të tilla fëmijët zevzekë.
  - 15. Ishite familja e Henrikut VII.
  - 16. Fund filmi.
  - 17. Opera me Liu dhe Calaf.
  - 19. Fillojnë një motiv
  - 20. Eshhtë gjahu si çiftja.
  - 21. Bëhen në stacione.
  - 23. Fillojnë romanin
  - 24. Eshhtë policia e FBI.
  - 26. Të parat në stacion.
  - 27. Mund të jepet me medalje.
  - 28. Inicialet e Keaton aktore.
  - 29. Dënoheshin nga Inkuizicioni të tillë.
  - 31. Zanore për papare.
  - 32. Fitohen nga ciklistët.
  - 33. Me beach në një qytezë të Florida-s.
  - 35. Shigjeta e argjenditë e Formula 1.

**Fjalëkryqi (2)**

- HORIZONTAL
- 1. Një Af famëkeq.
  - 7. Eshhtë mjet lundrimi klandestinësh.
  - 11. Ishite kryeperëndi nordike
  - 12. Një pjesë e porosive.
  - 14. Inicialet e Redford.
  - 15. Mund të jetë emërore.
  - 16. Eshhtë vejetacion.
  - 18. Shkruhet shkurt mm.
  - 19. Inicialet e Turgeniev.
  - 21. Eshhtë e mërztishme.
  - 23. Kështu thomë se është femra
  - 25. Janë pjesë drame.
  - 27. Kanë aderuar në parti.
  - 28. Fillojnë teorinë.
  - 29. Nikola Tesla.
  - 30. Nuk kanë nevojë të rruhen.
  - 31. Derek aktore.
  - 32. Një pije aromatike
  - 33. Pierre Daninos.

- 35. Eshhtë legjenda
- 36. Kështu thirrje Marco Pantani.
- 38. Lindsay aktore.
- 40. Kaplon të inatosurin.
- 42. Janë edhe ato të cirkut
- 44. Eshhtë numri i oktetit
- 45. Fillojë armataimin.
- 46. Janë pasuri të investuara.
- 47. Eshhtë shoshë.

- VERTIKAL
- 1. Një spektakël me dema.
  - 2. Negri poete.
  - 3. Kështu e ka punën ai që e ka keq
  - 4. Konak pa kufij
  - 5. Fillojnë nismat.
  - 6. Ishin kaçakë.



- 8. Eshhtë pika delikate
- 9. Mali ku ngeci Arka.
- 10. Zanicchi këngëtare.
- 12. Janë shoferë të Formula 1.
- 13. Girona aktor.
- 16. Janë trarë.
- 17. Ulen në dhomën e lartë.
- 18. Janë sandale lëkurëkuqsh.
- 20. Dhjetë angleze.
- 21. Gënjëjnë për t'u bërë të famshëm.
- 22. Emri i Bismarck.
- 24. Gjysma e leqeve.
- 26. Janë katalizatorë të organizmit.
- 31. Duhet vaditur.
- 32. Kutia kur nuk... ka
- 33. Kush është... është në moshën e tretë.
- 34. D'Istria, alias Elena Gjika.
- 36. Sampras tenist.
- 37. Marsi i akeje.
- 39. Një pjesë e hepatiti.
- 41. Firar pa kufij
- 43. Fillojnë tatëpjetën.

**Gjeni ndryshimin**

Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra

Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

		1		4				2	6
5	2							7	
	6								
				9	8	6			
	7	1							3
8	1					5			
9				4		6	8		
	5			7					
7			2	3					

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

1	9	4	6	5	8	2	7	3
2	5	7	4	3	9	6	1	8
3	8	6	2	1	7	5	4	9
4	1	2	5	8	3	7	9	6
7	3	9	1	2	6	8	5	4
5	6	8	7	9	4	3	2	1
9	2	5	3	6	1	4	8	7
6	4	1	8	7	5	9	3	2
8	7	3	9	4	2	1	6	5

**PËNGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

A	P	M	P	K	A	G	I	M			
T	I	K	M	O	D	E	L	E	T	R	I
K	A	P	I	R	A	T	E	R	I	A	Z
P	I	R	A	T	E	R	I	A	S	O	
P	A	R	A	K	A	L	I	M	E	T	
E	R	C	K	E	R	O	R	A	R	I	
N	O	I	R	E	T	P	E	L	L	E	
M	I	N	M	A	L	O	R	E	T		
L	E	E	D	S	M	A	L	O	G	O	N
A	T	I	A	T	E	S	T	E	R		
N	E	S	O	N	O	R	S	E	A	T	
G	U	T	U	S	O	E	D	I	T		
E	D	L	T	E	C	M	A	F	I	A	
C	K	O	P	E	R	R	D	E	R	R	
O	H	A	R	A	D	I	A	M	A	N	T
E	P	E	R	D	I	T	S	H	M	E	A
S	T	A	D	T	U	M	E	T	I	R	A
D	I	K	A	S	T	E	R	I	R	A	
M	E	N	T	A	N	I	S	S	A	N	
N	O	T	A	A	S	U	E	L	E	N	A
O	R	T	R	I	M	A	B	O	N	E	
V	E	S	I	M	O	T	E	N	D		
A	A	M	E	N	E	T	R	E	N	E	
K	A	R	A	K	T	E	R	E	T	T	R

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

*Argëtim filozofik*

- Që të kesh të ardhme, duhet të braktisësh shpresën se do të jesh në gjendje për të ndryshuar të kaluarën.

- Mua nuk më duhet miku, që pajtohet me gjithçka dhe çdo gjë e miraton me kokë, sepse këtë edhe hija ime mund ta bëjë shumë më mirë.

- Që të ekzistojë miqësia duhet t'i besojmë njëri-tjetrit, e që të bsojmë duhet të jemi miq.

- Eshhtë më mirë të të njohin 6 njerëz për diçka që jeni krenar, se sa të të njohin 60 milionë për diçka që nuk jeni.

**KRIPTOSKEME**

*Përgjigja e numrit të djeshëm*

12	3	9	6	1	10	18	2	4	11	5	1
4	2	6	9	12	3	3	2	6	2	4	
15	8	4	7	3	1	5	1	1	11	14	
8	4	1	6	13	3	2	6	6	1	6	9
5	15	18	18	13	3	12	6	2			
2	1	7	14	2	2	6	2	7	14	6	
10	6	7	6	6	5	1	3	8	6	1	
6	1	4		1	12	10	6	6		7	
7		11	6	5	5	7	6	2	1	5	
7	18	4	1	15	1	6	7	5	14	1	5
5	6	4	1		2	4	1	5	11	5	

**KRIPTOSKEME**

P	U	S	I	K	U	P	T	O	P	
U	R	A	R	O	A	S	L	I		
S	I	P	E	L	E	R	I	N	A	T
H	P	A	N	O	R	A	M	A	T	
T	R	I	P	A	N	O	Z	O	M	A
E	P	A	T	A	T	I	N	A	T	
T	E	S	A	I	T	T	O	D		
I	A	R	E	P	R	A	N	I	M	E
R	I	C	H	T	E	R	S	I	L	
S	T	I	L	E	T	E	U	K	E	
R	U	Z	A	T	R	E				
R	I	C	H	A	R	D	T	A		

*Thënie të mënçura*

- Në qoftë se para çdo shërbimi miqësor menjëherë mendon falenderimin, atëherë nuk ke dhuruar, por ke shitur.
- Gjërat e bukura nuk e përballojnë përshkrimin.
- Pesimizmi është çështje e gjendjes shpirtërore. Optimizmi është çështje e vullnetit
- Pse të shkatërojmë jetën e një vajze të re, kur mund të bëjmë një grua të madhe të ndjehet e lumtur.
- Makiazihi më i bukur për një grua është pasioni. Por është më e lehtë për dikë të blejë kozmetikë.



**Universiteti  
Europian i  
Tiranës**

maiora premunt / gjëra të mëdha na presin

## TRANSFEROHU NË UET

MUNDËSIA E DYTË PËR NJË EDUKIM CILËSOR

**DATA 03-13 Shtator 2018**

- Juridik i Përgjithshëm
- Financë & Bankë
- Menaxhim Biznesi
- Informatikë Ekonomike
- Shkenca Politike
- Marrëdhënie Ndërkombëtare
- Psikologji
- Sociologji – Antropologji Sociale
- Komunikim – Marrëdhënie Publike
- Komunikim Dizajn

Adresa: Bulevardi Gjergj Fishta, Nd. 70, H.1, Tirane, Cel. 068 20 16 816, info@uet.edu.al, www.uet.edu.al



# www.gsh.al GAZETA SHQIPTARE



- Na mermi!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

# Gazeta e gjithë shqiptarëve!



Kontakt: +355 68 40 63 842

- Facebook: Gazeta Shqiptare
- Instagram: gazetashqiptare.al
- Twitter: Gazeta Shqiptare
- E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
- Youtube: Gazeta Shqiptare

